Banka e Shqipërisë

RAPORTI I STABILITETIT FINANCIAR

6M2-2016

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi, jeni të lutur të citoni burimin.
Botuar nga: Banka e Shqipërisë,
Sheshi "Skënderbej", Nr.1, Tiranë
Tel.: + 355 4 2419301/2/3; + 355 4 2419401/2/3
Faks: + 355 4 2419408
E-mail: public@bankofalbania.org

www.bankofalbania.org

Tirazhi: 270 kopje
Shtypur nga *sh.p.k.*

P Ë R M B A J T J A

HYRJE 7

SQARIME 8

DEKLARATA E STABILITETIT FINANCIAR PËR GJASHTËMUJORIN E DYTË TË VITIT 2016 9

1. VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM I RREZIQEVE KRYESORE TË STABILITETIT FINANCIAR 17
1.1 Rreziku sistemik 20

2. ZHVILLIMET NDËRKOMBËTARE 22
2.1 Zhvillimet në tregjet financiare dhe të lëndëve të para 25
2.2 Zhvillimet në grupet bankare të huaja që operojnë në Shqipëri 27

3. ZHVILLIMET MAKROEKONOMIKE NË VEND 29

4. POZICIONI FINANCIAR DHE EKSPOZIMI NDAJ RREZIQEVE I INDIVIDËVE DHE BIZNESEVE 31
4.1 Pozicioni financiar i individëve dhe bizneseve 31
4.2 Tregu i pasurive të paluajtshme dhe kredia për pasuri të paluajtshme 37

5. TREGJET FINANCIARE 41
5.1 Tregu i letrave me vlerë 41
5.2 Tregu ndërbankar 43
5.3 Tregu i këmbimeve valutore 44

6. ZHVILLIMET NË SISTEMET E PAGESAVE 45

7. SISTEMI FINANCIAR 47
7.1 Zhvillimet në sektorin jobankar 48
7.2 Vlerësimi i rreziqeve dhe ekspozimeve të sektorit jobankar 51

8. ZHVILLIMET NË SEKTORIN BANKAR 53
8.1 Ecuria e aktivitetit bankar 53
8.2 Pozicioni i sektorit bankar ndaj jorezidentëve 55
8.3 Zhvillimet në kreditim 57
8.4 Depozitat dhe rreziku i likuiditetit 65
8.5 Rreziqet e tregut 70
8.6 Rreziku operacional 73
8.7 Rezultati financiar dhe eficienca e burimeve 73
8.8 Kapitalizimi i veprimtarisë 75

9. VLERËSIM I QËNDRUESHMËRISË SË SEKTORIT BANKAR SIPAS USHTRIMIT TË PROVËS SË REZISTENCËS 81
9.1 Vlerësimi i qëndrueshmërisë së sektorit bankar ndaj goditjeve makroekonomike 81
9.2 Prova e rezistencës së likuiditetit 85

ANEKS 87

HAPËSIRA INFORMUESE

Hapësirë informuese 4.1	*Rezultatet e vrojtimit mbi gjendjen financiare dhe huamarrjen e familjeve*	*33*
Hapësirë informuese 4.2	*Rezultatet e vrojtimit mbi gjendjen financiare dhe huamarrjen e ndërmarrjeve*	*36*
Hapësirë informuese 4.3	*Përmbledhje e rezultateve të vrojtimit "Tregu i pasurive të paluajtshme" dhe ecuria e indeksit të çmimit të banesave për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2016*	*39*
Hapësirë informuese 8.1	*Prania e euroizimit në ekonominë shqiptare dhe nevoja për trajtimin e tij*	*67*
Hapësirë informuese 8.2	*Faktorët ndikues në raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit të bankave*	*79*
Hapësirë informuese 9.1	*Ndjeshmëria e sektorit bankar ndaj lëvizjeve në normën e interesit*	*83*

PËRMBAJTJA E TABELAVE

2. Zhvillimet ndërkombëtare

Tabelë 2.1	*Disa tregues makroekonomikë për SHBA-në dhe Eurozonën*	*24*
Tabelë 2.2	*Disa tregues kryesorë makroekonomikë dhe financiarë për vendet e Ballkanit Perëndimor*	*25*
Tabelë 2.3	*Zhvillimet në grupet e huaja bankare që operojnë në Shqipëri*	*27*

4. Pozicioni financiar dhe ekspozimi ndaj rreziqeve i individëve dhe bizneseve

Tabelë 4.1	*Aktivet e individëve në sistemin financiar*	*32*

7. Sistemi Financiar

Tabelë 7.1	*Pesha e segmenteve të sistemit financiar ndaj PBB-së në vite*	*47*

8. Zhvillimet në sektorin bankar

Tabelë 8.1	*Struktura e bilancit të bankave, dhjetor 2016*	*54*
Tabelë 8.2	*Ecuria e kredisë*	*57*
Tabelë 8.3	*Tregues kryesorë të depozitave në sektorin bankar*	*65*

PËRMBAJTJA E GRAFIKËVE

1. Vlerësimi i përgjithshëm i rreziqeve kryesore të stabilitetit financiar

Grafik 1.1	Harta e stabilitetit financiar	17
Grafik 1.2	Akumulimi dhe materializimi i rrezikut sistemik	20
Grafik 1.3	Indeksi i Stresit Financiar	20
Grafik 1.4	Vlerësimi i bankave mbi rreziqet kryesore sistemike	21
Grafik 2.1	Ecuria e indekseve kryesore në tregjet e aksioneve	26
Grafik 2.2	Ecuria e kursit të këmbimit të euros ndaj monedhave kryesore	26

4. Pozicioni financiar dhe ekspozimi ndaj rreziqeve i individëve dhe bizneseve

Grafik 4.1	Pozicioni financiar individë dhe biznese, miliardë lekë	31
Grafik 4.2	Struktura e kredisë për individët sipas afatit të maturimit (majtas) dhe monedhës	32
Grafik 4.3	Ndryshimi vjetor i Raportit të Kredive me Probleme për individët, p.p.	33
Grafik 4.4	Struktura e kredisë për bizneset sipas afatit të maturimit (majtas) dhe monedhës	34
Grafik 4.5	Struktura e kredisë së bizneseve sipas madhësisë	35
Grafik 4.6	Ndryshimi vjetor i Raportit të Kredive me Probleme për bizneset, në p.p	35
Grafik 4.7	Kredia për blerje të pasurisë së paluajtshme	38
Grafik 4.8	Raporti i kredive me probleme	38

5. Tregjet financiare

Grafik 5.1	Ecuria e normës mesatare të interesit të borxhit të emetuar në letra me vlerë, në përqindje	41
Grafik 5.2	Përbërja e borxhit të emetuar gjatë 2015-2016	41
Grafik 5.3	Teprica mbi shumën e ofruar për investim dhe normat e interesit të bonove të thesarit, për gjysmën e dytë të vitit 2016	42
Grafik 5.4	Teprica mbi shumën e ofruar për investim dhe normat e interesit të obligacioneve, për gjysmën e dytë të vitit 2016	42
Grafik 5.5	Vëllimi dhe norma mesatare e ponderuar e kthimit të bonove të thesarit në tregun primar	42
Grafik 5.6	Vëllimi dhe norma mesatare e ponderuar e kthimit të obligacioneve në tregun primar	42
Grafik 5.7	Huamarrja e brendshme në euro	43
Grafik 5.8	Normat e interesit në tregun ndërbankar	43
Grafik 5.9	Ecuria e kursit të këmbimit në tregun e brendshëm valutor	44

6. Zhvillimet në sistemet e pagesave

Grafik 6.1	Ecuria e aktivitetit në AIPS dhe AECH për gjashtëmujorin e dytë 2015-2016	45
Grafik 6.2	Ecuria e instrumenteve të pagesave në sasi dhe në vlerë	46

7. Sistemi Financiar

Grafik 7.1	Rritja vjetore e aktiveve të segmenteve përbërëse të sistemit financiar	47
Grafik 7.2	Struktura e institucioneve financiare jobanka sipas llojit të aktivitetit që kryejnë	48
Grafik 7.3	Struktura e aktiveve të institucioneve financiare jobanka	48
Grafik 7.4	Struktura e aktiveve të shoqërive të kursim-kreditit	49
Grafik 7.5	Struktura e aktiveve të shoqërive të sigurimit	49
Grafik 7.6	Struktura e aktiveve të fondeve të investimeve	50
Grafik 7.7	Struktura e investimeve të fondeve të pensioneve private suplementare	50
Grafik 7.8	Ekspozimi i institucioneve kryesore jobankare ndaj sektorit bankar, në raport me totalin e aktiveve të tyre	51
Grafik 7.9	Investimet e institucioneve të sektorit jobankar në titujt e qeverisë, ndaj totalit të aktiveve të tyre	51

8. Zhvillimet në sektorin bankar

Grafik 8.1	Treguesi Herfindahl për produktet kryesore bankare	55
Grafik 8.2	Kontributi i zërave në rritjen vjetore të aktiveve me jorezidentët, p.p	56
Grafik 8.3	Përbërësit e detyrimeve jorezidente	56
Grafik 8.4	Teprica e kredisë, rritje vjetore	58
Grafik 8.5	Kredia e re, mesatare rrëshqitëse 3-mujore	58
Grafik 8.6	Kredia e re sipas qëllimit të përdorimit	58

Grafik 8.7	*Ecuria e kredisë së pambrojtur në valutë*	*59*
Grafik 8.8	*Përbërja e kredisë së pambrojtur në valutë sipas subjekteve, %*	*59*
Grafik 8.9	*Kredia e pambrojtur në valutë për pasuri të paluajtshme dhe cilësia e saj*	*60*
Grafik 8.10	*Kredia e pambrojtur në valutë (jo për pasuri të paluajtshme) dhe raporti i kredive me probleme*	*60*
Grafik 8.11	*Ecuria e kredisë për jorezidentët*	*60*
Grafik 8.12	*Raporti i kredive me probleme*	*61*
Grafik 8.13	*Kontributi në ndryshimin e stokut të kredive me probleme (mld lekë)*	*61*
Grafik 8.14	*Struktura e kredive me probleme*	*61*
Grafik 8.15	*Portofoli i kredive me probleme sipas grupeve bankare*	*61*
Grafik 8.16	*Huatë me probleme në sektorin bankar shqiptar*	*62*
Grafik 8.17	*Ecuria e treguesve të cilësisë për portofolin e pambuluar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit*	*62*
Grafik 8.18	*Ecuria në kohë e raportit të provigjionimit*	*63*
Grafik 8.19	*Ndryshimi vjetor në raportet e mbulimit për bankat*	*63*
Grafik 8.20	*Teprica e kredisë dhe raporti i kredive me probleme sipas llojit të kolateraleve*	*64*
Grafik 8.21	*Kontributi në rritjen e depozitave*	*65*
Grafik 8.22	*Ecuria e depozitave sipas llojit*	*66*
Grafik 8.23	*Depozitat e reja me afat sipas monedhës dhe afatit të maturimit, flukset gjashtëmujore*	*67*
Grafik 8.24	*Tregues të likuiditetit*	*69*
Grafik 8.25	*Mospërputhja në maturim mes aktiveve dhe detyrimeve*	*69*
Grafik 8.26	*Maturimi mesatar i mbetur*	*70*
Grafik 8.27	*Pozicioni i hapur në valutë ndaj kapitalit rregullator për grupet sipas madhësisë*	*70*
Grafik 8.28	*Mospërputhja valutore dhe teprica e aktiveve neto*	*71*
Grafik 8.29	*Mospërputhja valutore sipas monedhave*	*71*
Grafik 8.30	*Mospërputhje valutore sipas monedhave*	*71*
Grafik 8.31	*Mospërputhja valutore, sipas grupeve*	*71*
Grafik 8.32	*Gap-et e maturimit sipas periudhave të riçmimit*	*72*
Grafik 8.33	*Spread-i i normave të interesit sipas monedhave*	*72*
Grafik 8.34	*Përbërësit e rezultatit financiar*	*74*
Grafik 8.35	*ROA sipas peshës së bankave në aktivet e sektorit*	*74*
Grafik 8.36	*Marzhi neto nga interesi*	*74*
Grafik 8.37	*Shpenzimet për provigjionim*	*74*
Grafik 8.38	*Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit*	*75*
Grafik 8.39	*Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit për grupet sipas madhësisë dhe origjinës së kapitalit*	*76*
Grafik 8.40	*Shpërndarja e aktiveve të sektorit sipas raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit*	*76*
Grafik 8.41	*Koeficientët e ponderimit dhe madhësia e klasave kryesore të portofolit të kredisë*	*77*
Grafik 8.42	*Ekspozimet e klasave të kredisë për bankat sipas madhësisë të aktivitetit dhe origjinës në kapitalit*	*77*
Grafik 8.43	*Treguesi i levës financiare, në herë*	*78*
Grafik 8.44	*Kontributi i elementeve në normën e mjaftueshmërisë së kapitalit, në pikë bazë*	*79*
Grafik 8.45	*Kontributi i elementeve në normën e mjaftueshmërisë së kapitalit, në pikë bazë, pa ndikimin e masave kundërciklike/ makroprudenciale*	*79*
Grafik 8.46	*Aktivet e ponderuara me rrezik (APR)*	*80*
Grafik 8.47	*Burimet e rritjes së kapitalit të bankave*	*80*
Grafik 8.48	*Kontributi në ecurinë e normës së mjaftueshmërisë së kapitalit për grupet sipas madhësisë së aktivitetit, në pikë bazë*	*80*

9. Vlerësim i qëndrueshmërisë së sektorit bankar sipas ushtrimit të provës së rezistencës

Grafik 9.1	*Supozimet për ndërtimin e provës së rezistencës*	*81*
Grafik 9.2	*Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit, sipas skenarëve të provës së rezistencës*	*83*
Grafik 9.3	*Vlerësimi i të ardhurave neto nga interesi për sektorin bankar, sipas skenarëve*	*84*

HYRJE

Ky është numri i 17-të i Raportit të Stabilitetit Financiar, një dokument i Bankës së Shqipërisë që publikohet dy herë në vit. Qëllimi i raportit është identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve me të cilat ndeshet sistemi financiar dhe infrastruktura e tij, për t'i dhënë autoriteteve publike mundësinë që të identifikojnë masat përkatëse për korrigjimet e nevojshme. Në hyrje të dokumentit është vendosur Deklarata e Stabilitetit Financiar, publikimi çdo gjashtë muaj i së cilës është një kërkesë ligjore.

Për hartimin e raportit, janë shfrytëzuar të dhëna që disponohen në Bankën e Shqipërisë, është shkëmbyer informacion me autoritete të tjera që mbikëqyrin veprimtarinë e tregut financiar, si edhe janë shfrytëzuar informacione dhe analiza të institucioneve të vendit dhe të atyre financiare ndërkombëtare, publike dhe private. Të dhënat dhe analizat e paraqitura përfshijnë kryesisht zhvillimet gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2016 (më tej, "periudha"). Nëse nuk përcaktohet ndryshe në raport, pritjet për zhvillimet e ardhshme ekonomike dhe financiare shtrihen për një periudhë kohe deri në 12 muaj.

Qëndrueshmëria e sistemit financiar është vlerësuar në bazë të ecurisë dhe rreziqeve që krijohen nga ndërveprimi i tij me mjedisin e përgjithshëm ekonomik, të brendshëm dhe të jashtëm, si edhe nga vetë veprimtaria e tij. Për të vlerësuar rreziqet që vijnë për shkak të ndërveprimit me mjedisin rrethues, janë analizuar zhvillimet më të fundit në tregjet financiare ndërkombëtare dhe në ekonomitë e vendeve të zhvilluara e ato të rajonit, si dhe është bërë një vlerësim mbi ndikimin e tyre në sistemin financiar të vendit dhe sektorin bankar. Ndër treguesit e brendshëm, janë vlerësuar zhvillimet e përgjithshme dhe pritshmëritë për rritjen ekonomike, bilancin tregtar, nivelin e përgjithshëm të çmimeve, kursin e këmbimit dhe treguesit fiskalë. Gjithashtu, nëpërmjet një analize të situatës së punëzënies, të ecurisë së të ardhurave dhe vrojtimeve specifike, është vlerësuar gjendja financiare e bizneseve dhe e individëve dhe ndikimi mbi aftësinë paguese të kredimarrësve të sektorit bankar.

Në raport janë përfshirë, në mënyrë të përmbledhur, rezultatet e ushtrimit të provës së rezistencës, i cili ka përfshirë edhe skenarë të stresit të likuiditetit.

SQARIME

Në fund të muajit dhjetor 2016, bankat e sektorit bankar shqiptar ndahen sipas madhësisë së aktivitetit në:

- banka të Grupit 1 (secila zotëron 0-2% të totalit të aktiveve të sektorit): Banka e Bashkuar e Shqipërisë (BBSH), Veneto Banka (VB), Banka Ndërkombëtare Tregtare (BNT), Banka e Parë e Investimeve (BPI), Banka e Kreditit të Shqipërisë (BKSH).
  Këto banka përbëjnë rreth 4.6% të totalit të aktiveve të sektorit.

- banka të Grupit 2 (secila zotëron 2-7% të totalit të aktiveve të sektorit): Banka Procredit (BPC), Banka Kombëtare e Greqisë (BKG), Banka Societe Generale – Albania (BSG), Banka Alpha – Shqipëri (BA), Banka Union (BU), Banka Tirana (BT), Banka Amerikane e Investimeve (BAI).
  Këto banka përbëjnë rreth 26.6% të totalit të aktiveve të sektorit.

- banka të Grupit 3 (secila zotëron mbi 7% të totalit të aktiveve të sektorit): Banka Kombëtare Tregtare (BKT), Banka Raiffeisen (BR), Banka Credins (BC), Banka Intesa Sanpaolo –Shqipëri (ISBA).
  Këto banka përbëjnë rreth 68.7% të totalit të aktiveve të sektorit.

Në fund të muajit dhjetor 2016, sipas origjinës së kapitalit, bankat e sektorit bankar shqiptar grupohen në:

- me kapital të huaj[1]: Banka Raiffeisen (Austri); Banka Intesa Sanpaolo – Shqipëri, Veneto Banka (Itali); Banka Alpha-Shqipëri, Banka Tirana, Banka Kombëtare e Greqisë (Greqi); Banka Kombëtare Tregtare (Turqi); Banka Societe Generale (Francë); Banka Procredit (Gjermani); Banka e Parë e Investimeve (Bullgari); Banka Ndërkombëtare Tregtare (Malajzi); Banka e Bashkuar e Shqipërisë (Banka Islamike e Zhvillimit - Arabia Saudite); Banka e Kreditit të Shqipërisë (Kuvajt);
  Këto banka përbëjnë rreth 82.6% të totalit të aktiveve të sektorit.

- me kapital shqiptar: Banka Credins, Banka Union, Banka Amerikane e Investimeve;
  Këto banka përbëjnë rreth 17.4% të totalit të aktiveve të sektorit.

Në fund të muajit dhjetor 2016, shtrirje të rrjetit të degëve jashtë vendit evidenton Banka Kombëtare Tregtare me një degë në Kosovë.

[1] *Sipas origjinës së kapitalit, kur kapitali i huaj përbën më shumë se 50% të madhësisë së kapitalit të paguar të bankës.*

DEKLARATA E STABILITETIT FINANCIAR PËR GJASHTËMUJORIN E DYTË TË VITIT 2016

Në mbështetje të kërkesës së nenit 69 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe të nenit 8 të ligjit nr. 9962, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, për të informuar Kuvendin e Republikës së Shqipërisë dhe Këshillin e Ministrave, si edhe për të tërhequr vëmendjen e institucioneve financiare dhe të publikut mbi gjendjen e sistemit financiar në vend dhe rreziqet potenciale që mund të kërcënojnë qëndrueshmërinë e tij, Banka e Shqipërisë publikon këtë deklaratë periodike. Kjo deklaratë është pjesë përbërëse e Raportit të Stabilitetit Financiar për të njëjtën periudhë.

Në raportin e stabilitetit financiar dhe në këtë deklaratë që e paraprin, vlerësohet ekspozimi i sektorit bankar ndaj rreziqeve që burojnë prej ndërveprimit të tij me zhvillimet ekonomike të jashtme, të brendshme, me agjentët e ekonomisë reale, me tregjet financiare në vend, si edhe ndaj rreziqeve që lidhen me mënyrën se si sektori bankar zhvillon veprimtarinë e tij. Në vijim, këto rreziqe përballen me gjendjen financiare të sektorit bankar dhe stresohen nëpërmjet ushtrimit të provës së rezistencës, për të vlerësuar qëndrueshmërinë e sektorit bankar.

Banka e Shqipërisë vlerëson që veprimtaria e sektorit bankar dhe e sistemit financiar në përgjithësi, ka vijuar në mënyrë të qëndrueshme gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2016. Në tërësi, ekspozimi i sektorit bankar ndaj rreziqeve të ndryshme mbetet i kontrolluar dhe treguesit kryesorë të veprimtarisë që lidhen me kapitalizimin, likuiditetin dhe përfitueshmërinë, evidentojnë kapacitetin e tij të plotë për të përballuar rreziqet e veprimtarisë në kushte normale, si edhe për të treguar një rezistencë të mirë ndaj goditjeve më të forta.

Zhvillimet në mjedisin ekonomik dhe financiar

Zhvillimet në ***ekonominë botërore*** gjatë periudhës ishin përgjithësisht pozitive, pavarësisht ndryshimeve mes rajoneve më të mëdha dhe dallimeve në politikat ekonomike. Kjo ecuri u mbështet kryesisht nga kushtet më të favorshme të financimit në tregje, nga vijimi i politikave nxitëse të rritjes ekonomike në shumicën e vendeve të zhvilluara dhe në disa vende në zhvillim, si edhe nga rritja e çmimeve në tregjet e lëndëve të para dhe të naftës. Ecuria e këtyre të fundit, ka ndikuar në rritjen e presioneve inflacioniste, ndonëse ato mbeten përgjithësisht poshtë objektivave të bankave qendrore. Në tregjet financiare botërore, lëvizjet në normat e interesit dhe në kurset e këmbimit të monedhave kanë qenë më të dukshme në muajt e fundit të vitit, duke reflektuar kryesisht disa zhvillime të rëndësishme politike dhe ekonomike në vendet e

zhvilluara. Ekonomia e Eurozonës është zgjeruar me ritme të moderuara, por të qëndrueshme gjatë periudhës. Aktiviteti ekonomik është zgjeruar në shumicën e vendeve të këtij rajoni, mbështetur kryesisht nga përmirësimi i kërkesës së brendshme dhe kontributi pozitiv i inventarëve në sektorin privat. Ekonomia e vendeve të Ballkanit Perëndimor shënoi rritje pozitive gjatë vitit 2016, duke u shoqëruar me përmirësim të kushteve në tregun e punës. Gjendja financiare e grupeve bankare evropiane që zhvillojnë veprimtarinë në vendin tonë mbetet përgjithësisht e qëndrueshme. Për disa prej tyre, aktiviteti është tkurrur gjatë vitit 2016, në vijim të proceseve që lidhen me uljen e borxhit dhe pastrimin e bilanceve nga kreditë me probleme.

Ecuria pozitive e ekonomisë botërore pritet të vazhdojë në periudhën 2017-2018[2], e mbështetur nga vijimi i rritjes graduale ekonomike në vendet e zhvilluara dhe forcimi i kontributit pozitiv nga ekonomitë e vendeve në zhvillim. Në Eurozonë, efekti pozitiv i politikës monetare lehtësuese mbi konsumin dhe investimet private do të vijojë të mbështesë rritjen ekonomike. Megjithatë, zhvillimet politike në vendet e zhvilluara dhe mundësia që ato të shoqërohen me ndryshim të politikave ekonomike, vlerësohen aktualisht si faktori kryesor që mund të ndikojë mbi pritshmëritë për ecurinë e ekonomisë botërore.

Një përmirësim i mëtejshëm i ekonomisë botërore, duke përfshirë atë të Eurozonës dhe të rajonit të Ballkanit, do të shoqërohej me rritjen e kontributit pozitiv të sektorit të jashtëm në ecurinë e ***ekonomisë shqiptare***. Në fakt, ky kontribut është shfaqur më i fortë në ecurinë e bilancit të pagesave për tremujorin e katërt të vitit 2016, kur rritja e tepricës pozitive në llogarinë e shërbimeve dhe një performancë më e mirë e eksporteve kanë sjellë uljen e deficitit të llogarisë korrente. Në tërësi, rritja e ekonomisë së vendit në tremujorin e katërt të vitit 2016, u përshpejtua duke shënuar një normë rritjeje prej gati 4%. Sipas sektorëve të ekonomisë, në rritjen ekonomike dhanë kontribut pozitiv sektori i shërbimeve dhe i prodhimit. Rritja e aktivitetit ekonomik në vend është shoqëruar me rënie të mëtejshme të papunësisë, si në terma vjetorë ashtu edhe tremujorë, në nivelin prej 14.2% në fund të vitit. Në fund të periudhës, politika fiskale konsoliduese rezultoi në ngushtimin e ndjeshëm të deficitit buxhetor për vitin 2016. Financimi i deficitit u bë kryesisht nga fondet e huaja, duke ulur nevojën për huamarrje të qeverisë në tregun e brendshëm në krahasim me një vit më parë. Gjatë periudhës, politika monetare e ndjekur nga Banka e Shqipërisë vijoi të ishte lehtësuese, në përgjigje të presioneve të kontrolluara inflacioniste.

Në ***tregjet financiare***, normat mesatare të interesit për titujt e borxhit të qeverisë, si ata afatshkurtër ashtu edhe ata afatgjatë, shënuan rritje të lehtë, por rezultuan më të ulëta se një vit më parë. Në tregun ndërbankar, bankat kanë tregtuar në vëllime më të ulëta dhe me norma interesi që kanë qenë vazhdimisht nën ose pranë nivelit të normës bazë të interesit, duke reflektuar një situatë të qëndrueshme të likuiditetit. Në tregun e këmbimit të monedhave, gjatë periudhës, leku u mbiçmua ndaj monedhës evropiane dhe u nënçmua lehtë

[2] *FMN parashikon që rritja globale gjatë viteve 2017-2018 do të jetë në vlerat 3.4-3.6%.*

ndaj dollarit amerikan. Në terma vjetorë, leku u mbiçmua ndaj të dy valutave kryesore. Në vijim të rënies së normës së interesit dhe përmirësimit të cilësisë për kredinë për pasuri të paluajtshme, kushtet për përfitimin e kësaj kredie janë bërë më të favorshme dhe kanë mbështetur më mirë ecurinë e tregut të banesave. Kjo është evidentuar në ecurinë e çmimeve të banesave, ku vrojtimet tregojnë rritje të indeksit të çmimit dhe pritje disi më optimiste për zhvillimet në këtë treg në periudhën e ardhshme.

Gjatë periudhës, ***individët dhe bizneset*** vijuan orientimin e tyre drejt kursimeve neto, duke sjellë zgjerim të pozicionit kreditor të individëve dhe ngushtim të pozicionit debitor të bizneseve. Në këtë ecuri ka ndikuar rritja më e shpejtë e depozitave në valutë. Huamarrja nga ana e individëve u përshpejtua në 3.7% në terma vjetorë, e realizuar tërësisht në lekë. Cilësia e kredisë së individëve është përmirësuar gjatë periudhës. Përmirësimin më të madh e ka shënuar kredia në valutë dhe ajo e pambrojtur nga lëvizjet e pafavorshme në kursin e këmbimit. Kredia për bizneset, që përfaqëson gati 67% të totalit të kredisë, është zgjeruar me 2.4% në terma vjetorë, e drejtuar kryesisht drejt subjekteve jorezidente. Në strukturën e kredisë për bizneset, vërehet rritje e peshës së kredisë në lekë dhe rritja e preferencës për bizneset e vogla dhe të mesme. Edhe cilësia e kredisë për bizneset, është përmirësuar gjatë periudhës. Në tërësi, në përmirësimin e cilësisë së kredisë për individët dhe bizneset, ka kontribuar vijimi i procesit të largimit të kredive të humbura nga bilancet e bankave.

Gjatë periudhës, veprimtaria e ***sistemit financiar*** u zgjerua dhe treguesit e tjerë ishin përgjithësisht të qëndrueshëm. Sektori bankar përshpejtoi zgjerimin e veprimtarisë duke e ngjitur peshën e saj në 94.9% të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB). Ai rezultoi me fitim dhe me tregues të përshtatshëm të kapitalit dhe likuiditetit. Në aktivitetin e sektorit bankar, në terma vjetorë, ndryshimin më të madh në aktiv të bilancit e treguan veprimet me titujt (rritje), investimet e tjera (rritje), kreditimi (rritje) dhe fondet rezervë (rritje), ndërsa në pasiv të bilancit spikatën veprimet me thesarin dhe ndërbankare (rritje), depozitat (rritje) dhe burimet e përhershme (rritje). Në krahasim me një vit më parë, sektori bankar ka zgjeruar pozicionin kreditor me jorezidentët, si edhe ka rritur tepricën e kredisë me 2.5% dhe stokun e depozitave me 5.2%. Sektori jobankar ka ruajtur peshën e tij ndaj PBB-së, dhe në ecurinë e veprimtarisë së tij ka kontribuar zgjerimi i aktivitetit tek institucionet financiare jobanka dhe shoqëritë e sigurimit. Për sektorin jobankar, investimet në titujt e borxhit të qeverisë shqiptare janë të rëndësishme, ndonëse gjatë vitit 2016 këto investime kanë shënuar rënie. Ekspozimi i drejtpërdrejtë i sektorit jobankar në sektorin bankar vlerësohet i ulët, ndërkohë që qëndrueshmëria e sektorit bankar mbetet një faktor me rëndësi kritike për aktivitetin dhe qëndrueshmërinë e sektorit jobankar.

Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rreziqeve të veprimtarisë

Në lidhje me rreziqet e veprimtarisë me të cilat përballet sektori bankar, Banka e Shqipërisë vlerëson si më poshtë:

a) *Rreziku i kreditit shënoi ulje gjatë periudhës, duke mbetur sidoqoftë pranë niveleve të një viti më parë.* Vlera absolute e kredive me probleme u ul me 8% dhe raporti i kredive me probleme zbriti me 1.7 p.p., në nivelin 18.3%. Në uljen e kredive me probleme kanë ndikuar veprimet e bankave për mbledhjen, ristrukturimin dhe largimin e tyre (të kredive të humbura) nga bilancet. Ulja e kredive me probleme ka shfaqur një shpërndarje më të mirë sipas sektorëve, llojit të monedhës dhe bankave. Pakësimi i kredive me probleme është shoqëruar me përmirësimin e masës së mbulimit të tyre me fonde rezervë dhe me kapital, ndërkohë që niveli i kolateralizimit të kredisë ka mbetur i qëndrueshëm.

Pakësimi i vlerës së kredive me probleme gjatë periudhës, shpërndarja më e mirë e tyre dhe përmirësimi i treguesve të mbulimit të tyre janë zhvillime pozitive dhe inkurajuese. Ulja e kredive me probleme në sektorin bankar do të fitojë më shumë qëndrueshmëri nëse përmbushen pritjet për përmirësim të rritjes ekonomike dhe përmirësohet mënyra e funksionimit të të gjithë infrastrukturës institucionale e ligjore që përfshihet në proces. Sidoqoftë, duke konsideruar që faktorët përcaktues janë të larmishëm dhe përmbajnë pasiguri për mënyrën e zhvillimit, Banka e Shqipërisë nxit bankat të ruajnë fokusin në këtë proces kritik për rritjen e qëndrueshme të veprimtarisë së tyre, duke angazhuar burimet financiare dhe ekspertizën e nevojshme për uljen e kredive me probleme. Kryerja e një analize sa më profesionale në fazën e dhënies së kredisë, monitorimi efektiv i saj dhe ristrukturimi i drejtë, janë veprime themelore për uljen e probabilitetit të dështimit të kredimarrësit (dhe uljen e fluksit të kredive me probleme), ndërkohë që veprimet e provigjionimit, ekzekutimit të detyrimit dhe largimit nga bilanci të kredive të humbura, duhet të kontribuojnë paralelisht në njohjen e shpejtë dhe uljen e stokut të kredive me probleme.

b) *Rreziku i likuiditetit në veprimtarinë bankare vlerësohet i ulët.* Vlera e ulët e raportit të kredive ndaj depozitave, vijimi i rritjes së depozitave dhe prania e lartë e aktiveve likuide mbi kërkesat minimale të kuadrit rregullator, tregojnë për një situatë të mirë të gjendjes së likuiditetit të sektorit bankar, në tërësi dhe sipas monedhave kryesore. Gjatë periudhës, mbulimi i detyrimeve afatshkurtra me aktive likuide ka njohur një rënie të lehtë, por për sa kohë ato mbeten ndjeshëm mbi nivelet minimale të kërkuara nga kuadri rregullativ, ky zhvillim duhet të reflektojë një përdorim më eficient të burimeve financiare nga ana e sektorit bankar. Gjendja e mirë e likuiditetit të sektorit është provuar edhe nëpërmjet një ushtrimi të posaçëm të provës së rezistencës, mbështetur në të dhënat e muajit nëntor 2016.

Kapacitetet e likuiditetit të sektorit bankar sipas monedhave, krahas përshtatshmërisë së nivelit të aktiveve likuide të vetë bankave, duhet të vlerësohen edhe në përputhje me aftësinë e tij për të shndërruar aktivet likuide në para, menjëherë dhe pa kosto të rëndësishme. Për monedhën

kombëtare, në rast nevoje, ky proces lehtësohet përmes operacioneve përkatëse të bankës qendrore me bankat, sipas përcaktimeve ligjore dhe në përputhje me standardet më të mira. Në rast se do të duhej që këto instrumente të përshtateshin edhe për valutën, kjo do të kërkonte rritjen e burimeve në valutë të bankës qendrore. Ky proces, në rastin e një vendi në zhvillim, siç është Shqipëria, përmban kosto për bankën qendrore. Si rregull, pa konsideruar faktorë të tjerë, kapacitetet likuide të sektorit bankar janë më të mira në monedhën vendase sesa në monedhë të huaj, ndaj rreziku i likuiditetit në valutë është më i lartë së rreziku i likuiditetit në monedhën vendase. Për këto arsye, është e nevojshme që kjo të reflektohet në kërkesën ndaj bankave për një nivel më të lartë të aktiveve likuide në valutë, në krahasim me atë për aktivet likuide në monedhën vendase. Në një këndvështrim më afatgjatë, ulja e aktivitetit në valutë të bankave do të pakësonte këtë burim rreziku dhe do të kontribuonte pozitivisht në stabilitetin financiar.

c) *Sektori bankar mbetet i ekspozuar në mënyrë të ndjeshme ndaj rrezikut të tregut (ku përfshihen rreziku i kursit të këmbimit dhe ai i normës së interesit), pavarësisht uljes së madhësisë së ekspozimit gjatë periudhës.*

Ndonëse pozicioni i hapur valutor në bilanc mbetet pranë niveleve historike dhe kredia në valutë e pambrojtur nga lëvizjet e pafavorshme të kursit të këmbimit zë një peshë më të ulët në tepricën e kredisë, përsëri kjo e fundit konsiderohet në nivele të larta dhe ekspozimi i sektorit bankar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit është i rëndësishëm. Rritja e depozitave në valutë të sektorit bankar, në kushtet e ngushtimit të diferencës mes normës mesatare të interesit të lekut dhe atyre të valutave kryesore, mban me vete potencialin që ajo të kanalizohet në kredi në valutë (ku një pjesë e konsiderueshme do të ishte përsëri e pambrojtur nga kursi i këmbimit) nëse kërkesa për kredi forcohet. Kjo do të tjetërsonte prirjen rënëse të kredisë në valutë në vitet e fundit. Procesi është në vetvete përforcues pasi, përmes procesit të krijimit të parasë, kredia në valutë ndikon në zgjerimin e depozitave në valutë, e kështu në vijim. Nëse kjo prirje do të materializohej, ngushtimi i kanalit të kreditimit në monedhën vendase dhe rritja e ndjeshmërisë së sektorit bankar dhe agjentëve ekonomikë ndaj lëvizjeve të kursit të këmbimit, do të cenonin aftësinë e politikës monetare të bankës qendrore për të përdorur efektivisht kanalet e transmetimit të saj.

Ndaj, edhe në këtë rast, duke konsideruar faktorët që kanë çuar në nivelet e larta të euroizimit në sektorin bankar dhe duke vlerësuar me përparësi rreziqet që ai sjell për stabilitetin financiar dhe për efektivitetin e politikës monetare, është e nevojshme që krahas vëmendjes për të ruajtur pozicione sa më të ekuilibruara në valutë në bilancin e bankave dhe të agjentëve ekonomikë, të synohet që, përmes një strategjie të qëndrueshme dhe me objektiva afatgjatë e realistë, niveli i euroizimit në sistemin financiar të ulet në nivele më të përshtatshme. Në këtë kuadër, Banka e Shqipërisë po vlerëson nevojën për veprime konkrete

që do të synojnë të ruajnë një diferencë të përshtatshme pozitive mes normës mesatare të lekut dhe atyre të valutave kryesore, si edhe që do të forcojnë ndërgjegjësimin e kredimarrësve për rreziqet që shoqërojnë huamarrjen e pajustifikuar në valutë. E vetëdijshme për kompleksitetin e fenomenit, Banka e Shqipërisë do të kërkojë për këtë qëllim edhe bashkëpunimin e autoriteteve të tjera publike.

Përsa i takon rrezikut të normës së interesit, ai paraqitet më i zbutur, por mbetet i pranishëm në veprimtarinë bankare, si në formën e tij të drejtpërdrejtë, ashtu edhe në atë të tërthortë. Në formën e tij të drejtpërdrejtë, rreziku përcillet nëpërmjet hendekut që ekziston midis aktiveve dhe pasiveve të sektorit bankar sipas periudhave të riçmimit, dhe ndjeshmërisë që shfaqin aktive të caktuara ndaj lëvizjeve në normën e interesit. Ky hendek është negativ, por është ulur disi gjatë periudhës. Rreziku do të materializohej në rastin e një rritjeje të normës së interesit, e cila, për shkak të hendekut negativ do të ndikonte më shpejt kostot e veprimtarisë së bankës në krahasim me të ardhurat e saj. Krahas kësaj, rritja e supozuar e normës së interesit do të ndikonte negativisht (dhe fillimisht) në vlerën e aktiveve të bankave të ndjeshme ndaj lëvizjeve në normën e interesit, siç janë titujt e ndryshëm afatgjatë. Ky rrezik ka edhe një komponent të tërthortë, që lidhet me efektin negativ që ka rritja e normës së interesit tek huamarrësit, që kanë një kredi me normë interesi të ndryshueshme. Edhe në këtë rast, është e nevojshme që bankat të vlerësojnë në mënyrë sasiore ndikimin e skenarëve të pafavorshëm dhe të veprojnë për kontrollin e ekspozimit ndaj rrezikut. Ndërkohë, rreziku i normës së interesit mbetet veçanërisht i nevojshëm për t'u vlerësuar në veprimtarinë e shoqërive të sigurimit të jetës, të fondeve të investimit dhe të fondeve private suplementare të pensionit.

ç) *Sistemet e bankave për vlerësimin dhe kontrollin e rrezikut operacional kanë nevojë të përmirësohen.*

Ndonëse raportimet e bankave tregojnë një përmirësim të mbulimit me kapital të rreziqeve tërësore operacionale, veprimtaria mbikëqyrëse e Bankës së Shqipërisë ka evidentuar nevojën e përmirësimit të mëtejshëm të procesit për identifikimin dhe raportimin e humbjeve operacionale në përputhje me profilin e aktivitetit të bankës. Gjithashtu, në përgjigje të cenimit të sigurisë fizike në veprimtarinë e transportimit të fondeve gjatë vitit të kaluar, Banka e Shqipërisë, ka forcuar kërkesat minimale në aktet përkatëse rregullative, kryesisht në drejtim të planifikimit, hartimit, monitorimit dhe mbikëqyrjes së zbatueshmërisë së procedurave, nga njësitë e posaçme të sigurisë në banka. Në kuadër të kësaj çështjeje, gjatë vitit 2016, Banka e Shqipërisë ka pasur bashkëpunim të vazhdueshëm me Policinë e Shtetit, duke kontribuar në përmirësimin e akteve nënligjore për transportin e vlerave monetare. Në vijim, Banka e Shqipërisë do të forcojë fokusin e vlerësimit të përshtatshmërisë së sistemeve të bankave për kontrollin e rrezikut operacional, si pjesë e inspektimeve të rregullta pranë subjekteve të mbikëqyrura.

d) *Tkurrja e aktivitetit tek disa nga grupet bankare evropiane që veprojnë në vendin tonë ruan stimujt për ristrukturimin e veprimtarisë, duke përfshirë edhe ndryshimin e rrjetit të tyre në vendet jashtë Bashkimit Evropian.*

Ky proces ka qenë më i dukshëm në vende të Evropës Qendrore dhe në Ballkan, dhe Shqipëria deri tani ka qenë relativisht e paprekur. Përvoja e vendeve të tjera, tregon që nëse procesi koordinohet mirë mes të gjitha palëve të interesuara, dalja e një grupi bankar nga një treg i caktuar mund të shoqërohet me hyrjen në treg të investitorëve të tjerë të vlefshëm, të cilët mund të sjellin kapacitete shtesë dhe përparësi të tjera në sektorin bankar lokal. Këto ndryshime, mund të japin një efekt pozitiv në strukturën e sektorit bankar dhe të sistemit financiar dhe të rrisin kontributin e tij në mbështetjen e rritjes ekonomike. Procesi përmban edhe pasiguri, të cilat lidhen me fazën në të cilën gjendet aktualisht cikli ekonomik dhe ai financiar në Bashkimin Evropian dhe në rajon, dhe me potencialin që kanë vendet e rajonit për të gjeneruar interes tek investitorë të rinj dhe të vlefshëm. Është e vështirë të përcaktohet në ç'masë dhe në ç'mënyrë ky proces mund të prekë filialet shqiptare të grupeve bankare evropiane. Në çdo rast, Banka e Shqipërisë dhe autoritetet e tjera në vend do të forcojnë kapacitetet monitoruese, vlerësuese dhe bashkëpunimin mes tyre, në mënyrë që proceset të zhvillohen në përputhje me kërkesat ligjore dhe objektivin final të ruajtjes së stabilitetit të sistemit financiar.

Rreziqet për stabilitetin financiar

Për vlerësimin e rreziqeve sistemike është analizuar ecuria e treguesve që lidhen me materializimin dhe me akumulimin e rrezikut sistemik, me nivelin e stresit në sistemin financiar dhe me perceptimin e industrisë bankare lidhur me ekspozimin e veprimtarisë bankare ndaj rrezikut sistemik. Gjithashtu, harta e stabilitetit financiar synon të realizojë një qasje të konsoliduar të vlerësimit për rreziqet ndaj stabilitetit financiar.

Në tërësi, indekset nuk tregojnë një rritje të rreziqeve për stabilitetin financiar gjatë periudhës. Ulja e fitimit të sektorit bankar dhe rënia e lehtë e treguesve të likuiditetit (që mbeten gjithsesi në nivele të larta) janë ekuilibruar nga zhvillimet më pozitive për ekonominë reale, në drejtim të përmirësimit të rritjes ekonomike dhe situatës financiare të individëve dhe të bizneseve. Akumulimi i rreziqeve ka qenë më i dobët për shkak të tkurrjes së kredisë në valutë, përmirësimit të treguesve të borxhit publik dhe ecurisë më pozitive të tregut të banesave. Nga ana tjetër, probabiliteti i materializimit të rrezikut sistemik ka rënë, në kushtet kur është përmirësuar treguesi i cilësisë së kredisë, ka rënë niveli i papunësisë dhe luhatshmëria në kursin e këmbimit ka qenë e ulët.

Aftësia e sektorit bankar për të përballuar rreziqet

Aftësia e sektorit bankar për të përballuar rreziqet, vlerësohet duke analizuar gjendjen e tij të kapitalizimit dhe të përfitueshmërisë, si edhe duke i stresuar këta tregues nëpërmjet ushtrimit të provës së rezistencës.

Në fund të periudhës, raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit të sektorit bankar shënoi nivelin 15.7%, duke qenë dukshëm mbi nivelin minimal të kërkuar për këtë tregues prej 12%. Kjo ecuri e treguesit u përcaktua nga rritja e aktiveve të ponderuara me koeficientët e rrezikut me gati 4.3% (ndikim në rënie mbi treguesin) dhe rritja e vlerës së kapitalit rregullator me gati 3.8% (ndikim në rritje mbi treguesin). Treguesi i levës financiare, i matur si raport i totalit të aktiveve mbi kapitalin aksioner, shënoi 10.3 herë dhe vlerësohet si një nivel mjaft i mirë. Ruajtja e pozicionit të mirë të kapitalit përcaktohet edhe nga ecuria e rezultatit financiar të sektorit. Gjatë vitit 2016, fitimi i sektorit bankar vlerësohet në rreth 9.3 miliardë lekë dhe është më i ulët se një vit më parë. Në rënien e madhësisë së fitimit, kanë ndikuar rënia e të ardhurave neto nga interesat dhe rritja e fondeve rezervë për rrezikun e kreditit. Rënia e të ardhurave neto nga interesat ka reflektuar rënien e normave të kthimit nga investimet, për instrumentet financiare në valutë dhe në lekë, me ritme më të shpejta se rënia e shpenzimeve për to. Rritja e fondeve rezervë për rrezikun e kreditit, ka reflektuar lëvizjen e kredive me probleme drejt kategorive më ekstreme të klasifikimit. Treguesit e rentabilitetit të sektorit, kthimi mbi aktivet (RoA) dhe kthimi mbi kapitalin (RoE) rezultuan përkatësisht 0.7% dhe 7.2%.

Përshtatshmëria e treguesve të mësipërm, është provuar gjatë ushtrimit të provës së rezistencës, me skenarë që supozonin ndryshime të pafavorshme në treguesit makroekonomikë dhe financiarë për periudhën 2017-2018. Si pjesë e supozimeve ekstreme, por me një probabilitet të ulët ndodhjeje, në skenarin e rënduar përfshiheshin tkurrja e ekonomisë, tkurrja e kredisë, rritja e shpejtë e normave mesatare të interesit dhe nënçmimi i fortë i kursit të këmbimit. Rezultatet e ushtrimit të provës së rezistencës treguan që në skenarin bazë dhe atë të moderuar, sektori bankar mbetet i kapitalizuar, por do të kishte nevojë të rriste kapitalin në skenarin e rënduar. Kërkesa për kapital shtesë për banka të veçanta, shfaqet që në skenarin e moderuar.

Mbështetur në këtë analizë, Banka e Shqipërisë vlerëson se gjendja e kapitalizimit dhe e përfitueshmërisë së bankave paraqitet e përshtatshme për të përballuar rreziqet e veprimtarisë. Sidoqoftë, ndjeshmëria ndaj rreziqeve është specifike për çdo bankë, në varësi të profilit të saj të veprimtarisë dhe kapaciteteve për të përballuar rreziqet. Për këto arsye, Banka e Shqipërisë rithekson nevojën për vlerësimin e rregullt të këtyre rreziqeve nga secila bankë, ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për uljen e tyre dhe ruajtjen e treguesve të kapitalizimit të veprimtarisë.

Në vijim, do të gjeni më të detajuar përmbajtjen e raportit të stabilitetit financiar për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2016.

1. VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM I RREZIQEVE KRYESORE TË STABILITETIT FINANCIAR

Harta e stabilitetit financiar tregon mënyrën se si është shpërndarë rreziku tek faktorët që përcaktojnë stabilitetin e sistemit financiar, të cilët përfshijnë veprimtarinë e vetë sektorit bankar dhe mjedisin ekonomik rrethues të brendshëm e të jashtëm.

(1) Për fundin e vitit 2016, harta e stabilitetit financiar tregon një rritje të lehtë të rrezikut të veprimtarisë bankare dhe një ulje të tij për rreziqet që mund të vijnë nga mjedisi ekonomik rrethues. Në një analizë ku zhvillimet shihen si të veçuara, vlera e treguesve sugjeron që rreziku për kategoritë e "individëve" dhe "ekonomisë së brendshme", si pjesë e mjedisit ekonomik rrethues, ka ardhur në rënie, si rezultat i zhvillimeve pozitive në ecurinë e treguesve makroekonomikë dhe financiarë gjatë periudhës. Në të kundërt, treguesit e veprimtarisë bankare, që lidhen me "kapitalizimin dhe përfitueshmërinë" dhe "likuiditetin dhe financimin", kanë rënë lehtë, duke sugjeruar një rritje të rrezikut.

(2) Megjithatë, duke konsideruar ndërveprimin e kategorive përbërëse të hartës, ecuria e treguesve të sektorit bankar mund të reflektojë më shumë lëvizjen drejt përmirësimit të eficiencës së veprimtarisë së tij. Në fakt, kjo rënie e treguesve të veprimtarisë të sektorit bankar, veçanërisht e atij të likuiditetit, ndodh në kushtet e qenies së tyre në nivele të larta dhe reflekton më shumë një përmirësim të eficiencës së sektorit bankar, si rezultat i një roli më aktiv në drejtim të kreditimit të ekonomisë. Nëse supozohet vijimi i kësaj prirjeje, përmirësimi i mëtejshëm i mjedisit ekonomik rrethues i reflektuar, për shembull, në formën e përshpejtimit të rritjes ekonomike dhe uljes së mëtejshme të papunësisë, do të shoqërohet me rritjen e gatishmërisë së sektorit bankar për të mobilizuar edhe më shumë burime financiare në procesin e kreditimit, duke rritur presionin për rënien e mëtejshme të treguesve të tij të likuiditetit. Nga ana tjetër, përdorimi më efektiv i burimeve të sektorit bankar në procesin e ndërmjetësimit, duhet të ndikojë pozitivisht në performancën financiare të sektorit në afat më të gjatë dhe të kontribuojë në ruajtjen e qëndrueshme të niveleve të kapitalizimit të veprimtarisë.

Grafik 1.1 Harta e stabilitetit financiar



* Rreziku vlerësohet: i ulët për notat 0-3 në hartë, mesatar për notat 4-5, i moderuar për notat 6-8 dhe i lartë për notat 9-10. Lëvizja drejt skajeve të hartës, larg qendrës, nënkupton rritje të rrezikut.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në krahasim me dhjetorin 2015, për përbërësit e ekonomisë reale veçojmë:

- për "ekonominë e brendshme", rreziku vlerësohet "i ulët". Rënia e rrezikut regjistrohet në të gjitha nënkategoritë, por kontribut kryesor jepet nga plotësimi i nevojave për financim nga burime të jashtme, nga ngushtimi i hendekut të prodhimit dhe nga luhatshmëria e ulët e kursit të këmbimit;
- rreziku për "individët", vlerësohet "mesatar" dhe në rënie, mbështetur nga ulja e normës së papunësisë, rritja e dërgesave të emigrantëve, përmirësimi i zhvillimeve në kredi dhe në cilësinë e saj.
- rreziku për "bizneset", vlerësohet sërish "i moderuar" dhe në rritje përgjatë periudhës, në kushtet e zhvillimeve të "indeksit të volumit të prodhimit" poshtë prirjes afatgjatë të vitit 2016;
- për "qeverinë", niveli i rrezikut vijon të vlerësohet "i ulët", me prirje rënëse, ku ngushtimi i ndjeshëm i deficitit buxhetor ka dhënë kontributin kryesor;
- së fundi, rreziku që vjen nga "mjedisi i jashtëm ekonomik" vlerësohet "mesatar", por në rritje përgjatë periudhës, duke reflektuar rritjen e çmimit të naftës në tregjet e huaja dhe të normave afatshkurtra të interesit në nivel ndërkombëtar.

Për përbërësit e "sektorit bankar" veçojmë:

- niveli i rrezikut për "kapitalizimin dhe përfitueshmërinë", vlerësohet "i moderuar", por në rritje, në kushtet e rënies në të ardhurat neto nga interesat dhe të rezultatit financiar të sektorit bankar;
- rreziku nga "likuiditeti dhe financimi" vlerësohet "mesatar" dhe sërish në rritje. Ky zhvillim reflekton thellimin e hendekut midis aktiveve dhe pasiveve të bankave me afat deri në 3 muaj[3];
- së fundi, vlerësimi i rrezikut që lidhet me "strukturën e sektorit bankar" vijon të mbetet në nivelin "i ulët", në vijim të diversifikimit më të mirë të fondeve të financimit të sektorit bankar dhe të përmirësimit të treguesit të RMK-së për bankat, të cilat kanë normë të kapitalizimit poshtë nivelit mesatar të sektorit. Megjithatë, përqendrimi i kredisë brenda sektorit të biznesit është disi më i lartë.

Hapësira informuese 1.1 paraqet të gjithë përbërësit e kategorive të Hartës së Stabilitetit Financiar gjatë vitit 2016, vlerësimet me "notë" për nivelin e rrezikut për secilin përbërës dhe krahasimin me vlerësimin e fundit të vitit 2015.

[3] *Brenda kësaj kategorie e cila përgjithësisht është vlerësuar me rrezik të ulët, ky kapërcim është rrjedhojë e ndryshimit të përkufizimit të vetë termit për qëllime të analizave më të hollësishme nga autoriteti mbikëqyrës.*

HAPËSIRË INFORMUESE 1.1. PËRBËRËSIT E HARTËS SË STABILITETIT FINANCIAR

Rreziku nga "ekonomia e brendshme" vlerësohet "i ulët" dhe në rënie, në vijim të përmirësimit të hendekut të prodhimit, nevojave për financim të jashtëm dhe qëndrueshmërisë së kursit të këmbimit.

EKONOMIA E BRENDSHME, T4-2016



Rreziku për "individët" është "mesatar" dhe në rënie, si rrjedhojë e përmirësimit në treguesit ekonomikë dhe financiarë të tyre.

INDIVIDËT, T4-2016



Rreziku për "bizneset", vlerësohet "i moderuar", dhe me rritje në reflektim të përkeqësimit të indeksit të volumit të prodhimit poshtë prirjes afatgjatë.

BIZNESET, T4-2016



Rreziku që vjen nga "qeveria" vlerësohet i "ulët" dhe në rënie, ku ngushtimi i deficitit buxhetor në terma vjetorë ka dhënë kontributin kryesor.

QEVERIA, T4-2016



Rreziku nga "mjedisi i jashtëm" rezulton i rritur ndaj fundit të vitit 2015, ku çmimet e naftës dhe ecuria e normaveafatshkurtra ndërkombëtare kanë dhënë kontributin e tyre.

MJEDISI I JASHTËM, T4-2016



Niveli i rrezikut nga "kapitali dhe përfitueshmëria" vlerësohet "i moderuar" dhe në rritje, si rrjedhojë e rënies së të ardhurave neto nga interesi dhe fitimit neto të bankave.

KAPITALI DHE PERFITUESHMERIA,T4-2016



Rreziku që vjen nga "financimi dhe likuiditeti" ka rezultuar sërish "mesatar", por me prirje rritëse nga thellimi i hendekut midis aktiveve dhe pasiveve afatshkurta deri në 3 muaj.

FINANCIMI DHE LIKUIDITETI, T4-2016



Rreziku që lidhet me "strukturën e sektorit bankar" ka vijuar të jetë i ulët, në kushtet e rritjes së diversifikimit të fondeve të financimit të tij dhe të nivelit të RMK-së ndaj minimumit rregullator.

STRUKTURA E SEKTORIT BANKAR, T4-2016



Burimi: Departamenti i Stabilitetit Financiar, Banka e Shqipërisë.

1.1 RREZIKU SISTEMIK[4]

Për vlerësimin e ekspozimit të sektorit bankar ndaj rrezikut sistemik, analizohet ecuria e treguesve që lidhen me materializimin dhe me akumulimin e rrezikut sistemik, me nivelin e stresit në sistemin financiar dhe me perceptimin e industrisë bankare lidhur me ekspozimin e veprimtarisë së saj ndaj rreziqeve sistemike. Indeksi i materializimit të rrezikut sistemik ofron një vlerësim lidhur me nivelin aktual të rrezikut, ndërsa indekset e akumulimit të rrezikut, të stresit financiar dhe të perceptimit të industrisë bankare rreth tij, fokusohen kryesisht drejt të ardhmes.

(3) Ecuria e indekseve të akumulimit dhe të materializimit të rrezikut sistemik, si edhe të stresit financiar, tregojnë për nivele më të zbutura të rrezikut sistemik. Kështu, tkurrja e kredisë në valutë si edhe rënia e borxhit publik dhe e borxhit të jashtëm, kanë zbutur akumulimin e rrezikut sistemik në kushtet e rritjes së moderuar të çmimeve të banesave në fund të vitit 2016. Nga ana tjetër, përmirësimi i cilësisë së kredisë për individët dhe bizneset, rënia e nivelit të papunësisë në vend, si dhe ulja e luhatshmërisë në ecurinë e kursit të këmbimit, kanë ulur materializimin e rrezikut sistemik krahasuar me një vit më parë (Grafik 1.2). Në uljen e indeksit të stresit financiar, kanë ndikuar zbutja e presioneve nënçmuese në kursin e këmbimit dhe zhvillimet pozitive në ecurinë e depozitave (Grafik 1.3).

Grafik 1.2. Akumulimi dhe materializimi i rrezikut sistemik



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

Grafik 1.3. Indeksi i Stresit Financiar



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

(4) Perceptimi i industrisë bankare mbi rreziqet e veprimtarisë, paraqitet i ngjashëm me periudhën e kaluar. Kështu, 'Përkeqësimi i ekonomisë së brendshme' vijon të konsiderohet si rreziku kryesor sistemik në vend, por perceptimi i sektorit bankar mbi nivelin e rëndësisë së tij ka rezultuar në rënie

[4] *Rreziku sistemik përcaktohet si "mundësia e materializimit të goditjeve që dëmtojnë funksionimin e sistemit financiar deri në masën që rritja ekonomike dhe mirëqenia të ndikohen në mënyrë materiale".*

gjatë periudhës, duke kaluar nga vlerësimi 'i lartë' në 'mesatar'. Vëmendja e bankave ndaj rrezikut që lidhet me 'ekzekutimin e kolateraleve' vazhdon të mbetet e lartë, dhe perceptimi mbi të nuk ka ndryshuar gjatë periudhës. Kjo reflekton jo vetëm rëndësinë që ruan procesi ligjor i ekzekutimit të kolateraleve si një instrument i domosdoshëm për trajtimin e kredive me probleme, por edhe vlerësimin e bankave për problematikën që ende e shoqëron atë. Vlerësimi i bankave lidhur me 'rrezikun e goditjeve nga jashtë' ka qenë në rritje për banka të caktuara, kryesisht i ndikuar nga zhvillimet e periudhës në sektorin bankar italian. Gjithsesi, në nivel sektori, perceptimi mbi këtë rrezik ka mbetur i ulët (Grafik 1.4).

Grafik 1.4 Vlerësimi i bankave mbi rreziqet kryesore sistemike



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

2. ZHVILLIMET NDËRKOMBËTARE

(5) Zhvillimet në ekonominë botërore gjatë periudhës ishin përgjithësisht pozitive, pavarësisht ndryshimeve mes rajoneve dhe ekonomive më të mëdha, në vijim të dallimeve në politikat ekonomike. Çmimet e naftës janë rikuperuar gjatë fundit të vitit, duke ofruar një mbështetje më të mirë për ekonomitë e vendeve eksportuese. Aktiviteti ekonomik botëror është rritur pozitivisht dhe me ritëm më të përmirësuar gjatë gjysmës së dytë të vitit 2016, mbështetur kryesisht nga kushtet e favorshme të financimit në tregje, vijimi i politikave stimuluese në shumicën e vendeve të zhvilluara dhe në disa vende në zhvillim, dhe stabilizimi i çmimeve të naftës. FMN-ja ka vlerësuar një rritje globale prej 3.1% për vitin 2016, e cila pritet të përmirësohet gradualisht gjatë dy viteve në vazhdim[5]. Pavarësisht kësaj, diferencat mes rajoneve kanë qenë të ndjeshme, ku ecuria ekonomike e vendeve të zhvilluara rezultoi më pozitive se pritjet, ndërsa presionet ndaj një pjese të vendeve në zhvillim kanë qenë në rritje, ndikuar nga faktorë të brendshëm dhe të jashtëm. Zhvillimet në tregjet financiare reflektuan divergjencat e politikës monetare në vendet e zhvilluara[6] dhe pritjet për ndryshim të politikës fiskale të SHBA-së pas zgjedhjeve të nëntorit 2016. Kthesa në politikën monetare të SHBA-së shkaktoi shtrëngim të kushteve të financimit gjatë fundit të vitit, veçanërisht në tregjet financiare të rajoneve në zhvillim. Presionet inflacioniste në nivel global janë rritur disi, ndikuar nga stabilizimi i çmimit të naftës dhe lëndëve të para.

(6) Aktiviteti ekonomik i vendeve të zhvilluara rikuperoi me një ritëm më të mirë se pritjet, ndërsa në vendet në zhvillim ecuria ekonomike ishte e ndryshme. Mes vendeve të zhvilluara, ekonomia e SHBA-së është përmirësuar ndjeshëm gjatë gjysmës së dytë të vitit krahasuar me ecurinë më të dobët në gjysmën e parë të tij. Rritja ekonomike u mbështet kryesisht nga rritja e shpenzimeve konsumatore dhe kontributi pozitiv i eksporteve neto. Kushtet në tregun e punës vijojnë të stabilizohen dhe norma e papunësisë në fund të vitit ra në nivelin 4.7%. Ekonomia e Mbretërisë së Bashkuar (në vijim MB), pavarësisht pritjeve pesimiste të nxitura nga Brexit, shënoi rritje pozitive mbështetur nga rritja e konsumit dhe e eksporteve. Gjithsesi, pasiguria lidhur me marrëdhëniet e reja tregtare mes Mbretërisë së Bashkuar dhe Bashkimit Evropian pas realizimit të Brexit dhe nënçmimi i paundit britanik, ruan pasiguri të rëndësishme lidhur me ecurinë e investimeve dhe të kërkesës së brendshme. Në vendet në zhvillim, ecuria ekonomike ka qenë e ndryshme, e ndikuar nga faktorë ekonomikë të brendshëm e të jashtëm, tensione gjeopolitike në rajone të caktuara dhe

[5] *Parashikimi i muajit janar 2017.*

[6] *Siç pritej, në dhjetor 2016, Rezerva Federale rriti normën e interesit të fondeve federale me 25 pikë bazë, duke sinjalizuar një kthesë në drejtim të politikës monetare ultra të lirshme, ndërsa politika monetare tepër e lirshme në vende të tjera të zhvilluara mbeti e pandryshuar.*

ecuria e çmimeve të naftës e të lëndëve të para. Kështu, aktiviteti ekonomik në Kinë rezultoi më i mirë se pritjet, kryesisht për shkak të politikave stimuluese ekonomike. Në vende të tjera, si vendet e Amerikës Latine (Argjentinë, Brazil, Meksikë), Turqi etj., aktiviteti ekonomik ka rezultuar në rënie. Nga ana tjetër, vendet prodhuese të naftës si Rusia, janë ndikuar pozitivisht nga stabilizimi i çmimit të saj në tregje.

(7) Ekonomia e Eurozonës është zgjeruar me ritme të moderuara, por të qëndrueshme gjatë tremujorit të tretë të vitit 2016, dhe të dhënat paraprake sugjerojnë të njëjtën prirje dhe gjatë tremujorit të fundit të vitit. Aktiviteti ekonomik i Eurozonës është zgjeruar në shumicën e vendeve të këtij rajoni, mbështetur kryesisht nga përmirësimi i kërkesës së brendshme dhe kontributi pozitiv i inventarëve në sektorin privat. Nga ana tjetër, tregtia ka pasur kontribut negativ, duke reflektuar dobësimin e kërkesës së jashtme. Gjithsesi, nënçmimi i euros që nga tremujori i tretë i vitit 2016, pritet të ndikojë pozitivisht eksportet e Eurozonës në vazhdim. Kushtet në tregun e punës janë përmirësuar, duke mbështetur pozitivisht konsumin. Punësimi është rritur duke u afruar më tej me nivelet e parakrizës, ndërkohë që norma e papunësisë në fund të vitit ka shënuar 9.6%.

(8) Në sektorin bankar në Eurozonë, kredidhënia vijon të rikuperohet me ritëm të moderuar, duke iu përgjigjur ecurisë së kërkesës për kredi. Politika monetare akomoduese e Bankës Qendrore Evropiane (BQE) ka nxitur lehtësimin e standardeve të kreditimit gjatë gjysmës së dytë të vitit 2016. Kredidhënia ndaj sektorëve të biznesit dhe familjeve shënoi rritje pozitive në terma vjetorë. Kërkesa për kredi është përforcuar dhe është mbështetur nga disa faktorë, ku përfshihen rënia e normave të interesit në nivele historikisht të ulëta, rritja e aktivitetit të rifinancimit të huave nga bankat, zhvillimet pozitive në tregun e pasurive të paluajtshme dhe rritja e besimit të konsumatorëve. Nga ana tjetër, bankat evropiane kanë përmirësuar pozicionet e kapitalit dhe kanë pakësuar nivelet e borxhit. Gjithsesi, tejzgjatja e procesit të konsolidimit të bilanceve dhe niveli ende i lartë i kredive me probleme në disa prej vendeve të Eurozonës, vazhdon të luajë një rol frenues në rigjallërimin e kredisë.

(9) Ecuria pozitive e ekonomisë botërore pritet të vazhdojë në periudhën 2017-2018[7], e mbështetur nga vijimi i rritjes graduale ekonomike në vendet e zhvilluara dhe forcimi i kontributit pozitiv nga ecuria ekonomike e vendeve në zhvillim. Por zhvillimet politike, veçanërisht në SHBA dhe Eurozonë, vlerësohen aktualisht si faktorët kryesorë që mund të ndikojnë mbi pritshmëritë për ecurinë e ekonomisë botërore. Peshën kryesore në rritjen ekonomike globale pritet ta kenë rajonet në zhvillim, ekonomia e të cilave parashikohet të përmirësohet gjatë dy viteve në vazhdim. Vendet e zhvilluara do të vijojnë të rikuperohen gradualisht. Megjithatë, ndryshimet e mundshme politike në SHBA, në vendet e Eurozonës, dhe procesi i Brexit, mund të diktojnë ndryshim të drejtimit të politikave ekonomike dhe të shoqërohen me lëkundje të

[7] *FMN parashikon që rritja globale gjatë viteve 2017-2018 do të jetë në vlerat 3.4-3.6%.*

raporteve tregtare dhe të kurseve të këmbimit të monedhave, gjë që mund të intensifikojë presionet proteksioniste. Forcimi i barrierave ndaj tregtisë globale dhe emigracionit mund të dëmtojë produktivitetin dhe të ardhurat në nivel global, duke lëkundur gjithashtu pritjet e investitorëve dhe të tregjeve. Nga ana tjetër, dobësitë strukturore makroekonomike në disa prej vendeve në zhvillim dhe procesi ende i papërfunduar i konsolidimit të bilanceve të sistemit financiar në disa prej vendeve të zhvilluara, përfaqësojnë rreziqe të mundshme shtesë ndaj ecurisë së ekonomisë botërore.

(10) Ekonomia e Eurozonës pritet të vazhdojë të zgjerohet me ritëm të moderuar, por të qëndrueshëm. Transmetimi i politikës monetare të BQE-së në ekonominë reale do të mbështesë kërkesën e brendshme dhe do të lehtësojë procesin e konsolidimit të bilanceve të sektorit privat e shtetëror. Nga ana tjetër, kushtet e favorshme të financimit dhe rritja e përfitueshmërisë në sektorin privat do të stimulojë rritjen e investimeve. Gjithashtu, përmirësimi i kushteve në tregun e punës do të vazhdojë të kontribuojë pozitivisht në rritjen e konsumit privat përmes rritjes së të ardhurave të disponueshme të familjeve. Aktualisht, rreziqet ndaj pritjeve për ecurinë ekonomike të Eurozonës lidhen me faktorë të brendshëm e të jashtëm, siç janë politikat e administratës së re të SHBA-së, arritja e marrëveshjes me Mbretërinë e Bashkuar në procesin Brexit dhe pasiguritë që lidhen me zgjedhjet politike në disa vende të Eurozonës.

Tabela 2.1 Disa tregues makroekonomikë për SHBA-në dhe Eurozonën

	Ndryshimi i PBB-së (% vjetore)				Inflacioni (% vjetore)		Papunësia (% vjetore)		Borxhi bruto i qeverisë (% PBB)	
	T3'16	T4'16	2016p	2017p	Qer'16	Dhj'16	Qer'16	Dhj'16	T2'16	T3'16
SHBA	1.7	1.9	1.6	2.3	1.1	1.8	4.9	4.7	105.05	104.81
Eurozonë	1.8	1.7	1.7	1.6	0.1	1.2	10.1	9.6	91.2	90.1
- Gjermani	1.7	1.8	1.7	1.5	0.2	1.7	4.2	3.9	70.2	6.9.4
-Francë	0.9	1.1	1.3	1.3	0.3	0.8	10.0	9.6	98.3	97.5
-Itali	1.1	1.1	0.9	0.7	-0.2	0.5	11.6	12.0	135.5	132.7
-Greqi	2.2	0.3	:	:	0.2	0.3	23.4	23.0*	179.8	176.9

Burimi: Banka Qendrore Evropiane, Eurostat, BEA(Bureau of Economic Analysis), Bureau of Labour Statistics, FMN;
*p-parashikime të FMN-së, janar 2017; * e dhënë e muajit tetor, 2016; : nuk ka të dhëna të disponueshme.*

(11) Ekonomia e vendeve të Ballkanit Perëndimor, shënoi rritje pozitive gjatë të tre tremujorëve të vitit 2016, duke u shoqëruar me përmirësim të kushteve në tregun e punës. Rritja ekonomike vjetore e vendeve të rajonit dhe e Turqisë, u rrit në 2.5% në tremujorin e tretë të vitit. Serbia, Kosova dhe Bosnja e Hercegovina (B&H) kanë shfaqur përmirësim, ndërkohë që rritja ekonomike është ngadalësuar disi për Malin e Zi dhe Maqedoninë. Aktiviteti ekonomik i kësaj të fundit ka reflektuar rënien e konsumit dhe të investimeve, si rezultat i zgjatjes së krizës politike në vend.

Tabela 2.2 Disa tregues kryesorë makroekonomikë dhe financiarë për vendet e Ballkanit Perëndimor

	PBB reale, % vjetore)			Papunësia (% vjetore)		Borxhi sovran (% e PBB-së)		Rritja e kredisë (% vjetore)		Raporti i kredisë me probleme	
	T2'16	T3'16	2016p	T2'16	T3'26	T2'16	T3'16	T2'16	T3'16	T2'16	T3'16
B&H	1.2	2.4	:	42.4	41.0	41.1	41.2	1.6	2.0	12.1	12.1
Maqedoni	3.1	2.4	2.1	24.0	23.4	37.0	41.9	5.8	2.8	7.2	7.1
Mal i Zi	2.7	2.4	2.7	17.5	16.9	61.7	60.8	-0.2	-1.5	12.6	11.0
Kosovë	3.3	3.8	:	26.2	:	13.8	14.3	8.4	9.6	5.3	5.1
Serbi	1.9	2.6	2.7	15.2	13.8	71.5	71.3	13.3	13.9	20.2	19.5

Burimi: EU Candidate and Potential Candidate Countries' Economic Quarterly (CCEQ) - 2016 Q4 Release.
p- parashikimi i ECFIN, janar 2017.

Pavarësisht problematikave specifike, kushtet në tregun e punës janë përmirësuar përmes rritjes së nivelit të punësimit dhe rënies së normës së papunësisë në të gjitha vendet. Presionet inflacioniste në të gjithë rajonin mbeten të ndrydhura, duke reflektuar nivelin e ulët të çmimit të lëndëve të para dhe qëndrueshmërinë e kursit të këmbimit. Gjatë gjysmës së dytë të vitit, normat e inflacionit në disa prej vendeve (B&H, Maqedoni, Mali i Zi) janë luhatur në vlera negative ose pranë zeros. Në vendet e tjera inflacioni ka qenë pozitiv, por përgjithësisht nën nivelin e synuar nga bankat qendrore. Në sektorin publik, performanca fiskale e vendeve të rajonit është përmirësuar ndjeshëm gjatë vitit 2016. Vijimi i programeve konsoliduese dhe rikuperimi ekonomik, kanë kontribuar në uljen e mëtejshme të deficiteve fiskale dhe borxhit publik në shumicën e vendeve. Në sektorin bankar, kreditimi ka shfaqur shenja pozitive, duke mbështetur rritjen ekonomike në rajon. Me përjashtim të Maqedonisë dhe Malit të Zi, kreditimi në pjesën tjetër të rajonit ka qenë pozitiv dhe në rritje. Pavarësisht uljes së portofolit të kredive me probleme gjatë vitit 2016, ky tregues vijon të mbetet mbi nivelet e parakrizës për shumicën e vendeve, duke frenuar gjallërimin e kredidhënies në rajon.

2.1 ZHVILLIMET NË TREGJET FINANCIARE DHE TË LËNDËVE TË PARA

(12) Zhvillimet në tregjet financiare globale ishin përgjithësisht pozitive gjatë tremujorit të tretë të vitit 2016. Tronditja që shkaktoi rezultati i referendumit të Mbretërisë së Bashkuar për daljen nga Bashkimi Evropian rezultoi jetëshkurtër, veçanërisht pas akomodimit të mëtejshëm të politikës monetare nga Banka e Anglisë dhe BQE-ja, dhe angazhimit për masa të reja lehtësuese në rast nevoje. Për të njëjtën periudhë, një pjesë e mirë e vlerave në tregjet e kapitalit të vendeve të zhvilluara u rikuperuan dhe *spread*-et u ngushtuan, duke u rikthyer në vlerat që kishin para qershorit 2016. Në tregjet e vendeve në zhvillim, kushtet e financimit në disa segmente u lehtësuan dhe flukset e kapitalit u rikthyen në kërkim të fitimeve më të larta.

(13) Por gjatë muajve të fundit të vitit 2016, kushtet e financimit në tregjet globale janë shtrënguar, duke reflektuar pjesërisht kthesën e politikës monetare të SHBA-së dhe pritjet për ndryshim të politikave fiskale. Në tregjet e vendeve të zhvilluara, normat afatgjata shënuan rritje gjatë tremujorit të fundit, veçanërisht në tregjet e titujve afatgjatë shtetërorë të Mbretërisë së Bashkuar dhe të SHBA-së. Këto zhvillime janë nxitur kryesisht nga pritjet e një ndryshimi të politikave ekonomike në SHBA pas zgjedhjeve presidenciale në nëntor 2016. Edhe në tregjet evropiane të titujve të sovranit, normat e interesit u rritën, më dukshëm në vende si Italia, duke reflektuar pasiguritë politike dhe ato financiare. Në tregjet e kapitalit, çmimet gjithashtu kanë qenë në rritje, kryesisht për korporatat jofinanciare, ndërsa në tregjet e parasë normat e interesit kanë mbetur në terren negativ, duke reflektuar politikën monetare të BQE-së dhe likuiditetin e bollshëm. Shtrëngimi i kushteve të financimit në tregjet botërore, ka shkaktuar flukse dalëse të kapitalit në vendet e Amerikës Latine dhe vendet në zhvillim të Evropës, si dhe ka rritur presionin për nënçmim të monedhave vendase.

Grafik 2.1 Ecuria e indekseve kryesore në tregjet e aksioneve



Burimi: Banka Qendrore Evropiane.

Grafik 2.2. Ecuria e kursit të këmbimit të euros ndaj monedhave kryesore



Burimi: Banka Qendrore Evropiane.

(14) Lëvizjet më të mëdha në flukset e kapitalit kanë shkaktuar një luhatshmëri më të dukshme në tregjet e këmbimit. Kjo ecuri është diktuar nga kombinimi i faktorëve politikë dhe ekonomikë. Kështu, përgjithësisht euro është mbiçmuar ndaj paundit britanik gjatë gjysmës së dytë të vitit, por është nënçmuar ndaj monedhave të tjera kryesore si dollari amerikan, jeni japonez dhe franga zvicerane. Luhatjet e flukseve të kapitalit nga disa tregje në zhvillim kanë rritur veçanërisht presionet ndaj monedhave të tyre, ku nënçmim më të ndjeshëm kanë shënuar monedhat e Turqisë dhe të Meksikës, ndikuar dhe nga rritja e pasigurisë politike dhe ekonomike të tyre. Nga ana tjetër, monedhat e vendeve eksportuese të naftës dhe të lëndëve të para, janë forcuar duke reflektuar stabilizimin e çmimeve të tyre në tregje.

(15) Çmimet e naftës kanë qenë në rritje gjatë gjysmës së dytë të vitit, ndikuar veçanërisht nga faktorë të ofertës. Pas marrëveshjes midis prodhueseve kryesorë[8] për të ulur kuotat e prodhimit të naftës gjatë gjysmës së parë të vitit 2016, çmimi i naftës në tregje filloi të rritej me shpejtësi. Në dhjetor 2016, çmimi i naftës bruto arriti në 52.6 dollarë/fuçi nga 29.9 dollarë/fuçi në janar 2016[9]. Gjithsesi, niveli shumë i lartë i inventarëve të akumuluar ka amortizuar disi efektin e kufizimeve në ofertën e prodhimit të naftës. Çmimet e lëndëve të tjera të para, veçanërisht të metaleve, gjithashtu kanë shënuar rritje gjatë fundit të vitit, ndikuar kryesisht nga kërkesa në rritje e Kinës dhe pritshmëritë për investime në infrastrukturë të administratës së re të SHBA-ve.

2.2 ZHVILLIMET NË GRUPET BANKARE TË HUAJA QË OPEROJNË NË SHQIPËRI

(16) Grupet e huaja bankare që zhvillojnë aktivitetin në vendin tonë, e mbyllën vitin 2016 përgjithësisht me nivele të qëndrueshme kapitalizimi, ndonëse rezultati financiar në disa prej tyre ka qenë negativ. Aktiviteti i tyre vijon të ndikohet përgjithësisht në rënie, nga procesi i uljes së niveleve të borxhit dhe nevoja për të pastruar bilancet nga kredia me probleme. Megjithatë, rezultatet e ushtrimit të provës së rezistencës të Autoritetit Evropian Bankar (EBA, korrik 2016), dëshmuan për aftësi të mira në përballimin e goditjeve me natyrë makroekonomike, pavarësisht rritjes së ndjeshmërisë tek disa prej grupeve bankare. Për sa i takon ecurisë së peshës së filialeve shqiptare në aktivitetin e grupit bankar, gjatë vitit 2016, ecuria e këtyre peshave ka qenë në drejtime të ndryshme, duke reflektuar specifikën e veprimtarisë së secilës palë.

Tabelë 2.3. Zhvillimet në grupet e huaja bankare që operojnë në Shqipëri

Ndryshim (%)	Raiffeisen Bank International	Intesa San Paolo	Alpha Bank	Piraeus Bank	National Bank of Greece	Societe Generale	Grupi Veneto
Aktivet	-0.5%	9.1%	-4.5%	-6.1%	-26.5%	2.2%	-11.2%
Kredi	2.1%	5.0%	-2.8%	-4.6%	-2.3%	3,0%	-16.8%
Depozita	-0.4%	2.0%	1.9%	-15.0%	-0.9%	8.0%	-12.0%
Provigjione	-36.7%	6.3%	-63.4%	...	-80.6%	13,7%	...
Fitimi neto	-6.9%	-14.3%	...	...	-36.5%	15,3%	58.3%
Raporte							
Kredi me probleme	10.2%	4.1%	38.3%	38.8%	-	5.0%	22.5%
Marzhi neto nga interesat	2.8%	-	2.7%	-	-	-5,6%	56.4%
Mjaftueshmëria e kapitalit	12.6%	12.8%	16.8%	17.4%	21.9%	11,5%	...
Pesha e bankës në Shqipëri ndaj grupit	1.7%	0.4%	0.7%	0.2%	0.3%	0,1%	0.8%

Shënim: Shenja (...) tregon ndryshim të theksuar të këtij treguesi (mbi 100%), ndërsa shenja (-) tregon të dhëna të padisponueshme për këtë tregues në publikimet e bankës përkatëse.
Burimi: Faqet zyrtare të grupeve bankare.

[8] *Marrëveshja (u lidh në qershor, 2016 dhe u ratifikua më 30 nëntor 2016) mes vendeve të OPEC dhe joOPEC, parashikon reduktimin e kuotave të prodhimit të naftës respektivisht me 1.27 dhe 0.6 milionë fuçi në ditë.*

[9] *Burimi: FMN.*

(17) Tkurrja e aktivitetit tek disa nga grupet bankare evropiane që veprojnë në vendin tonë, ruan stimujt për ristrukturimin e veprimtarisë, duke përfshirë edhe ndryshimin e rrjetit të tyre në vendet jashtë Bashkimit Evropian. Ky proces mbështetet mbi një analizë të plotë të kostove dhe të përfitimeve në nivel grupi në raport me objektivat e tij afatshkurtër dhe afatgjatë, dhe orientohet mbi performancën aktuale dhe potenciale për aktivitetin e çdo njësie të rrjetit në juridiksionet ku veprojnë. Në thelb, përvoja e vendeve të tjera tregon që nëse ky është një proces i koordinuar mirë mes të gjitha palëve të interesuara, dalja e një grupi bankar nga një treg i caktuar mund të shoqërohet me hyrjen në treg të investitorëve të tjerë të vlefshëm, të cilët mund të sjellin kapacitete shtesë dhe përparësi të tjera në sektorin bankar lokal. Këto ndryshime, mund të japin një efekt pozitiv në strukturën e sektorit bankar dhe të sistemit financiar në një vend të caktuar, dhe të rrisin kontributin e tij në mbështetjen e rritjes ekonomike të atij vendi. Procesi përmban edhe pasiguri, të cilat lidhen me fazën në të cilën gjendet aktualisht cikli ekonomik dhe ai financiar në BE dhe në rajon, dhe me potencialin që kanë vendet e rajonit për të gjeneruar interes tek investitorët e rinj të vlefshëm. Është e vështirë të përcaktohet në ç'masë dhe në ç'mënyrë ky proces mund të prekë filialet shqiptare të këtyre grupeve bankare evropiane. Nëse ndodh, ky proces duhet vlerësuar në kuadër të mundësive të reja që mund të krijohen për përmirësimin e aktivitetit të sektorit bankar. Nga ana tjetër, Banka e Shqipërisë dhe autoritetet e tjera në vend, do të forcojnë kapacitetet monitoruese, vlerësuese dhe bashkëpunimin mes tyre, në mënyrë që proceset të zhvillohen në përputhje me kërkesat ligjore dhe objektivin final të ruajtjes së stabilitetit të sistemit financiar.

3. ZHVILLIMET MAKROEKONOMIKE NË VEND

(18) Ekonomia shqiptare përshpejtoi rritjen në tremujorin e katërt të vitit 2016, duke shënuar një normë vjetore rritjeje prej 3.97%. Kontributit të qëndrueshëm pozitiv të sektorit të shërbimeve iu shtua kontributi pozitiv i sektorit të prodhimit për degët e ndërtimit, të industrisë dhe të bujqësisë. Kërkesa agregate u mbështet në rritjen e konsumit final të popullatës dhe të qeverisë, si dhe në rritjen e formimit të kapitalit të qëndrueshëm. Në zgjerimin e kërkesës së brendshme, bie në sy kontributi që ka dhënë ulja e deficitit të llogarisë korrente në bilancin e pagesave, kryesisht për shkak të përmirësimit të ecurisë së eksporteve[10] dhe të tepricës pozitive në llogarinë e shërbimeve. Rritja e aktivitetit ekonomik në vend është shoqëruar me rënie të mëtejshme të papunësisë, si në terma vjetorë, ashtu edhe tremujorë[11], në nivelin prej 14.2%. Pritshmëritë mbi nivelet e punësimit për gjashtëmujorin e parë të vitit 2017, përcaktohen nga vlerësimet pozitive nga të gjithë sektorët e ekonomisë dhe nga pritjet disi më të ulëta të konsumatorëve.

(19) Gjatë periudhës, politika monetare mbeti lehtësuese, ndonëse nuk pati ndryshim të normës bazë të interesit nga ana e Bankës së Shqipërisë. Kjo qasje u diktua nga nevoja për të konsoliduar zhvillimet pozitive që lidhen me përmirësimin e aktivitetit ekonomik dhe të kreditimit, rënien e normës së papunësisë dhe rritjen graduale të inflacionit drejt vlerës së objektivit afatmesëm. Në dhjetor 2016, inflacioni vjetor arriti në nivelin 2.2%. Ndonëse kjo normë ishte e ngjashme me atë të vitit paraardhës, ajo shënoi rritje në tremujorin e katërt të vitit[12]. Në linjë me pritshmëritë për përmirësim të mëtejshëm të aktivitetit ekonomik në vend dhe jashtë, Banka e Shqipërisë pret që inflacioni të konvergojë drejt vlerës objektiv brenda vitit 2018.

(20) Në fund të periudhës, politika fiskale konsoliduese rezultoi në ngushtimin e ndjeshëm të deficitit buxhetor për vitin 2016. Në fakt, teprica buxhetore regjistroi një deficit prej rreth 27 miliardë lekësh kundrejt një deficiti prej 58.2 miliardë lekësh një vit më parë. Financimi i tij u bë kryesisht nga fondet e huaja, duke ulur nevojën për huamarrje të qeverisë në tregun e brendshëm. Në rënien e vlerës së deficitit buxhetor, ndikoi rritja e të ardhurave buxhetore me 6.8%[13] dhe rënia e shpenzimeve buxhetore me 1.4%, ku kontributin kryesor e dha rënia e shpenzimeve kapitale. Nevoja për realizimin e shpenzimeve

[10] *Eksportet e mallrave dhe shërbimeve u rritën me 15.9%, ndërsa importet e mallrave dhe shërbimeve u rritën me 0.45%.*

[11] *Norma e papunësisë shënonte nivelin prej 14.7% në T3 2016 dhe 17.3% në T4 2015.*

[12] *Më konkretisht, në dhjetor 2015, kjo normë shënoi vlerën 2.0% dhe në shtator të 2016-ës arriti në 1.8%.*

[13] *Të ardhurat vjetore shënuan një vlerë kumulative prej 405.1 miliardë lekësh, ndërsa shpenzimet e përgjithshme shënuan vlerën 432 miliardë lekë.*

buxhetore, veçanërisht të atyre kapitale, në përputhje me objektivat dhe në mënyrë konsistente përgjatë gjithë vitit financiar, mbetet një nga sfidat e planifikimit dhe realizimit të buxhetit.

(21) Në tremujorin e fundit të vitit, deficiti i llogarisë korrente në bilancin e pagesave u ul ndjeshëm, ndikuar nga një ecuri më e mirë e eksporteve dhe rritje e tepricës pozitive në llogarinë e shërbimeve. Deficiti i llogarisë korrente rezultoi në vlerën 240 milionë euro, duke u tkurrur me 40% në terma vjetorë. Në këtë ecuri ndikuan tkurrja e deficitit në llogarinë e mallrave për shkak të rritjes më të shpejtë të eksporteve[14], rritja e tepricës pozitive në llogarinë e shërbimeve[15] ndikuar nga hyrjet prej shërbimeve të udhëtimit[16], rritja e flukseve hyrëse në llogarinë e të ardhurave dytësore[17], kryesisht për shkak të rritjes së vlerës së dërgesave nga emigrantët[18], dhe ulja e vlerës së flukseve dalëse në llogarinë e të ardhurave parësore. Zgjerimi i eksportit të mallrave i dedikohet: (i) rritjes së eksportit të produkteve minerale në zërin "Xeherorët, zgjyrat dhe hiri" dhe (ii) rritjes së eksporteve në zërin "Metale bazë dhe artikujt prej tyre (giza dhe çeliku)". Fluksi i detyrimeve financiare të Shqipërisë me botën vlerësohet 221 milionë euro, duke shënuar një rënie vjetore me 34%. Detyrimet financiare u krijuan në masën më të madhe nga investimet e huaja direkte, të cilat rezultuan 276 milionë euro, duke qenë rreth 70% më të larta se një vit më parë. Kontributin kryesor në rritjen e investimeve të huaja direkte e dha sektori i energjetikës dhe ai i hidrokarbureve. Detyrimet në formën e investimeve të tjera shënuan vlerën negative prej 59 milionë euro, kundrejt vlerës pozitive prej 43 milionë eurosh një vit më parë.

---

[14] *Kundrejt të njëjtës periudhë të një viti më parë, eksportet u rritën me 29%, ndërsa importet u rritën vetëm me 1%.*

[15] *Në llogarinë e shërbimeve, teprica pozitive rezultoi 230 milionë euro, duke qenë 89 milionë euro më e lartë se në të njëjtën periudhë të një viti më parë.*

[16] *Hyrjet nga shërbimet e udhëtimit ishin dy herë më të larta se për të njëjtën periudhë të një viti më parë, në vlerën 96 milionë euro.*

[17] *Në këtë llogari, teprica rezultoi 224 milionë euro, me një rritje prej gati 23 milionë eurosh nga e njëjta periudhe një viti më parë.*

[18] *Në terma vjetorë, dërgesat nga emigrantët u rritën me 8%, duke shënuar vlerën 160 milionë euro.*

4. POZICIONI FINANCIAR DHE EKSPOZIMI NDAJ RREZIQEVE I INDIVIDËVE DHE BIZNESEVE

(22) Përgjatë vitit 2016, individët dhe bizneset janë orientuar drejt kursimeve. Pavarësisht përshpejtimit të kreditimit të individëve, rritja e depozitave të tyre mbetet më e lartë, duke reflektuar zgjerim të pozicionit kreditor të individëve. Për të njëjtën periudhë, kredia për bizneset shënoi rënie, ndërsa depozitat zgjerim më të shpejtë, kryesisht në monedhë të huaj. Si rezultat, edhe bizneset shfaqin ngushtim të pozicionit debitor. Procesi i fshirjes së kredive të humbura nga bilancet e bankave është shoqëruar me përmirësim të cilësisë së kredisë për individët dhe bizneset, më e theksuar kjo ndaj zhvillimeve të një viti më parë dhe kryesisht për kredinë e pambrojtur në valutë.

4.1 POZICIONI FINANCIAR I INDIVIDËVE DHE BIZNESEVE

(23) Gjatë periudhës, pozicioni kreditor[19] i individëve shënon një zgjerim, ndërsa pozicioni debitor i bizneseve është ngushtuar[20]. Pozicioni kreditor i individëve u ngjit në nivelin 772 miliardë lekë, mbështetur tërësisht nga zgjerimi i pozicionit kreditor në valutë, përmes rritjes së këtyre depozitave. Orientimi i kredisë së individëve në monedhën vendase ka ngushtuar pozicionin kreditor në lekë. Në të kundërt, bizneset kanë ngushtuar pozicionin e tyre debitor ndaj sektorit bankar me rreth 38 miliardë lekë, në nivelin 217 miliardë lekë. Ngushtimi i pozicionit debitor të bizneseve është më i dukshëm në monedhën e huaj, kryesisht për shkak të rritjes së ndjeshme të depozitave në valutë.

Grafik 4.1 Pozicioni financiari individëve dhe bizneseve, miliardë lekë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

(24) Gjatë periudhës, individët kanë rritur kursimet në formën e depozitave kryesisht në valutë dhe kanë ulur investimet në aktive të tjera të sistemit financiar. Pesha e investimeve në bono thesari, obligacione dhe fonde investimesh, ka shënuar një rënie të lehtë gjatë periudhës, ndërkohë që pesha e depozitave në valutë shënon rritje në nivelin 42.3% të totalit të aktiveve të individëve në sistemin financiar.

[19] *Diferenca midis depozitave dhe kredisë së individëve në sektorin bankar.*

[20] *Në terma vjetorë, regjistrohet një zgjerim prej rreth 2% i pozicionit kreditor të individëve përkundër një ngushtimi prej rreth 15% të pozicionit debitor të bizneseve.*

Tabela 4.1. Aktivet e individëve në sistemin financiar

	2010		2013		Qershor 2016		Dhjetor 2016	
	mld lek	Pesha %	mld lek	Pesha %	mld lek	Pesha %	mld lek	Pesha %
Depozita në lekë	357.6	49.8	449.5	43.7	450.4	40.3	454.3	40.3
Depozita në valutë	304	42.3	418.4	40.7	455.6	40.8	476.4	42.3
Bono thesari	56.7	7.9	70.6	6.7	72.4	6.5	65.2	5.8
Obligacione	0.37	0.05	39.8	3.9	66.4	5.9	64.5	5.7
Fondet e investimeve*	-	-	50.3	4.9	71.7	6.4	65.4	5.8
Fondet e pensioneve private vullnetare*	0.12		0.43	0.04	1.1	0.1	1.2	0.1
Portofoli i individëve	718.8	100	1,029	100	1,117.6	100	1,127	100

Burimi: Banka e Shqipërisë.

4.1.A KREDITIMI I INDIVIDËVE DHE RREZIKU I KREDISË

(25) Gjatë periudhës, individët kanë përshpejtuar huamarrjen nga sektori bankar, në nivelin 3.7% në terma vjetorë. Ky zgjerim reflekton rritjen e kredisë për "konsum të mallrave jo të qëndrueshme" ndjekur nga kredia për "blerje banese". Kredia e re për "investime në pasuri të paluajtshme" shënon ritme pozitive mbështetur nga nivelet e ulëta historike të normës së interesit.

(26) Zgjerimi i kredisë për individët[21] është tërësisht në monedhën vendase, ndërsa kredia në valutë është tkurrur. Kredia e pambrojtur e individëve në valutë ka rënë në vlerë absolute dhe cilësia e saj është përmirësuar, duke shënuar rënie të ekspozimit ndaj lëvizjeve të pafavorshme të kursit të këmbimit. Pesha e saj në kredinë e individëve ra në 25.7% të tepricës totale të kredisë, krahasuar me 29.4% në fundin e vitit 2015. Rreth 79.8% e kredisë së pambrojtur për individë përbëhet nga "kredia për blerje shtëpie", e cila gjatë harkut kohor njëvjeçar ka rënë lehtësisht me 2 p.p. Si rrjedhim, pesha e kredisë në lekë është ngjitur në 52.4%, rreth 2.6 pp më shumë se në dhjetor 2015. Sipas afatit të maturimit, kredia afatgjatë për individë paraqet një rritje të lehtë me 1.1% dhe arrin në nivelin prej 79.4% të portofolit; kredia afatshkurtër ka zbritur në 6.0% dhe kredia afatmesme zë 14.6% të portofolit.

Grafik 4.2. Struktura e kredisë për individët sipas afatit të maturimit (majtas) dhe monedhës (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

[21] *Individët rezidentë.*

(27) Përmirësimi i cilësisë së portofolit të kredisë për individët ka vijuar, i ndikuar nga procesi i fshirjes së kredive të humbura nga bilancet e bankave. Raporti i kredive me probleme për individët zbriti në 10%, rreth 2.9 pp më i ulët së viti i kaluar. Përmirësimi i cilësisë së kredisë është më i ndjeshëm për kredinë në valutë dhe për pjesën e saj që është e pambrojtur nga lëvizjet në kursin e këmbimit. Raporti i kredisë me probleme në valutë për individët zbriti në nivelin 11.9%, duke shënuar një rënie vjetore prej 3.4 pp. Po ashtu, edhe cilësia e kredisë për individë e pambrojtur nga kursi i këmbimit u përmirësua, ku raporti i kredive me probleme për këtë kategori zbriti në 11.2%, nga 15.1% në dhjetor 2015.

Grafik 4.3 Ndryshimi vjetor i Raportit të Kredive me Probleme për individët, pikë përqindje



Burimi: Banka e Shqipërisë.

HAPËSIRË INFORMUESE 4.1. REZULTATET E VROJTIMIT MBI GJENDJEN FINANCIARE DHE HUAMARRJEN E FAMILJEVE

Vrojtimi i gjendjes financiare dhe huamarrjes së familjeve kryhet çdo gjashtë muaj, me një kampion rastësor prej 1,209 familjesh, ku rreth 55% i përkasin zonave urbane dhe 45% zonave rurale.

Gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit, numri i të punësuarve shënon rritje në terma vjetorë mbështetur nga punësimi në sektorin privat. *Balanca financiare (të ardhura-shpenzime) e familjeve ka shënuar zgjerim për shkak të rritjes së të ardhurave dhe ruajtjes së shpenzimeve pothuaj në të njëjtin nivel.* ***Rreth 29% e familjeve deklarojnë së kanë hua për të paguar*** *dhe kjo peshë ka rënë pak krahasuar me pjesën e parë të vitit dhe krahasuar me një vit më parë.*

Në 95% të rasteve, huamarrja është në lekë dhe kjo peshë ka ardhur duke u rritur. *Në 38% të rasteve të huamarrjes, familjet i janë drejtuar burimeve formale (banka dhe institucione jobankare) dhe në 62% të rasteve i janë drejtuar burimeve joformale, kryesisht në cash. Krahasuar me 6-mujorin e parë të vitit 2016,* ***kjo shpërndarje është zhvendosur në favor të huamarrjes joformale kundrejt asaj formale****, si rezultat i rritjes së rasteve të huamarrjes nga persona fizikë. Tre qëllimet kryesore të huamarrjes mbeten për konsum (42% e rasteve të huamarrjes), blerje/riparim prone (29% e rasteve) dhe zhvillim biznesi (12% e rasteve). Gjatë periudhës së vrojtuar, shpërndarja e rasteve të huamarrjes sipas qëllimit të kredisë, është zhvendosur në favor të huamarrjes për konsum.*

Totali i tepricës së raportuar të huasë rezulton në rënie krahasuar me vrojtimin e kaluar dhe krahasuar me një vit më parë. *Rreth 80% e tepricës është siguruar nga burime formale dhe 20% nga burime joformale, duke u zhvendosur disi drejt huasë joformale. Në përbërjen sipas monedhës, 97% e tepricës deklarohet në lekë dhe vetëm 3% në euro. Sipas qëllimit të përdorimit, rreth* ***57% e tepricës së huasë deklarohet për "blerjen/riparimin e një prone", 24% për "zhvillimin e një biznesi" dhe vetëm 10% për qëllime "konsumi".***

Familjet huamarrëse vlerësojnë ***rënie të kështit të kredisë gjatë periudhës referuese****, duke reflektuar uljen e normës së ponderuar të kredisë për individët. Në lidhje me aftësinë paguese,* ***vlerësohet përmirësim i aftësisë paguese në terma vjetorë dhe gjashtëmujorë,*** *ndërsa pritshmëritë për pjesën e mbetur të vitit janë optimiste.*

Kërkesa për kredi mbetet e dobët, por gjithsesi në tendencë rritëse *gjatë gjithë vitit. Mundësia për të marrë hua është rritur lehtë në pjesën e dytë të vitit, duke iu afruar nivelit të mesatares afatgjatë.*

4.1.B KREDITIMI I BIZNESEVE DHE RREZIKU I KREDISË

(28) Kredia për bizneset, që përfaqëson gati 67% të totalit të kredisë, është zgjeruar me 2.4% në terma vjetorë, e orientuar kryesisht drejt subjekteve jorezidente. Kredia për bizneset rezidente shënoi ritme negative, duke u tkurrur me 0.8% ndaj vitit të kaluar. Teprica e kredisë së rezidentëve u tkurr për të gjitha qëllimet e përdorimit, me përjashtim të kredisë për "blerje pajisjesh", që përbën 29% të totalit (që u rrit me 4% në terma vjetorë) dhe "kredisë për çelje biznesi", e cila përbën vetëm 1.4% të totalit. Për bizneset jorezidente, teprica e kredisë u zgjerua me 25.6% ndaj një viti më parë ose rreth 14.4% gjatë periudhës.

(29) Ne strukturën e kredisë për bizneset pesha e kredisë në lekë është rritur. Pesha e kredisë në valutë në totalin e kredisë së bizneseve zbriti në 61.6%, ose 3.1 pp më pak se fundi i vitit 2015. Gjithsesi, teprica e kredisë së pambrojtur nga lëvizjet e pafavorshme të kursit të këmbimit mbetet në të njëjtat nivele me një vit më parë, duke zënë rreth 27% të totalit të kredisë për bizneset. Në strukturën e kredisë së pambrojtur të bizneseve, pesha e kredisë "për tregti" shënoi zbritje në 44.4% të këtij portofoli, ndërsa kredia "për zhvillim biznesi" dhe kredia "për zhvillim të pasurive të paluajtshme" përbëjnë përkatësisht 15.8% dhe 8.6% të portofolit.

Grafik 4.4. Struktura e kredisë për bizneset sipas afatit të maturimit (majtas) dhe monedhës (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

(30) Pesha e kredisë për bizneset e mëdha ka pësuar rënie duke zbritur në nivelin 56.4% të totalit; ndërsa pesha e kredisë për bizneset e vogla dhe të mesme ka shfaqur rritje, duke zënë përkatësisht 22.3% dhe 21.3% të totalit. Gjatë vitit 2016, biznesi i vogël dhe i mesëm ka vijuar të rrisë peshën e kredisë afatshkurtër, ndërsa biznesi i madh është orientuar drejt kredisë afatmesme dhe nuk regjistron ndryshime në peshën e asaj afatgjatë. Sipas monedhës së kreditimit, vërehet se biznesi i vogël dhe ai i mesëm kanë zgjeruar kredinë në lekë, kurse biznesi i madh regjistron ngushtim të lehtë për monedhën e huaj në favor të asaj vendase.

Grafik 4.5. Struktura e kredisë së bizneseve sipas madhësisë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

(31) Megjithëse cilësia e portofolit të kredisë për bizneset shënon një përkeqësim të lehtë në terma vjetorë, ajo ka ndjekur një prirje rënëse gjatë gjithë periudhës. Në dhjetor 2016, raporti i kredive me probleme për bizneset shënoi nivelin 21.4% nga 23.0% në qershor dhe 20.1% një vit më parë. Raporti i kredive me probleme për kredinë në valutë shënoi nivelin 24.3% në fund të periudhës, ose 2.6 p.p. mbi nivelin e një viti më parë. Cilësia e portofolit të kredisë së pambrojtur në valutë për bizneset shënoi përmirësim të ndjeshëm vjetor, e ndikuar kryesisht nga procesi i fshirjes së kredive të humbura. Në fund të periudhës, raporti i kredive me probleme për këtë kategori të kredisë zbriti në 22.2% nga 26.3% në qershor dhe nga niveli 25.7% në fund të vitit 2015.

Grafik 4.6. Ndryshimi vjetor i raportit të kredive me probleme për bizneset, në pikë përqindje



Burimi: Banka e Shqipërisë.

HAPËSIRË INFORMUESE 4.2 REZULTATET E VROJTIMIT MBI GJENDJEN FINANCIARE DHE HUAMARRJEN E NDËRMARRJEVE

Vrojtimi i gjendjes financiare dhe huamarrjes së ndërmarrjeve kryhet me frekuencë gjashtëmujore. Në gjashtëmujorin e parë 2016, vrojtimi u zgjerua në një kampion prej 1,209 ndërmarrjesh (të vogla, të mesme dhe të mëdha), të shtrira gjeografikisht në të gjithë vendin dhe që kryejnë aktivitetin e tyre në sektorët kryesorë të ekonomisë.

***Konkurrenca dhe gjetja e tregut** vlerësohen si faktorët kryesorë kufizues të aktivitetit për të gjitha ndërmarrjet, veçanërisht për ato të vogla dhe të mesme. Problematikat lidhur me aksesin në financim dhe koston e financimit, janë vlerësuar në rënie nga të tre grupet e ndërmarrjeve.*

***Ndërmarrjet e vogla vazhdojnë të vlerësojnë rënie të nivelit të shitjeve dhe të rezultatit financiar gjatë gjysmës së dytë të vitit 2016**, por me një tendencë më të zbutur krahasuar me gjysmën e parë të vitit. Situata paraqitet më pozitive për ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha, të cilat kanë vlerësuar rritje të shitjeve dhe të rezultatit financiar gjatë periudhës referuese. Të tre grupet e ndërmarrjeve deklarojnë se kanë zgjeruar veprimtarinë e tyre, por zgjerimi ka qenë më i ndjeshëm tek ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha. Për gjysmën e parë të vitit 2017, **të gjitha ndërmarrjet presin zgjerim të veprimtarisë së tyre dhe ecuri pozitive të nivelit të shitjeve dhe rezultatit financiar**. Gjithsesi, këto pritshmëri janë zbutur gjatë periudhës.*

***Gjatë periudhës referuese, më tepër se gjysma e ndërmarrjeve të përgjigjura kanë financuar veprimtarinë e tyre vetëm përmes shitjeve**. Krahasuar me periudhën e kaluar, përdorimi i shitjeve si burim i vetëm financimi ka rënë në rastin e ndërmarrjeve të vogla dhe atyre të mëdha, duke u mbështetur në përdorimin e rezervave. Nga ana tjetër, huamarrja si burim më vete apo i kombinuar është përdorur nga rreth 25% e ndërmarrjeve.*

***Rreth 44% e totalit të ndërmarrjeve pohojnë se kanë një hua për të paguar dhe kjo peshë ka rënë krahasuar me gjysmën e parë të vitit** për të tre grupet e ndërmarrjeve. Pesha e huamarrësve tek ndërmarrjet e vogla është rreth 38%, për ato të mesme rreth 44%, ndërsa për ndërmarrjet e mëdha është 48%. Rreth 96% e ndërmarrjeve huamarrëse deklarojnë se e kanë siguruar huanë nga sektori bankar dhe kjo peshë është rritur krahasuar me periudhën e kaluar. Kjo rritje ka rezultuar e shpërndarë në të tre grupet e ndërmarrjeve, por ka qenë më e theksuar tek ndërmarrjet e mesme.*

***Huamarrja e ndërmarrjeve ka si qëllim kryesor përballimin e shpenzimeve korrente** (37% e ndërmarrjeve të vogla, 41% e atyre të mesme dhe 43% e atyre të mëdha), si edhe kryerjen e një investimi afatgjatë (40% e ndërmarrjeve të vogla, 37% e atyre të mesme dhe 38% e ndërmarrjeve të mëdha). Rreth 76% e totalit të ndërmarrjeve huamarrëse (pavarësisht madhësisë), **e konsiderojnë të përshtatshëm nivelin e huamarrjes së tyre për financimin e veprimtarisë**. Ndërkohë, rreth 17% e tyre deklarojnë se do të donim të merrnim më tepër hua dhe kjo peshë është rritur krahasuar me 6-mujorin e kaluar, e ardhur kryesisht nga ndërmarrjet e vogla dhe ato të mëdha.*

*Huamarrja raportohet **kryesisht në monedhën vendase për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, dhe kryesisht në valutë në rastin e ndërmarrjeve të mëdha**. Gjithsesi, pesha e huamarrësve në lekë kundrejt atyre në valutë rezulton në rritje për të tre grupet e ndërmarrjeve. Pjesa më e madhe e ndërmarrjeve (rreth 50%) deklaron se kanë marrë hua në 1-5 vitet e fundit. Nga ana tjetër, vetëm 14% e ndërmarrjeve*

të vogla, 12% e ndërmarrjeve të mesme dhe 14% e atyre të mëdha deklarojnë huamarrje të re gjatë gjashtëmujorit në analizë.

Vlera e përgjithshme e huasë në krahasim me kapitalin e ndërmarrjes rezulton afërsisht sa gjysma e tij, për pjesën kryesore të ndërmarrjeve huamarrëse (78%) *dhe pothuaj e njëjtë për 12% të ndërmarrjeve. Mbi 70% e ndërmarrjeve deklarojnë se pagesa e huasë ndaj totalit të të ardhurave arrin deri në 20% të të ardhurave duke rezultuar në një ngarkesë në borxh në nivelin "mbi mesatar".*

Procesi i huamarrjes nga bankat vlerësohet midis nivelit "normal" dhe "i vështirë" nga të gjitha ndërmarrjet. *Mundësia e huamarrjes së re për gjashtëmujorin e ardhshëm vlerësohet përgjithësisht "pak e mundshme" dhe vijon të rezultojë disi më e ulët për ndërmarrjet e vogla. Kërkesa e ulët për kredi mund të jetë reflektim i qëndrimit se niveli aktual i huamarrjes konsiderohet i përshtatshëm.*

4.2 TREGU I PASURIVE TË PALUAJTSHME DHE KREDIA PËR PASURI TË PALUAJTSHME

(32) Veprimtaria bankare, kushtet e financimit dhe ecuria e tregut të pasurive të paluajtshme ndërveprojnë ngushtë me njëra-tjetrën[22]. Nga njëra anë, një rritje e shpejtë dhe e pajustifikuar nga kushtet e tregut, e kredisë për blerje pasurish të paluajtshme mund të shkaktojë mbinxehje ose rritje të fortë të çmimeve, në tregun e pasurive të paluajtshme. Nga ana tjetër, një rënie e menjëhershme e çmimeve të pasurive të paluajtshme, përveç pasojave negative për ekonominë, mund të sjellë destabilitet në tregjet financiare në formën e tkurrjes së kërkesës për kredi të garantuar me pasuri të paluajtshme, rënies së kërkesës dhe normës së shlyerjes së kredive nga sektori i ndërtimit, dhe rënies së vlerës së portofolit të pasurive të paluajtshme të marra nga bankat si pasojë e ekzekutimit të kolateraleve.

(33) Teprica e kredisë për pasuri të paluajtshme[23] zbriti me 1.7% gjatë periudhës, ndonëse cilësia e kësaj kredie u përmirësua lehtësisht dhe norma e interesit shënoi rënie. Raporti i kredive me probleme për këtë lloj kredie ra në nivelin 8.8%, nga 10.4% në qershor dhe nga rreth 11.5% një vit më parë. Pesha e tepricës së kredisë për ndërtim ra lehtë në nivelin 13.7% të tepricës së kredisë për bizneset, pa shfaqur ndryshime të rëndësishme gjatë periudhës dhe duke reflektuar kushtet disi më të shtrënguara nga ana e sektorit bankar. Gjatë viteve 2007-2011, pesha e kësaj kredie ndaj tepricës së kredisë ka qenë rreth 20%. Ndërkohë, kërkesa e individëve për kredi për pasuri të paluajtshme ka ardhur në rritje, dhe bankat raportojnë se kushtet për këtë kategori kredie kanë mbetur përgjithësisht të pandryshuara.

[22] *Ekspozimi në këtë rast përfaqësohet nga kredia e dhënë për, ose e garantuar me pasuri të paluajtshme; kredi dhënë kompanive të sektorit të ndërtimit; si edhe nga portofoli i pasurive të paluajtshme që është krijuar tek bankat si rezultat i marrjes së kolateralit në vijim të procesit të ekzekutimit të detyrimit.*

[23] *Përfshin kredinë e dhënë për ndërtim dhe për blerje banese.*

Grafik 4.7 Kredia për blerje të pasurisë së paluajtshme



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 4.8 Raporti i kredive me probleme



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Norma e ponderuar e interesit për kredi për pasuri të paluajtshme[24] në fund të vitit 2016 shënoi 4.2%, duke ruajtur pririjen rënëse të viteve të fundit. Në të njëjtën linjë, kosto relative e pagesës së kredisë për blerje pasurie të paluajtshme ka vazhduar të zbutet, duke reflektuar kushte më të favorshme për blerjen e pronave të paluajtshme nga këndvështrimi i huamarrësit.

(34) Pesha e kredive të kolateralizuara me pasuri të paluajtshme, ka shënuar rënie gjatë periudhës. Në fund të dhjetorit të vitit 2016, rreth 49% e kredive të dhëna nga sektori bankar ishin të kolateralizuara me prona të paluajtshme, ndërkohë që për individët dhe bizneset raportet ishin përkatësisht 65% dhe 43%. Në krahasim me një gjashtëmujor dhe një vit më parë, të tre raportet kanë shënuar rënie. Në fund të vitit 2015, kredia e kolateralizuar me pronë të paluajtshme zinte rreth 52% të stokut të përgjithshëm të kredisë.

(35) Rezultat e vrojtimit për tregun e pasurive të paluajtshme dhe ecurinë e indeksit të çmimit të banesave për periudhën, në shkallë vendi, sugjeron një rritje të numrit dhe të çmimit të shitjeve. Subjektet e intervistuara, që janë agjenci të pasurive të paluajtshme dhe kompani ndërtimi, kanë përmirësuar perceptimin e tyre për gjendjen e tregut, ndonëse në tërësi ai ende vlerësohet i vështirë. Sipas përgjigjes së të intervistuarve, gjatë periudhës, indeksi (Fischer) i çmimit të banesave në rang vendi u rrit me 12.8%. Ky zhvillim është ndikuar nga rritja e çmimit dhe vëllimit të shitjeve në zonat qendrore të kryeqytetit dhe nga rritja e çmimit dhe vëllimit të shitjeve në zonat e tjera[25]. Për zonën bregdetare, agjentët kanë raportuar rënie të çmimit mesatar dhe të vëllimit të shitjeve. Indeksi i çmimit mesatar për Tiranën vlerësohet 3.3% më i lartë në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar. Në tërësi, ecuria e inventarëve të raportuar dhe rënia e numrit të pronave të pashitura mbështesin një situatë më optimiste të këtij tregu, ashtu siç konfirmohet edhe nga pritshmëritë e subjekteve të intervistuara

[24] *Individë dhe biznese.*
[25] *"Zona të tjera" përfshin të gjitha zonat përveç Tiranës dhe zonës së bregdetit.*

për periudhën e ardhshme. Megjithatë, zgjatja e kohës mesatare të shitjes së pronave tregon që përgjithësisht, transaksionet janë ende selektive dhe kjo do të reflektojë edhe në ecurinë e çmimeve.

HAPËSIRË INFORMUESE 4.3 PËRMBLEDHJE E REZULTATEVE TË VROJTIMIT "TREGU I PASURIVE TË PALUAJTSHME" DHE ECURIA E INDEKSIT TË ÇMIMIT TË BANESAVE PËR GJASHTËMUJORIN E DYTË TË VITIT 2016

Vlerësimi i situatës në tregun e pasurive të paluajtshme bëhet përmes vrojtimit në terren të një kampioni të përbërë nga 230 agjentë të pasurive të paluajtshme dhe shoqëri ndërtimi, të cilët përfaqësojnë rreth 75-80% të popullatës së këtyre subjekteve për nga madhësia e aktivitetit. Banka e Shqipërisë realizon hartimin e pyetësorit, si edhe hedhjen dhe përpunimin e rezultateve, ndërkohë që Instituti i Statistikave mbulon intervistën në terren, proceset kryesore të përzgjedhjes së kampionit dhe kontrollin fizik të pyetësorëve të plotësuar.

Në përgjigje të pyetjes "Si e vlerësoni situatën e tregut në krahasim me periudhën (gjashtëmujorin) e mëparshme?", balanca neto e përgjigjeve prej -8.2%, tregon se një numër më i madh agjentësh kanë dhënë përgjigje negative (më keq) sesa përgjigje pozitive (më mirë). Por, megjithëse vlerësimi i përgjithshëm mbetet pesimist, balanca e përgjigjeve është më pak negative se në gjashtëmujorin e kaluar (-33%), gjë që tregon një përmirësim të vlerësimit të përgjithshëm të subjekteve të intervistuara. Vlen të theksohet fakti se, për këtë periudhë, i njëjti tregues i vlerësuar vetëm për subjektet që kanë raportuar shitje gjatë periudhës, shfaq vlera më negative; balanca neto e përgjigjeve mbi situatën e përgjithshme nga ana e subjekteve që kanë raportuar shitje është -16%.

Gjatë pjesës së dytë të vitit 2016, Indeksi Fischer i çmimit të banesave në rang vendi u rrit me 12.8%. Ky zhvillim është ndikuar nga rritja e vëllimit të shitjeve në zonat qendrore të kryeqytetit dhe nga rritja e çmimit dhe vëllimit të shitjeve në zonat e tjera. Për zonën bregdetare, agjentët kanë raportuar rënie të çmimit mesatar dhe të vëllimit të shitjeve. Indeksi i çmimit mesatar për Tiranën vlerësohet 3.3% më i lartë në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar.*

Agjentët raportojnë numër pothuajse të njëjtë banesash të regjistruara në librat e tyre; balanca neto mes atyre që raportojnë rritje të numrit të banesave të regjistruara dhe atyre që raportojnë rënie të tyre, është pothuaj neutrale. Për pronat tregtare, balanca neto e numrit të pronave është rikthyer në vlera pozitive (2.6%), ndërkohë që gjatë gjashtëmujorit të kaluar balanca neto shënonte -17%. Numri i pronave të pashitura, si për banesat, ashtu edhe për godinat tregtare, ka shënuar rënie të theksuar në krahasim me periudhën e kaluar. Vlen të theksohet se, që nga fillimi i vitit 2013, ky është rasti i parë i raportimit të një rënieje në numrin e pronave të pashitura.

Koha mesatare e shitjes së pronave në rang vendi raportohet të jetë mesatarisht 13.7 muaj ose rreth 2 muaj më e gjatë në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar. Për Tiranën, subjektet e intervistuara kanë raportuar një kohë mesatare shitjeje prej 13.8 muajsh, ose pothuajse të njëjtë me gjashtëmujorin e kaluar. Për zonën e bregdetit, koha e shitjes ka rënë nga 10 muaj në rreth 8.4 muaj, ndërsa për zonat e tjera subjektet kanë raportuar thuajse të njëjtën kohë shitjeje me periudhën paraardhëse (15 muaj).

Sipas agjentëve, rreth 68% e pronave për banim dhe për përdorim tregtar të shitura prej tyre janë blerë me hua bankare. Kjo shifër shënon rritje të lehtë në krahasim me vlerën prej 65% të raportuar në periudhën paraardhëse. Pjesa e çmimit të shitjes së pronës që është mbuluar me kredi (LtV) vlerësohet rreth 53%, ose diçka më lart në krahasim me periudhat e mëparshme.

Agjentët janë optimistë për ecurinë e tregut në territorin ku ata veprojnë në të ardhmen afatshkurtër dhe ndjeshëm më pozitivë për periudhën afatgjatë (deri në dy vjet). Numri i pronave që pritet të regjistrohen për shitje gjatë periudhës në vazhdim, vlerësohet në rënie, ndërsa lidhur me ecurinë e mëtejshme të çmimeve të pronave të paluajtshme agjentët nuk presin ndryshime të ndjeshme.

** "Zona të tjera" përfshin të gjitha zonat përveç Tiranës dhe zonës së bregdetit.*

5. TREGJET FINANCIARE

5.1 TREGU I LETRAVE ME VLERË

(36) Gjatë periudhës, normat mesatare të interesit për titujt e borxhit të qeverisë shënuan rritje të lehtë, por rezultuan më të ulëta se një vit më parë. Në fund të vitit, norma mesatare e interesit të borxhit të qeverisë ishte 2.4% ose 0.3 p.p. më e lartë në krahasim me fundin e gjashtëmujorit të parë, por 1.2 p.p. më e ulët në krahasim me një vit më parë. Normat e kthimit në ankandet e tregut primar të titujve të borxhit, veçanërisht për ato me afat maturimi mbi një vit, u rritën duke reflektuar zhvillimet në raportin kërkesë-ofertë për këto instrumente. Gjatë periudhës, qeveria ka ulur nevojat për financim me borxh të brendshëm në masën 32% në nivelin 137 miliardë lekë. Struktura e emetimit vijon të dominohet nga bonot e thesarit, të cilat zënë 75% të totalit të borxhit të brendshëm të emetuar.

Grafik 5.1 Ecuria e normës mesatare të interesit të borxhit të emetuar në letra me vlerë, në përqindje



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 5.2. Përbërja e borxhit të emetuar gjatë 2015-2016



Burimi: Banka e Shqipërisë.

(37) Emetimet e borxhit afatshkurtër të qeverisë, shënuan rënie gjatë periudhës, por norma mesatare e interesit shënoi rritje. Gjatë pjesës së dytë të vitit, emetimet e titujve të borxhit të qeverisë në formën e bonove të thesarit shënuan 100 miliardë lekë, duke rënë me 32% ndaj pjesës së parë të vitit dhe me 21% ndaj një viti më parë. Tek emetimet e borxhit afatshkurtër, ato me afat maturimi 12 muaj zunë 74.0% të totalit të vëllimit. Norma mesatare e interesit të bonove të thesarit është rritur me 0.3 p.p., duke arritur në nivelin 1.9%. Në disa ankande, dhe kryesisht për bonot 3 dhe 6-mujore, oferta për investim ka qenë më e ulët nga kërkesa për huamarrje ose shuma e shpallur

nga qeveria, duke favorizuar rritjen e normës së interesit. Me një frekuencë më të ulët, fenomeni është vërejtur edhe në ankandet e bonove 12-mujore, interesi i të cilave u rrit nga 1.5% në fillim të periudhës, në 3.1% në fund të vitit.

Grafik 5.3. Teprica mbi shumën e ofruar për investim dhe normat e interesit të bonove të thesarit, për gjysmën e dytë të vitit 2016



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 5.4. Teprica mbi shumën e ofruar për investim dhe normat e interesit të obligacioneve, për gjysmën e dytë të vitit 2016



Burimi: Banka e Shqipërisë.

(38) I njëjti fenomen, për sa i takon emetimeve dhe ecurisë së normës së interesit u konstatua edhe për titujt e borxhit afatgjatë të qeverisë. Emetimet e titujve të borxhit në formën e obligacioneve, gjatë gjashtëmujorit të dytë, ishin rreth 35 miliardë lekë, rreth 34% më pak se në pjesën e parë të vitit, por pothuajse në të njëjtin nivel me një vit më parë. Rreth 70% e vëllimit të obligacioneve të emetuara përbëhet nga obligacionet me afat maturimi 2 dhe 5-vjeçar me normë fikse. Rënia e shpejtë e normës së ponderuar të interesit të obligacioneve në lekë gjatë pjesës së parë të vitit, u reflektua në uljen e kërkesës për investim në këto titujë në pjesën e dytë të tij. Në fakt, në disa

Grafik 5.5 Vëllimi dhe norma mesatare e ponderuar e kthimit të bonove të thesarit në tregun primar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 5.6 Vëllimi dhe norma mesatare e ponderuar e kthimit të të obligacioneve në tregun primar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

ankande të emetimit të obligacioneve, shuma e ofruar për investim qëndroi poshtë shumës së shpallur për huamarrje. Si rezultat, norma mesatare e interesit për tituj afatgjatë të borxhit të qeverisë u rrit lehtë, në nivelin 4.1%. Gjithsesi, ky nivel ishte ndjeshëm më i ulët se ai i fundit të vitit 2015.

(39) Në fund të periudhës, qeveria riemetoi borxh në euro afatmesëm për tregun e brendshëm, dhe zgjodhi të maturojë titujt e borxhit afatshkurtër në këtë monedhë. Në dhjetor të vitit 2016, qeveria maturoi titujt e borxhit në euro me afat 12 muaj, dhe riemetoi obligacione 2-vjeçare në euro. Ky ishte emetimi i vetëm në euro për vitin 2016 dhe zuri 3.4% të totalit të emetimeve gjatë periudhës. Në mungesë të emetimeve të borxhit afatshkurtër në euro, totali i borxhit në euro të emetuar për tregun e brendshëm ra me 57% në krahasim me fundin e vitit 2015. Tkurrja e ofertës së huamarrjes në euro, në prani të një kërkese të lartë të investitorëve për këtë instrument, u reflektua në uljen e normës së interesit të titullit në 0.75%, krahasuar me 3.23% në emetimin e ngjashëm të një viti më parë.

Grafik 5.7 Huamarrja e brendshme në euro



Burimi: Banka e Shqipërisë.

5.2 TREGU NDËRBANKAR

(40) Gjatë periudhës, vëllimi i transaksioneve në tregun ndërbankar shënoi rënie dhe normat e interesit qëndruan pranë nivelit të normës bazë të interesit të politikës monetare. Mbajtja e pandryshuar e normës bazë gjatë periudhës ka favorizuar nivele të ulëta të normave të interesit në tregun ndërbankar. Bankat kanë tregtuar në vëllime më të ulëta, me norma interesi që kanë qenë vazhdimisht nën ose pranë nivelit të normës bazë të interesit, duke reflektuar një situatë të qëndrueshme të likuiditetit. Në fund të vitit, norma mesatare e interesit për transaksionet ndërbankare me afat 1 dhe 7-ditor ishte 1.2% ose 0.3 pp më e ulët nga norma 1.5% e fundit të gjashtëmujorit të parë të vitit. Pavarësisht normave më të ulëta të interesit ndërbankar, vëllimi mesatar i huamarrjes njëditore dhe njëjavore shënoi rënie në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar. Rënie gjatë kësaj periudhe ka regjistruar edhe huamarrja me afat maturimi 1-mujor, pavarësisht se instrumenti përdoret rrallë dhe në vëllime më të vogla në krahasim me instrumentet e huamarrjes me afat më të shkurtër.

Grafik 5.8. Normat e interesit në tregun ndërbankar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

5.3 TREGU I KËMBIMEVE VALUTORE

Grafik 5.9 Ecuria e kursit të këmbimit në tregun e brendshëm valutor



Burimi: Banka e Shqipërisë.

(41) Gjatë periudhës, leku u mbiçmua ndaj monedhës evropiane dhe u nënçmua lehtë ndaj dollarit amerikan. Në terma mesatarë, në krahasim me monedhën evropiane, leku është mbiçmuar me 1.3%, në krahasim me gjashtëmujorin e parë të vitit. Nënçmimi i lekut ndaj dollarit amerikan gjatë periudhës ka reflektuar forcimin e këtij të fundit ndaj monedhës euro. Në krahasim me një vit më parë, monedha vendase është mbiçmuar me rreth 1.9% ndaj euros dhe me 1.3% ndaj dollarit amerikan.

6. ZHVILLIMET NË SISTEMET E PAGESAVE

(42) Infrastruktura bazë për klerimin dhe shlyerjen e pagesave në monedhë vendase ka vijuar të funksionojë me siguri dhe efikasitet, duke mbështetur qëndrueshmërinë financiare dhe zbatimin e politikës monetare. Gjatë kësaj periudhe, operimi i sistemit nuk ka reflektuar probleme me karakter operacional, financiar (të kreditit dhe likuiditetit) dhe ligjor, të cilat të kenë cenuar disponueshmërinë e sistemit. Në terma të aktivitetit, sistemi i pagesave me vlerë të madhe, AIPS, ka regjistruar një rritje në vlerë me rreth 48% nga e njëjta periudhë e vitit të kaluar, ndërkohë që numri i transaksioneve shënon rreth 65 mijë. Në këtë mënyrë, vlera mesatare e shlyerjes për transaksion ngjitet në rreth 68 milionë lekë, kundrejt rreth 46 milionë lekëve të një viti më parë.

Në sistemin e pagesave me vlerë të vogël, AECH, gjatë periudhës, janë kleruar 275.5 mijë pagesa, me një vlerë mesatare për transaksion prej rreth 0.18 milionë lekësh. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, aktiviteti i sistemit AECH ka regjistruar rritje si në numër, ashtu edhe në vlerë përkatësisht me 10.0% dhe 9.1%.

Grafik 6.1. Ecuria e aktivitetit në AIPS dhe AECH për gjashtëmujorin e dytë 2015-2016



Burimi: Banka e Shqipërisë.

(43) Numri i pagesave të kryera nëpërmjet instrumenteve specifike si transfertat e kreditit, kartat e debitit/kreditit, debitimi direkt, shënoi rritje gjatë periudhës, por vlera ishte më e ulët se një vit më parë. Konkretisht, nëpërmjet këtyre instrumenteve u kryen 11.9 milionë pagesa gjithsej gjatë vitit 2016, rreth 8.5% më shumë pagesa në krahasim me vitin 2015. Transfertat e kreditit në formë letre janë forma më e përdorur e instrumenteve të pagesave

Grafik 6.2. Ecuria e instrumenteve të pagesave në sasi dhe në vlerë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

(me 65%). Përgjithësisht përdorimi i të gjitha instrumenteve të pagesave ka shënuar rritje gjatë vitit 2016, duke përjashtuar çekun, përdorimi i të cilit zbriti me rreth 31%. Pavarësisht rritjes së përdorimit të instrumenteve të pagesave, vlera e tyre në total ka regjistruar një rënie prej 1.9% nga viti 2015, në 4,512 miliardë lekë, e diktuar kryesisht nga rënia e vlerës së transfertave të kreditimit në formë letre.

7. SISTEMI FINANCIAR

(44) Gjatë periudhës, veprimtaria e sistemit financiar u zgjerua dhe treguesit e tjerë ishin përgjithësisht të qëndrueshëm. Sektori bankar zgjeroi aktivitetin, duke u ngjitur në 94.9% të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) dhe rezultoi me fitim dhe me tregues të mirë të kapitalit dhe likuiditetit. Sektori jobankar ka ruajtur peshën e tij ndaj PBB-së, dhe në veprimtarinë e tij kanë kontribuar pozitivisht institucionet financiare jobanka dhe shoqëritë e sigurimit. Ekspozimi i drejtpërdrejtë i sektorit jobankar në sektorin bankar vlerësohet i ulët, ndërkohë që qëndrueshmëria e sektorit bankar mbetet një faktor me rëndësi kritike për aktivitetin dhe qëndrueshmërinë e sektorit jobankar. Për sektorin jobankar, investimet në titujt e borxhit të qeverisë shqiptare janë të rëndësishme, ndonëse gjatë vitit 2016 këto investime kanë shënuar rënie.

(45) Veprimtaria e sistemit financiar është zgjeruar gjatë periudhës me ritme më të shpejta. Konkretisht, raporti i aktiveve të sistemit financiar[26] ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) u ngjit në nivelin 105.1%, me një rritje prej rreth 4 p.p., pas një periudhe stanjative gati dyvjeçare. Kontributin kryesor në këtë rritje e ka dhënë aktiviteti i sektorit bankar, i cili është zgjeruar me ritme më të larta se rritja e PBB-së. Struktura e aktiveve të sistemit financiar mbizotërohet nga bankat, aktivet e të cilave zënë rreth 90.4% të aktiveve të sistemit ose rreth 94.9% të PBB-së. Gjatë periudhës, ky mbizotërim është rritur më tej.

Tabelë 7.1 Pesha e segmenteve të sistemit financiar ndaj PBB-së në vite

Autoriteti Licencues dhe Mbikëqyrës	Sistemi financiar	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Banka e Shqipërisë	Sektori bankar	84.7	89.6	90.5	91.7	91.3	94.9
	Institucione jobanka	2.5	2.7	2.5	2.7	2.7	2.9
	SHKK dhe Unionet e tyre	0.7	0.8	0.8	0.8	0.7	0.6
Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare	Shoqëri sigurimi	1.5	1.6	1.6	1.7	1.9	2.1
	Fondet e pensionit	0.01	0.02	0.03	0.04	0.1	0.1
	Fonde Investimi		1.21	3.7	4.5	4.7	4.4
Ndërmjetësimi financiar		89.41	95.93	99.13	101.4	101.3	105.1

Burimi: Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare.

Grafik 7.1 Rritja vjetore e aktiveve të segmenteve përbërës të sistemit financiar



Burimi: Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare.

[26] *Sistemi financiar përbëhet nga bankat, institucionet financiare jobanka, shoqëritë e kursim-kreditit (SHKK), shoqëritë e sigurimit, fondet e pensioneve suplementare, si dhe fonde të investimit. Në analizën e këtij kapitulli, konsideroni që baza e të dhënave të shoqërive të sigurimit (bilanci) dhe fondet e pensionit i referohen tremujorit të tretë të vitit 2016; përsa i përket segmenteve të tjera të sistemit financiar, raportimi i fundit mbi aktivitetin e tyre i takon gjashtëmujorit të dytë të vitit 2016.*

7.1 ZHVILLIMET NË SEKTORIN JOBANKAR

Institucionet që mbikëqyren nga Banka e Shqipërisë

(46) Gjatë periudhës, institucionet financiare jobanka (IFJB), shënuan zgjerim të aktivitetit dhe tregues më të mirë të performancës financiare. Konkretisht, rritja e aktiveve u mbështet nga zgjerimi i aktivitetit kreditues dhe investimeve në formën e depozitave në sektorin bankar. Rezultati financiar i IFJB-ve ishte pozitiv, kapitalizimi i kënaqshëm dhe cilësia e aktiveve ka ardhur në përmirësim. Në fund të vitit 2016, sistemi financiar përmbante 28 IFJB të angazhuara kryesisht në fushën e mikrokredisë, kreditimit, *leasing*-ut, *faktoring*-ut, parasë elektronike etj. Peshën kryesore e zënë IFJB-të që kryejnë aktivitet kreditues, ndjekur nga ato që kryejnë pagesa dhe transferta. Aktivet e IFJB-ve shënuan 44 miliardë lekë, në rritje me 8.7% ndaj muajit qershor dhe 10.7% ndaj një viti më parë. Peshën kryesore në strukturën e aktiveve e zënë "veprimet me klientë" që përfaqësojnë aktivitetin kreditues, ndjekur nga mjetet jofinanciare, të cilat kanë dhënë kontributin kryesor në zgjerimin e aktiveve. Rreth 87.6% e portofolit të kredisë së IFJB-ve përbëhet nga bizneset, të cilat veprojnë kryesisht në sektorin e tregtisë (24%) dhe bujqësisë (14%). Rezultati financiar i IFJB-ve u përmirësua në 1.3 miliardë lekë nga 0.7 miliardë lekë një vit më parë.

Grafik 7.2 Struktura e institucioneve financiare jobanka sipas llojit të aktivitetit që kryejnë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 7.3. Struktura e aktiveve të institucioneve financiare jobanka



Burimi: Banka e Shqipërisë.

(47) Ecuria e aktivitetit të shoqërive të kursim kreditit (SHKK), ka qenë më e mirë gjatë periudhës, por në krahasim me një vit më parë ajo është tkurrur. Ky rezultat reflekton procesin e ristrukturimit të veprimtarisë së këtyre institucioneve, në vijim të kërkesave të ligjit të ri që rregullonte veprimtarinë e tyre dhe përfshirjes në skemën e sigurimit të depozitave. Veprimtaria kryesore e këtyre institucioneve reflekton të njëjtën ecuri si aktiviteti i përgjithshëm. Rezultati financiar i SHKK-ve u kthye në terma pozitivë (5 milionë lekë), në krahasim me

humbjen financiare të vitit 2015 (274 milionë lekë). Kreditë për klientët, aktivet e tjera (kryesisht investime në aksione) dhe aktivet e qëndrueshme përfaqësojnë zërat kryesorë të aktiveve të këtyre institucioneve. Në fund të vitit 2016, tregu kishte 9 shoqëri aktive të kursim-kredititi.

Grafik 7.4. Struktura e aktiveve të shoqërive të kursim-kredititi



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Institucione që mbikëqyren nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

(48) Shoqëritë e sigurimit kanë zgjeruar aktivitetin e tyre gjatë periudhës. Në gjysmën e dytë të vitit 2016, numërohen 12 shoqëri sigurimi të licencuara[27]. Aktivet e këtyre institucioneve u zgjeruan në 14.4%[28] në terma vjetorë, dhe ishin përqendruar në investime në formën e depozitave me afat në banka, në aksione, në tituj të borxhit të qeverisë dhe provigjione teknike. Shoqëritë e sigurimit kanë zgjeruar ndjeshëm dhe kapitalin total, me rreth 11.5% në terma vjetorë.

Grafik 7.5. Struktura e aktiveve të shoqërive të sigurimit



Burimi: Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Në veprimtarinë e sigurimeve, të ardhurat nga primet (që paguhen në avancë) përdoren për pagesat e detyrimeve dhe mbulimin e kostove që mund të rrjedhin kur ndodh ngjarja e sigurimit. Primet e shkruara bruto[29], që përfaqësojnë burimin kryesor të financimit të aktivitetit të shoqërive të sigurimit, u zgjeruan me 9.6% në terma vjetorë. Treguesi i depërtimit të tregut të sigurimeve, i matur si raporti i primeve ndaj PBB-së, u rrit në 1.04% nga 0.97%, që shënonte një vit më parë. Treguesi i humbjeve ose raporti i dëmeve të paguara ndaj primeve të shkruara bruto u rrit në 27.7% nga 25.8% një vit më parë. Ky zhvillim reflekton rritjen më të shpejtë të pagesave të dëmeve në krahasim me të ardhurat nga primet bruto. Vlera e dëmeve të paguara bruto u rrit me 17.5% në terma vjetorë në nivelin 4.3 miliardë lekë.

(49) Aktiviteti i fondeve të investimit[30] u ngadalësua, si rezultat i rënies së investimeve në titujt e borxhit të qeverisë. Fondi i investimeve është një sipërmarrje me pjesëmarrje të hapur, e krijuar në bazë të një kontrate, nëpërmjet

[27] *8 shoqëri sigurimi të jojetës, 3 shoqëri sigurimi të jetës dhe 1 shoqëri risigurimi.*
[28] *Niveli i aktiveve të shoqërive të sigurimit i referohet muajit shtator 2016, si raportim i fundit i bilancit të tyre pranë Bankës së Shqipërisë.*
[29] *AMF, Buletini Statistikor "Tregu i Sigurimeve: Janar-Dhjetor 2016", publikuar më 25 janar 2017.*
[30] *AMF, "Të dhëna të përgjithshme të fondeve të investimeve", 31 dhjetor 2016*

Grafik 7.6. Struktura e aktiveve të fondeve të investimeve



Burimi: Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Grafik 7.7 Struktura e investimeve të fondeve të pensioneve private suplementare



Burimi: Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

ofertës publike të kuotave[31], të cilat përfaqësojnë të drejtat ose interesat e investitorëve. Normat e kthimit nga pjesëmarrja e investitorëve në fondet e investimit është zakonisht më e lartë se ajo e depozitave në banka, duke reflektuar profilin më të lartë të rrezikut[32] që përmban investimi në fond. Në sistemin financiar shqiptar bëjnë pjesë 3 fonde investimi aktive, njëri prej të cilëve e nisi veprimtarinë në mes të vitit 2016. Aktivet e fondeve investohen kryesisht në bono thesari dhe obligacione të emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë në lekë dhe të tjera në euro.

Në vitin 2012, fondet e investimeve numëronin 7,149 anëtarë, ndërsa në fund të vitit 2016, ky numër ishte rreth 4 herë më i lartë (29,267 anëtarë). Vlera e aktiveve neto në shtator 2012, rezultonte 16.9 miliardë lekë, ndërkohë që në vitin 2016, vlera neto e aktiveve ishte 65.4 miliardë lekë (4.4% e PBB-së së vendit).

(50) Edhe fondet e pensioneve private suplementare[33] kanë zgjeruar veprimtarinë e tyre gjatë periudhës. Në fund të vitit 2016, në Shqipëri vepronin tre fonde pensionesh private vullnetare. Në fund të tremujorit të tretë të vitit 2016, aktivet e këtyre fondeve shënuan vlerën 1.2 miliardë lekë ose 29% më shumë së një vit më parë. Aktiviteti i fondeve të pensionit dominohet nga investime në titujt e borxhit të qeverisë. Vlera e këtyre investimeve ishte rreth 1.1 miliardë lekë ose 30% më e lartë ndaj fundit të tremujorit të tretë të vitit 2015. Sipas raportimeve të fundit, numri i anëtarëve të fondeve të pensionit ishte rreth 16,000.

[31] *Ligji, nr.10 198, datë 10.12.2009 për "Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive", AMF.*

[32] *Në një rast ekstrem që lidhet me lëvizjet e pafavorshme në treg dhe/ose keqmenaxhimin e një fondi, e tërë vlera e investuar nga investitori në një fond mund të humbasë. Në një rast të ngjashëm në banka, kursimet e depozituesit janë të mbrojtura të paktën deri në vlerën 2.5 milionë lekë (sipas parashikimeve në ligjin "Për sigurimin e depozitave"). Në çdo rast, si fondet e investimit, ashtu edhe bankat, i nënshtrohen kërkesave rregullative për treguesit financiarë të veprimtarisë së tyre, me qëllim që mundësia e dështimit të tyre të jetë sa më e vogël.*

[33] *AMF, Raporti Statistikor "Tregu i Pensioneve Private Vullnetare", 30 shtator 2016, publikuar më 21 nëntor 2016.*

7.2 VLERËSIMI I RREZIQEVE DHE EKSPOZIMEVE TË SEKTORIT JOBANKAR

(51) Ekspozimi i sektorit bankar ndaj sektorit jobankar në vend mbetet i ulët. Ky ekspozim, në krahun e aktivit të bankave përfaqësohet nga huatë dhe pjesëmarrja në kapital në institucionet financiare jobankare, ndërsa në krahun e detyrimeve në formën e fondeve të mbledhura prej tyre (llogarive të ndryshme). Në total, ky ekspozim zë vetëm 1.8% të vlerës së aktiveve të sektorit bankar.

(52) Nga ana tjetër, ekspozimi i sektorit jobankar ndaj sektorit bankar mbetet i konsiderueshëm. Në total, ky ekspozim përbën 16.4% të aktiveve të sektorit jobankar, në rritje me 0.8 pp ndaj një viti më parë[34]. Shoqëritë e sigurimit dhe institucionet financiare jobanka (IFJB) shfaqin ndjeshmërinë më të madhe ndaj sektorit bankar, pasi vendosjet e tyre në formën e depozitave përbëjnë 31% dhe 19% të aktiveve përkatëse. Për shoqëritë e sigurimit, pesha e këtyre depozitave në totalin e veprimtarisë së tyre ka ardhur në rënie në 5-6 vitet e fundit. Fondet e investimeve dhe fondet e pensioneve paraqesin gjithashtu ekspozim në rritje, edhe pse ky ekspozim vlerësohet i ulët. Ekspozimi i shoqërive të kursim-kreditit, ka ardhur në rritje në dy vitet e fundit.

Grafik 7.8. Ekspozimi i institucioneve kryesore jobankare ndaj sektorit bankar, në raport me totalin e aktiveve të tyre



Burimi: Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, përpunime nga Banka e Shqipërisë.

Grafik 7.9 Investimet e institucioneve të sektorit jobankar në titujt e qeverisë, ndaj totalit të aktiveve të tyre



Burimi: Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, përpunime nga Banka e Shqipërisë.

(53) Investimet e institucioneve financiare jobankare në titujt e borxhit të qeverisë[35] janë në vlera të konsiderueshme. Pesha e këtyre investimeve në aktivet e sektorit jobankar ka zbritur gjatë 2016-ës në 41%, kundrejt rreth 44%, që shënonte në fund të vitit 2015. Në raport me aktivet e tyre, fondet e pensioneve dhe fondet e investimeve kanë nivelin më të lartë të ekspozimit ndaj borxhit të qeverisë.

[34] *Të dhënat i referohen tremujorit të tretë të vitit 2016.*

[35] *Të dhënat për investimet në letrat me vlerë të qeverise për fondet e pensionit i përkasin tremujorit të tretë të vitit 2016.*

(54) Rreziku i kredisë është rreziku që prek në masën më të madhe aktivitetin e institucioneve financiare jobankare aktive në kredidhënie dhe atë të shoqërive të kursim-kreditit. Në dhjetor të vitit 2016, raporti i huave me probleme ndaj totalit të huave për këto dy segmente shënoi rënie, përkatësisht në 11.6% dhe 6.7%, nga 12.7% dhe 8.7% një vit më parë.

(55) Rreziqet e tregut, kryesisht ai që lidhet me nivelet dhe luhatshmërinë e normave të interesit, përbëjnë një shqetësim më të madh për veprimtarinë e shoqërive të sigurimit, të fondeve të investimit dhe të fondeve të pensionit. Mënyra e ndikimit nga ky rrezik, përcaktohet jo vetëm nga masa e goditjes, por edhe nga struktura e aktiveve dhe detyrimeve të çdo institucioni.

Konkretisht, shoqëritë e sigurimit të jetës që ofrojnë pagesa të garantuara për t'u kryer në të ardhmen, por që kanë një portofol investimesh afatshkurtra, përballen me rënien e të ardhurave nga riinvestimi, veçanërisht gjatë një periudhe të zgjatur me rënie të normave të interesit. Për shoqëritë e sigurimit të jojetës, ky rrezik është ndjeshëm më i ulët, pasi ato kanë një përputhje më të mirë mes aktiveve dhe detyrimeve (të dyja, përgjithësisht afatshkurtra). E njëjta gjë ndodh edhe në rastin e rritjes së normave të interesit, ku shoqëritë e sigurimit që kanë investime afatgjata do të përballen fillimisht me humbje në vlerën e tregut të tyre.

Tek fondet e investimeve[36], ndjeshmëria ndaj rrezikut të luhatshmërisë së normave të interesit reflekton nevojën për vlerësimin e rregullt me vlerën e tregut të kuotave të pjesëmarrjes në fond, si rezultat i mundësisë së tërheqjes së tyre në çdo kohë. Aktivet e fondeve investohen në instrumente financiare, të cilat janë lirisht të tregtueshme dhe çmimi i të cilave mund të ndryshojë vazhdimisht. Kur normat e interesit rriten, çmimi i instrumenteve financiare bie. Kjo rënie sjell ulje të vlerës së portofolit të investimeve e për rrjedhojë rënie të kthimit nga investimi, që reflektohet në rënien e çmimit të kuotës dhe rritjen e mundësisë për tërheqje. Fondi mund të jetë i detyruar të ndryshojë strukturën dhe kompozimin e portofolit të aktiveve të tij, në mënyrë që të plotësojë kërkesën për shlyerje. Ky veprim mund të ketë një efekt negativ në performancën e fondit, duke qenë se shitja e instrumenteve financiare, në mënyrë të parakohshme, mund të rezultojë në humbje dhe në rënie të mëtejshme të çmimit të kuotës. Për sa i takon rrezikut të kursit të këmbimit, fondet kanë një rrezik të ulët duke qenë se sigurojnë një përputhje më të mirë të zërave të bilancit sipas monedhave. Fondet e investimeve mund të ekspozohen edhe ndaj rrezikut reputacional të lidhur me performancën e shoqërisë që administron fondin. Gjithashtu, një rrezik i mundshëm është edhe ai i pamundësisë së shlyerjeve në shuma të mëdha, kur ka tërheqje të konsiderueshme të kuotave nga anëtarët e fondit.

Fondet e pensionit privat suplementar përgjithësisht mbështeten në plane të përcaktuara kontributi. Lëvizja e normave të interesit do të sillte luhatshmëri në nivelet e kthimeve nga investimi dhe ndoshta më pak përfitime. Ky rrezik mund të zbutet vetëm nëse punonjësi apo punëdhënësi kontribuon më shumë në fond.

[36] *Prospekt i Fondeve "Raiffeisen Prestigj dhe Raiffeisen Invest Euro"- Shkurt 2017, faqja zyrtare e Raiffeisen Invest.*

8. ZHVILLIMET NË SEKTORIN BANKAR

(56) Gjatë gjysmës së dytë të vitit 2016, sektori bankar ka pasur ecuri të qëndrueshme. Në krahasim me një vit më parë, veprimtaria e sektorit është zgjeruar me ritme më të larta, mbështetur kryesisht në rritjen e stokut të investimeve në titujë. Treguesit prudencialë në terma të aftësisë paguese, likuiditetit dhe krijimit të fondeve rezervë për rreziqet përkatëse u shfaqën në nivele të përshtatshme, duke qenë në përputhje me kërkesat rregullatore. Procesi i vazhdueshëm i fshirjes së kredive të humbura nga bilancet e bankave, ka ngadalësuar ritmin e rritjes së huave me probleme. Pavarësisht këtij zhvillimi, sektori bankar vijon të mbetet i ekspozuar ndaj rrezikut të kreditit. Ekspozimi ndaj rreziqeve të tregut mbetet i kontrollueshëm, por kërkon një monitorim dhe vlerësim të rregullt.

8.1 ECURIA E AKTIVITETIT BANKAR

(57) Veprimtaria e sektorit bankar është zgjeruar me ritme më të shpejta gjatë periudhës. Në terma vjetorë, norma e rritjes së totalit të aktiveve të sektorit bankar shënoi vlerën 6.8%, kundrejt 1.9% një vit më parë. Në krahun e aktivit të bilancit, rritjen më të shpejtë e ka shënuar zëri "Veprime me letra me vlerë" ndjekur nga zgjerimi i veprimeve me thesarin[37] dhe ndërbankare[38] dhe zhvillimet pozitive edhe në aktivitetin kreditues. Në anën e pasiveve, zërat kryesorë vijojnë të mbeten "Veprimet me klientë", që përfaqësojnë aktivitetin depozitues dhe "Burimet e përhershme", që përfaqësojnë fondet e veta (kapitalin) e bankave. Vetëm gjatë periudhës, aktivet e sektorit bankar u zgjeruan me 5.8%, duke arritur në nivelin 1,407.3 miliardë lekë. Zgjerimi i aktiveve gjatë periudhës u mbështet nga investimet në letra me vlerë[39], kryesisht në tituj të borxhit qeveritar, por edhe në tituj të emetuar nga subjekte jorezidente. Zotërimet e sektorit bankar në titujt e borxhit të qeverisë shqiptare përfaqësojnë

[37] *Gjatë gjysmës së dytë të vitit 2016, veprimet me bankën qendrore në formën e "llogarive rrjedhëse" kanë shënuar një rritje të konsiderueshme me rreth 27.7 miliardë lekë, në nivelin 50.6 miliardë lekë.*

[38] *Investimet ndërbankare shënuan një rritje gjashtëmujore me rreth 5.3 miliardë lekë, në nivelin e 213.4 miliardë lekëve. Këto investime ishin kryesisht në formën e "Llogarive rrjedhëse për bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare" dhe "Huave për bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare" ndaj jorezidentëve, duke u rritur respektivisht në masën 11.2 miliardë lekë dhe 9.4 miliardë lekë, në nivelin e 60.8 miliardë lekëve dhe 62 miliardë lekëve. Ngushtim kanë shënuar vetëm investimet ndërbankare në formën e "Depozitave në bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare" kryesisht ndaj jorezidentëve në masën 15.6 miliardë lekë, në nivelin e 88.1 miliardë lekëve.*

[39] *Portofoli i investimeve në letrat me vlerë shënoi një rritje me rreth 31.2 miliardë lekë ose 9.2% krahasuar me gjysmën e parë të vitit 2016, duke u ngjitur në nivelin 368.4 miliardë lekë. Këto investime ishin kryesisht në formën e letrave me vlerë të vendosjes, të investimit dhe REPO (jorezidente) në nivelin 108 miliardë lekë, ose 28.2% më shumë nga qershori 2016.*

22% të totalit të aktivit, nga 23% një gjashtëmujor më parë, dhe ecuria është përcaktuar kryesisht nga rritja më e shpejtë e aktiveve[40].

Tabelë 8.1. Struktura e bilancit të bankave, dhjetor 2016

Aktivi	% e aktiveve	Ndryshimi vjetor,%	Pasivi	% e pasiveve	Ndryshimi vjetor,%
I. Veprime me thesarin dhe ndërbankare	32.9	3.1	I. Veprime me thesarin dhe ndërbankare	4.4	26.4
II. Veprime me klientët (Kredia)	42.4	2.5	II. Veprime me klientët (Depozita)	81.9	5.4
Nga e cila: për sektorin publik	2.04	-2.8	Nga të cilat: të sektorit publik	2.1	11.6
Nga e cila: për sektorin privat	40.6	2.8	Nga të cilat: të sektorit privat	80.2	5.1
III. Veprimet me letrat me vlerë	26.2	19.7	III. Veprimet me letrat me vlerë	0.4	807.71
IV. Fonde rezervë të krijuara	-5.6	3.7	IV. Detyrime të tjera	0.9	37.7
V. Të tjera*	4.2	4.6	V. Burimet e përhershme	11.9	6.1
			Nga të cilat: Borxhi i varur	1.6	-1.7
			Nga të cilat: Kapitali aksioner	9.7	9.01
			VI. Interesa të përllogaritura	0.3	-26.1
Totali i aktiveve	100	6.8	Totali i pasiveve	100	6.8

Burimi: Banka e Shqipërisë.
** Tek zëri "Të tjera" në bilanc i referohemi "Mjeteve të tjera", "Mjeteve të qëndrueshme" dhe "Interesave të përllogaritura".*

(58) Portofoli i kredisë[41] së sektorit bankar është zgjeruar me 0.6% në terma gjashtëmujorë dhe 2.5% në terma vjetorë, duke arritur nivelin 596.9 miliardë lekë në fund të vitit 2016. Pavarësisht procesit të vazhdueshëm të fshirjes së huave të humbura, fondi i provigjionimit shënoi rritje, duke reflektuar një fluks të ri në klasat e kredisë me probleme gjatë vitit dhe zhvendosjen e saj midis kategorive të klasifikimit.

(59) Financimi i aktivitetit bankar sigurohet kryesisht nga depozitat, të cilat përbëjnë rreth 82% të totalit të aktiveve. Raporti hua/depozita shënon 52%. Baza e depozitave[42] ka shënuar rritje pothuajse në të njëjtat nivele si në terma gjashtëmujorë, ashtu edhe vjetorë (rreth 5.2%), mbështetur nga depozitat në valutë. Në shpërndarjen sipas maturiteteve, vërehet një zhvendosje e depozitave drejt llogarive rrjedhëse[43]. Ky zhvillim përbën një dobësi potenciale për sa i takon strukturës së financimit të sektorit bankar, i cili megjithatë, zbutet nga fakti që 83% e depozitave mbahet nga individët dhe, në tërësi, maturiteti i mbetur i pasiveve ka ardhur në rritje për shkak të rritjes së vlerës së depozitave me afat maturimi mbi 1 vit. Bankat kanë ruajtur raportin e përdorimit të kapitalit të tyre për financimin e veprimtarisë, duke respektuar kërkesat përkatëse të kuadrit rregullativ.

(60) Sektori bankar shqiptar karakterizohet nga një përqendrim i lartë për disa nga aktivitetet e tij. Në Grafikun 8.1 (majtas), tregohen produktet

[40] *E gjithë rritja e investimeve në titujt e borxhit të qeverisë erdhi nga zgjerimi i portofolit të obligacioneve. Në gjysmën e dytë të vitit 2016, portofoli i bonove të thesarit u ngushtua me rreth 1.9 miliardë lekë krahasuar me qershorin 2016, në nivelin 68.9 miliardë lekë, ndërkohë që portofoli i obligacioneve shënoi rritje me rreth 5.2 miliardë lekë, në nivelin 240.7 miliardë lekë.*

[41] *Pa përfshirë interesat e përllogaritura.*

[42] *Këtu i referohemi "Veprimeve me klientë", në bilancin e bankave pa përfshirë interesat e përllogaritura.*

[43] *Në dhjetor 2016, pesha e llogarive rrjedhëse rezultoi 32.3%, nga 28.5% në qershor 2016 dhe 27.0% një vit më parë.*

bankare (në aktiv dhe në pasiv të bankave), për të cilat sektori bankar paraqet një përqendrim të moderuar ose më të ulët. Këtu mund të veçojmë rritjen e nivelit të përqendrimit për kredinë në lekë dhe kredinë për biznese. Në Grafikun 8.1 (djathtas), tregohen aktivitetet për të cilat sektori bankar shfaq një përqendrim më të lartë, kryesisht në aktiv të bilancit të sektorit bankar. Tek këto përfshihen veprimet e huadhënies, kryesisht me subjektet financiare jorezidente.

Grafik 8. 1. Treguesi Herfindahl për produktet kryesore bankare



Burimi: Banka e Shqipërisë.

8.2 POZICIONI I SEKTORIT BANKAR NDAJ JOREZIDENTËVE

(61) Varësia e sektorit bankar nga burime të jashtme të financimit mbetet e kufizuar. Pozicioni neto i sektorit bankar ndaj jorezidentëve vijon të mbetet "kreditor" dhe ka ardhur duke u zgjeruar gjatë periudhës. Huamarrja nga grupet bankare vijon të mbetet e ulët.

(62) Sektori bankar ka zgjeruar pozicionin kreditor në subjektet jorezidente. Në dhjetor 2016, aktivet me jorezidentët përbëjnë 27% të totalit të aktiveve, ndërsa detyrimet përbëjnë 6% të tyre. Si rezultat, pozicioni neto kreditor është zgjeruar me rreth 11% në terma gjashtëmujorë dhe rreth 19% në terma vjetorë, duke arritur në nivelin 293 miliardë lekë. Rritja më e madhe në transaksionet me jorezidentët në anën e aktivit (me 48% në terma vjetorë) është evidentuar në klasën "Veprime me letrat me vlerë". Detyrimet ndaj jorezidentëve përbëhen në masën më të madhe nga "Veprimet me klientët" (vendosja e depozitave të jorezidentëve në bankat vendase), si dhe nga "Burimet e përhershme" ose fondet e veta. Gjatë pjesës së dytë të vitit, ndryshe nga pjesa e parë e tij, vërehet rënie e zërit "Veprime ndërbankare", që përfshin depozitat dhe huatë e marra nga institucionet financiare jorezidente, çka tregon ulje të mëtejshme të varësisë nga burimet e jashtme të financimit.

Grafik 8.2 Kontributi i zërave në rritjen vjetore të aktiveve me jorezidentët, p.p



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 8.3 Përbërësit e detyrimeve jorezidente



Burimi: Banka e Shqipërisë.

(63) Pretendimet në formën e vendosjeve[44] tek grupet bankare zotëruese zënë një peshë të ulët, rreth 2.8% të aktivit të sektorit bankar, ndërsa pasivet zënë vetëm 0.02% të tyre. Vendosjet në grupet bankare zotëruese janë rritur me 2.7% në terma vjetorë. Në totalin e tyre, 48.1% i takojnë bankave të G3, 41.1% i takojnë atyre të G2 dhe 10.8% i takojnë atyre të G1. Sipas origjinës së kapitalit, grupi italian zë 39.8% të totalit, ndërsa ai grek zë 22.7% të vendosjeve në grupet bankare zotëruese.

(64) Masat me natyrë kundërciklike të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë në maj të vitit 2013 kanë kontribuar në zbutjen e ritmit të rritjes së investimeve të sektorit bankar pranë subjekteve jorezidente, por ky ndikim është dobësuar gjatë periudhës. Gjatë pjesës së parë të vitit, ritmi vjetor i rritjes së investimeve të sektorit bankar pranë jorezidentëve prej rreth 3.4%, ishte dukshëm më i ulët në krahasim me ritmet e rritjes së këtyre investimeve në kohën kur filloi zbatimi i masave prej rreth 25%. Gjatë gjysmës së dytë të vitit, rritja e shpejtë e burimeve të financimit në valutë dhe ulja e efektit penalizues të këtyre masave, është reflektuar në zgjerimin e aktiveve me jorezidentët me rreth 15.6% në terma vjetorë, në mungesë të alternativave të mjaftueshme të investimit në vend. Pesha e aktiveve me jorezidentët, të cilat janë subjekt i masave kundërciklike u ngjit në nivelin 80.3% të totalit të aktiveve me jorezidentët, nga 79.4% një vit më parë. Brenda grupit të aktiveve me jorezidentët, që janë subjekte të masave të sipërpërmendura, vërehet një zgjerim i ndjeshëm i investimeve në tituj. Përgjatë vitit 2016, ritmi i rritjes në aktivet jorezidente të sektorit, që nuk janë objekt i masave kundërciklike, ka qenë më i ulët dhe i qëndrueshëm, duke shënuar vlerën prej 10.9% në dhjetor 2016. Për vitin 2017, Banka e Shqipërisë do të vijojë zbatimin e masave në adresim të uljes së ritmit të investimeve në subjekte jorezidente nga sektori bankar, por mënyra e zbatimit të masës ka ndryshuar. Duke filluar nga muaji mars 2017, Banka e Shqipërisë do të ruajë një kërkesë

[44] *Nuk përfshihen investimet në tituj dhe kredia për subjektet jofinanciare jorezidente.*

më të lartë për kapital për masën e ndryshimit të vendosjeve me jorezidentët, por këtë herë periudha bazë e krahasimit do të ndryshojë sipas një periudhe rrëshqitëse dyvjeçare. Ndryshimi i mënyrës së zbatimit të masës, adreson nevojën për të shmangur rritjen e pakufizuar të kërkesës për kapital shtesë.

8.3 ZHVILLIMET NË KREDITIM

(65) Në fund të gjashtëmujorit të dytë të vitit 2016, teprica e kredisë në bilancin e sektorit bankar shënoi nivelin 600.4 miliardë lekë, duke e zgjeruar me 2.5% në terma vjetorë. Ecuria e portofolit të kredisë përfitoi nga dhënia e kredisë së re gjatë periudhës në masën 140.4 miliardë lekë. Për të njëjtën periudhë, sektori bankar mblodhi kredi në masën 150.2 miliardë lekë, rreth 8.4% më shumë së një vit më parë. Aktiviteti kreditues është mbështetur nga ulja e vazhdueshme e normës së interesit të kredisë së re në nivelin 5.32%, rreth 1.1 p.p. më e ulët së niveli i qershorit 2016.

Tabelë 8.2. Ecuria e kredisë

Treguesi dhe njësia	Vlera (mld lekë)	Pesha ndaj totalit të kredive (%) 2016	Pesha ndaj totalit të kredive (%) 2015	Ndryshimi gjashtëmujor	Ndryshimi vjetor
Kredia në lekë	248.3	41.4%	39.9%	4.1%	8.2%
Kredia në valutë	352.1	58.6%	60.1%	-1.9%	-1.2%
Sektori publik	28.7	4.8%	4.7%	1.6%	-2.82
Biznese	403.0	67.1%	67.4%	0.04%	2.4%
Individë	168.7	28.1%	27.9%	1.4%	3.7%
Afatshkurtër	190.9	31.8%	33.1%	-3.4%	-3.9%
Afatmesëm	121.5	20.2%	18.7%	8.5%	13.6%
Afatgjatë	287.9	48.0%	48.2%	0.0%	2.8%
Teprica e kredisë	600.4	100.0%	100.0%	0.5%	2.5%

Burimi: Banka e Shqipërisë.

(66) Në strukturën e portofolit të kredisë, pesha e kredisë në lekë ka vijuar rritjen. Në harkun kohor të një viti, teprica e kredisë në monedhën vendase është zgjeruar me 8.2%, ndërsa ajo në valutë është ngushtuar me 1.2%. Kredia e re në lekë, dhënë gjatë periudhës, është rritur me 21 p.p. dhe zë 61% të totalit të kredisë së re të periudhës. Ajo vijon prirjen rritëse të viteve të fundit, duke u zgjeruar me 62% nga e njëjta periudhë të një viti më parë. Kredia e re në valutë, dhënë gjatë periudhës, është ulur me 31% ndaj të njëjtës periudhë të një viti më parë. Në mbështetje të kreditimit në monedhën vendase, sektori bankar ka ulur normën e interesit të kredisë së re në lekë me 1.8 p.p. në nivelin 5.5%. Norma e interesit të kredisë së re në euro shënon 4.6%, në rënie më të ngadaltë me 0.73 p.p. gjatë periudhës.

Grafik 8.4. Teprica e kredisë, rritje vjetore



Burimi : Banka e Shqipërisë.

Grafik 8.5 Kredia e re, mesatare rrëshqitëse 3-mujore



Burimi : Banka e Shqipërisë.

(67) Sektori bankar ka përshpejtuar kreditimin e individëve, por ka ulur ritmin e kreditimit për bizneset. Në terma vjetorë, teprica e kredisë për individë është zgjeruar me 3.7%, ndërsa ajo për biznese është zgjeruar me 2.4%[45]. Gjatë periudhës, kredia e re për individët u rrit me 14.3% ndaj të njëjtës periudhë të një viti më parë, ku kontributin kryesor në zgjerim (rreth 60%) e dha kredia për blerje të pasurisë së paluajtshme. Në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë, pesha e saj në kredinë e re dhënë individëve është rritur me 3 pp, në nivelin 39%. Në të kundërt, gjatë periudhës, kredia e re për bizneset u ngushtua me 12.2%, ndikuar nga ngushtimi i kreditimit për "blerje pajisjesh", për "kapital qarkullues" dhe në formën "overdraft". Teprica e kredisë

Grafik 8.6 Kredia e re sipas qëllimit të përdorimit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

[45] *Referuar rezultateve të "Vrojtimit të Aktivitetit Kreditues për Tremujorin e Katërt 2016", sektori bankar ka lehtësuar standardet e kreditimit të individëve dhe ka shtrënguar standardet e kreditimit për bizneset, duke reflektuar për këto të fundit problemet specifike të sektorit, kreditë me probleme dhe perceptimin e bankave mbi situatën makroekonomike.*

dhënë sektorit publik zë një peshë të ulët, 4.8% të totalit, por kredia e re dhënë gjatë periudhës për këtë sektor përbën 12.6% të totalit.

(68) Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rrezikut të tërthortë të kredisë mbetet i lartë, kryesisht për biznesin. Në dhjetor 2016, kredia në valutë e pambrojtur nga lëvizjet e pafavorshme të kursit të këmbimit (kredia e pambrojtur në valutë) përbën 45.3% të kredisë totale në valutë (1.2 pp më shumë se muaji qershor 2016) dhe 26.6% të tepricës totale të kredisë (pothuajse i njëjti nivel krahasuar me periudhën paraardhëse). Sipas subjekteve, teprica e kredisë së pambrojtur në valutë për bizneset, zë 74% të totalit të kësaj kredie. Teprica e kredisë së pambrojtur gjatë periudhës u zgjerua me 0.7% në nivelin 159.5 miliardë lekë, ndikuar nga zgjerimi i konsiderueshëm i kredisë së pambrojtur në monedhën amerikane me rreth 37.3%[46]. Sipas subjekteve, zgjerimi i kredisë së pambrojtur gjatë periudhës reflekton rritjen e kësaj kredie për bizneset, me 2.6%. Në terma vjetorë, tkurrja e kredisë së pambrojtur në valutë me 1.8%, reflekton uljen e tepricës së kredisë së pambrojtur për individët ndërsa për bizneset kjo kredi është zgjeruar me 1.3%.

Grafik 8.7 Ecuria e kredisë së pambrojtur në valutë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 8.8 Përbërja e kredisë së pambrojtur në valutë sipas subjekteve, %



Burimi: Banka e Shqipërisë.

(69) Kredia dhënë për investime në pasuri të paluajtshme, përbën 46% të totalit të kredisë së pambrojtur, por shënon tkurrje në krahasim me një vit më parë. Pjesa tjetër e kredisë së pambrojtur në valutë është dhënë kryesisht për tregti dhe zhvillim biznesi (grafik 9.12).

[46] *Teprica e kredisë në dollarë amerikanë ku të ardhurat e huamarrësit janë në lekë, zë 18.1% të tepricës së kredisë të pambrojtur në valutë.*

Grafik 8.9 Kredia e pambrojtur në valutë për pasuri të paluajtshme dhe cilësia e saj (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 8.10 Kredia e pambrojtur në valutë (jo për pasuri të paluajtshme) dhe raporti i kredive me probleme (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 8.11 Ecuria e kredisë për jorezidentët



Burimi: Banka e Shqipërisë.

(70) Sektori bankar ka rritur ekspozimin ndaj kredisë në subjekte jorezidente. Pesha e kredisë dhënë subjekteve jorezidente është ngjitur në 11.3% të tepricës së kredisë në dhjetor 2016, nga 9.2% që shënonte një vit më parë. Teprica e kredisë për jorezidentët shënoi nivelin 67.8 miliardë lekë, duke u rritur me 25.6% vit më vit dhe 13.1% gjatë periudhës. Kontributin kryesor në këtë rritje e ka dhënë kredia për subjekte biznesi, e cila është rritur me 25.5% vit mbi vit dhe 14.4% gjatë periudhës, duke zënë 86% të totalit. Në përgjithësi, kredia për jorezidentët orientohet në afate më të gjata maturimi, me peshën kryesore në afatin e mesëm (52%), e ndjekur nga kredia afatgjatë (me 30%).

8.3.1 RREZIKU I KREDISË

(71) Gjatë periudhës, teprica e kredisë me probleme[47] është ngushtuar me 8%, në nivelin 109.7 miliardë lekë, duke u reflektuar në uljen e raportit të kredive me probleme. Rritja e kredisë së mbledhur për klasat e para të klasifikimit "me probleme" dhe kryesisht fshirjet e kredive në klasën "e humbur", kanë ndikuar në tkurrjen e stokut të kredive me probleme. Vlera e kredisë së fshirë në gjysmën e dytë të vitit, shënon rreth 6.7 miliardë lekë. Në harkun kohor të një viti, bankat kanë fshirë nga bilanci rreth 12.6 miliardë lekë kredi të humbura[48].

[47] *Kreditë me probleme përfshijnë klasat "nënstandarde", "të dyshimta" dhe "të humbura". Kriter për të përcaktuar një kredi si "me probleme" është numri i ditëve të vonuara (90 ditë).*

[48] *Duke filluar nga janari 2015, bankat janë të detyruara nga kërkesat rregullative për të ndërmarrë procesin e pastrimit të bilanceve – fshirjen e kredive, që gjenden në kategorinë "e humbur" për më shumë së 3 vjet. Gjithsej në dy vite, janë fshirë 39.3 miliardë lekë kredi të humbura.*

Grafik 8.12 Raporti i kredive me probleme



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 8.13 Kontributi në ndryshimin e stokut të kredive me probleme (mld lekë)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

(72) **Në fund të periudhës, raporti i kredive me probleme (RKP) shënoi 18.3%, duke u ngushtuar me 1.7 pp ndaj nivelit në qershor 2016, por duke mbetur pranë nivelit të një viti më parë.** Brenda strukturës së kredive me probleme, si rezultat i shlyerjeve, ristrukturimeve dhe fshirjes së kredive të humbura, pesha e kategorisë së kredive të humbura është rritur me 6.7 pp gjatë periudhës, duke zënë 56% të kredive me probleme.

Grafik 8.14 Struktura e kredive me probleme



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 8.15. Portofoli i kredive me probleme sipas grupeve bankare



Burimi: Banka e Shqipërisë.

(73) **Në përmirësimin e cilësisë së kredisë, kontributin kryesor e kanë dhënë bankat e mesme, të cilat së bashku zënë 31% të tepricës së kredive me probleme.** Kreditë me probleme për këtë grup bankash u ngushtuan me 21.2%, ndërsa RKP-ja ra me 4.7 pp, në nivelin 18.2%. Nivelin më të ulët të raportit të kredive me probleme e raportojnë bankat e mëdha (G3) me 17.7%,

në ngushtim gjatë periudhës me 1.2 p.p., ndërsa bankat e vogla (G1), mbartin nivelin më të lartë të RKP-së prej rreth 26.6%, dhe ai është zgjeruar me 10.5 pp gjatë periudhës.

(74) Cilësia e kredisë paraqitet më e dobët për kredinë në valutë, kredinë për biznes dhe kredinë me afat të gjatë maturimi. Në dhjetor 2016, cilësia e kredisë për secilin portofol shënoi përkatësisht 21.5% (valuta), 23.0% (biznesi),

Grafik 8.16 Huatë me probleme në sektorin bankar shqiptar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

dhe 18.8% (afati i gjatë).

(75) Cilësia e kredisë së pambrojtur në valutë shfaq përmirësim të vazhdueshëm, që prej fillimit të vitit 2015. Raporti i kredive me probleme (RKP) për kredinë e pambrojtur në valutë ra në nivelin 19.3% (3.6 p.p. më i ulët së niveli i muajit qershor 2016). Sipas valutave, raporti i cilësisë për kredinë e pambrojtur në Euro u përmirësua me 3.0 p.p. në nivelin 18.2%, dhe për

Grafiku 8.17 Ecuria e treguesve të cilësisë për portofolin e pambuluar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

kredinë e pambrojtur në Usd u përmirësua me rreth 9.4 p.p. në nivelin 24.4%. Kredia e pambrojtur "për zhvillim biznesi" shfaq raportin më të lartë të kredive me probleme, në nivelin 27.6%, e ndjekur nga ajo "për tregti" me 19.9%, e cila është përmirësuar gjatë periudhës.

(76) Cilësia e kredisë për subjektet jorezidente konsiderohet relativisht e mirë, pasi raporti "kredi me probleme ndaj tepricës së kredisë" shënon 3.3% dhe ka ardhur në rënie të vazhdueshme, që prej mesit të vitit 2014. Gjatë periudhës, stoku i kredive me probleme për këto subjekte është ngushtuar me 31.7%, në nivelin 2.3 miliardë lekë, ndërsa raporti i kredive me probleme ka rënë me 0.2 p.p. Krahasuar me fundin e vitit 2015, RKP-ja është ngushtuar rreth 1.3 p.p., ndërsa stoku i kredive me probleme është ngushtuar me 8.7%. Sidoqoftë, kjo është një kredi e këtyre viteve të fundit, relativisht e re, dhe përmban disa specifika që lidhen me aftësinë e bankave për të vlerësuar në mënyrë të përshtatshme rreziqet e huamarrësit që vepron në një juridiksion të huaj. Ndaj, vlerësimi i cilësisë së saj, kërkon vëmendje dhe monitorim të vazhdueshëm.

8.3.2 FAKTORË ZBUTËS TË RREZIKUT TË KREDISË

(77) Raporti i mbulimit me provigjione të kredive me probleme është zgjeruar gjatë periudhës, ndikuar nga ngushtimi i shpejtë i stokut të kredive me probleme. Në dhjetor 2016, raporti i mbulimit me provigjione u ngjit në 70.5% nga niveli 65.9% në qershor 2016. Efektin kryesor në zgjerimin e raportit të mbulimit për periudhën, e dha ngushtimi më i shpejtë i tepricës së

Grafik 8.18 Ecuria në kohë e raportit të provigjionimit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 8.19* Ndryshimi vjetor në raportet e mbulimit për bankat



*Shënim: Të përfshira janë bankat me peshë më të madhe se 1% ndaj totalit të aktivit. Ngjyra e gjelbër tregon përmirësim, ngjyra e kuqe përkeqësim dhe ngjyra blu një kombinim rreziku. Vija e ndërprerë shënon raportin mesatar të mbulimit me provigjion të kredive me probleme në nivel sektori, 70.5% në fund të dhjetorit 2016.

Burimi: Banka e Shqipërisë.

kredive me probleme.

(78) Rënia e vlerës së kredive me probleme neto gjatë periudhës, ka sjellë rritjen e mbulimit me kapital të tyre. Gjatë periudhës, raporti i kredive me probleme neto ndaj tepricës së kredisë është ngushtuar me 1.4 p.p, në nivelin 5.4%. Një vit më parë ky raport shënonte 5.3%. Në të njëjtën kohë, si rrjedhojë e ekspozimit më të ulët ndaj rrezikut të kredisë përmes ngushtimit të tepricës së kredive me probleme neto, raporti "hua me probleme neto/kapitali rregullator" ra në 23.1% nga 30.2% në fund të muajit qershor 2016. Një vit më parë ky raport shënonte 24.1%.

(79) Mbulimi me kolateral i kredisë mbetet në nivele të larta, dhe ruan përqendrimin e lartë të formës së kolateralit tek "pasuria e paluajtshme". Në dhjetor 2016, mbulimi me kolateral[49] u ngjit në nivelin 71.2%, nga 71.0% referuar muajit qershor 2016. Kreditë me kolateral pasuri të paluajtshme zënë 69.4% të kredive të kolateralizuara, dhe 49% të tepricës së kredisë. Cilësia e kredisë së kolateralizuar është përmirësuar gjatë periudhës dhe krahasuar me një vit më parë, dhe RKP-ja shënoi nivelin 17.7%. Kredia e kolateralizuar me "*cash*" raporton përmirësimin më të shpejtë të cilësisë së kredisë. Në dhjetor 2016, kjo kredi mbart nivelin më të ulët të RKP-së, rreth 0.95%. Kreditë e kolateralizuara me pasuri të paluajtshme komerciale, edhe pse raportojnë përmirësim të ndjeshëm të cilësisë së kredisë (RKP-ja ka rënë me 3.1 p.p. gjatë periudhës), vijojnë të shfaqin nivelin më të lartë të raportit të kredive me probleme prej rreth 22.2%. Kredia e pakolateralizuar, e cila përbën 29% të totalit të kredisë, raporton zgjerim të raportit të kredive me probleme gjatë periudhës, me 1.5 p.p. në nivelin 19.8%.

Grafik 8.20. Teprica e kredisë dhe raporti i kredive me probleme sipas llojit të kolateraleve



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Përdorimi i lartë i pasurive të paluajtshme si kolateral për sigurimin e kredisë, ruan varësinë e sektorit ndaj nevojës për funksionim eficient të këtij tregu dhe funksionimin sa më të mirë të procesit ligjor për ekzekutimin e detyrimit (kolateralit).

[49] *Kolaterali në formën e pasurive të paluajtshme (rezidenciale, tregtare ose tokë), cash etj.*

8.4 DEPOZITAT DHE RREZIKU I LIKUIDITETIT

(80) Në dhjetor 2016, stoku i depozitave në sektorin bankar ishte rreth 1,160 miliardë lekë, ose rreth 5.3% më i lartë se në fund të gjashtëmujorit të parë. Pothuaj e gjithë rritja vjetore e depozitave u realizua gjatë periudhës. Depozitat e individëve mbizotërojnë në stokun e depozitave, por shënuan ritëm më të ngadaltë të zgjerimit në krahasim me depozitat e bizneseve. Rënia e normave të interesit është shoqëruar me tkurrje të mëtejshme të depozitave me afat dhe rritje të konsiderueshme të peshës së llogarive rrjedhëse dhe depozitave pa afat.

Tabelë 8.3. Tregues kryesorë të depozitave në sektorin bankar

	Treguesi dhe njësia	Vlera (mld lekë)	Pesha ndaj totalit të depozitave (%)		Ndryshimi	
	Periudha	12/2016	12/2016	12/2015	Vjetor	Gjashtëmujor
Sipas monedhës	Depozitat në lekë	546	47.2%	48.7%	2.0%	2.7%
	Depozitat në valutë	611	52.8%	51.3%	8.3%	7.6%
Sipas subjekteve	Sektori publik	29	2.5%	2.4%	11.6%	-4.9%
	Biznese	163	14.1%	12.5%	18.6%	24.2%
	Individë	966	83.4%	85.1%	3.1%	2.9%
Sipas produktit	Llogari rrjedhëse	374	32.3%	27.0%	25.8%	19.2%
	Depozita pa afat	91	7.9%	6.3%	30.8%	19.5%
	Depozita me afat	669	57.8%	64.8%	-6.1%	-3.0%
Stoku i depozitave		1,158	100.%	100.%	5.2%	5.3%

Burimi: Banka e Shqipërisë.

(81) Zgjerimi i depozitave në valutë ka dhënë kontributin kryesor në rritjen e depozitave gjatë vitit 2016. Pesha e depozitave në valutë është rritur në 53% të totalit, me një kontribut pozitiv si nga depozitat në valutë të individëve, ashtu edhe nga ato të bizneseve.

(82) Gjatë periudhës, depozitat e individëve u rritën me 2.9%, ndërsa ato të bizneseve u rritën me 24%. Në terma vjetorë, rritja ishte përkatësisht 3.1% dhe 18.6%. Pavarësisht se depozitat e bizneseve zënë rreth 14% të totalit, rritja e konsiderueshme e tyre gjatë periudhës ka dhënë gjysmën e kontributit në rritjen totale të stokut të depozitave. Depozitat në valutë përbëjnë rreth 51% të depozitave të individëve dhe rreth 63% të depozitave të bizneseve, dhe së bashku kanë regjistruar rritjen më të shpejtë gjatë periudhës.

Grafik 8.21 Kontributi në rritjen e depozitave



Burimi: Banka e Shqipërisë.

(83) Depozitat me afat vazhdojnë të mbajnë peshën kryesore në vlerën e përgjithshme të depozitave, por shënojnë tkurrje në terma absolutë dhe relativë ndaj stokut të depozitave[50]. Gjatë periudhës, depozitat me afat ranë me 21 miliardë lekë ose me 3%. Rritja vjetore e stokut të llogarive rrjedhëse (me rreth 31% gjatë periudhës) dhe, në masë më të ulët, rritja e depozitave pa afat kanë vijuar të japin kontributin kryesor në rritjen e stokut të depozitave.

Grafik 8.22 Ecuria e depozitave sipas llojit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

(84) Ndryshimet në depozita gjatë periudhës, kanë reflektuar mënyrën e shpërndarjes së tyre sipas grupeve të bankave. Kështu, rreth 66% e rritjes së depozitave është përqendruar në bankat e mëdha, dhe 29% në bankat e mesme. Rritje e depozitave është vërejtur edhe në grupin e bankave të vogla. Përqendrimi i depozitave sipas Indeksit Herfindahl qëndron poshtë niveleve të moderuara[51] (1,447 pikë).

(85) Gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2016, fluksi i depozitave të reja me afat (rivendosje dhe vendosje të reja) në sektorin bankar ishte rreth 330 miliardë lekë. Pesha e tyre në totalin e depozitave të reja (19%) ka shënuar luhatje të vogla gjatë periudhës. Në kategorinë e depozitave të reja me afat, vërehet një zhvendosje e lehtë drejt maturiteteve më afatgjata. Fluksi i depozitave të reja në Lekë u rrit me 7.7%, ai në USD me 10%, dhe ai në Euro u rrit me mbi 20%. Gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit, normat mesatare të interesit për depozitat e reja me afat në Lekë kanë vijuar të bien deri në nivelin 0.8%, ndërkohë që normat e interesit për depozitat e reja në dollarë amerikanë dhe Euro kanë mbetur pothuajse të pandryshuara (rreth 0.25%).

---

50 *Nga muaji tetor i vitit 2013 (rritja vjetore e depozitave me afat filloi të regjistronte norma negative), depozitat me afat kanë rënë me 12.7%, ndërsa pesha e tyre ndaj totalit të depozitave ka rënë nga 77% në 57.8%. Në krahasim me fundin e vitit të kaluar, depozitat me afat ranë me 43.8 miliardë lekë ose me 6.1%.*

51 *Vlerat e indeksit Herfindahl deri në 1500 tregojnë një treg kompetitiv, 1500-2500 konkurrueshmëri të moderuar, dhe mbi 2500 përqendrim të lartë.*

Grafik 8.23 Depozitat e reja me afat sipas monedhës dhe afatit të maturimit, flukset gjashtëmujore



Burimi: Banka e Shqipërisë.

HAPËSIRË INFORMUESE 8.1 PRANIA E EUROIZIMIT NË EKONOMINË SHQIPTARE DHE NEVOJA PËR TRAJTIMIN E TIJ

Termi dollarizim/euroizim nënkupton përdorimin e një monedhe apo disa monedhave të huaja nga subjektet rezidente në një vend (kryesisht dollari amerikan ose euro), si alternativë ndaj monedhës vendase. Literatura dallon përgjithësisht këto forma të euroizimit: a) euroizimi financiar, që përfaqëson mbajtjen e aktiveve dhe detyrimeve në valutë nga subjektet rezidente dhe që reflektohet kryesisht në bilancet e institucioneve financiare; b) euroizimi real, që nënkupton indeksimin e transaksioneve, çmimeve dhe pagave me kursin e këmbimit të një valute të caktuar; dhe c) euroizimi i transaksioneve, apo zëvendësimi i monedhës vendase përmes ekzekutimit të transaksioneve në monedhë të huaj. Një ekonomi mund të ketë një apo disa nga format e mësipërme të euroizimit.

Prania e euroizimit në ekonomi ka ndikime të rëndësishme për efektivitetin e politikave ekonomike. Në drejtim të politikave makroekonomike, euroizimi ndikon në uljen e efektivitetit të politikës monetare; kufizon rolin e kursit të lirë të këmbimit si një stabilizues automatik në rastin e goditjeve makroekonomike, në kushtet e ndjeshmërisë më të lartë të subjekteve ekonomike ndaj luhatjeve të mëdha të kursit të këmbimit; dhe cenon efektivitetin e politikës fiskale, përmes rritjes së mundshme të kostos së shërbimit të borxhit dhe ndryshimit të strukturës së tij. Në drejtim të stabilitetit financiar, euroizimi rrit ekspozimin e sistemit financiar dhe të agjentëve të ekonomisë ndaj zhvillimeve të pafavorshme në kursin e këmbimit dhe situatave të stresit të likuiditetit në valutë. Nga ana tjetër, niveli i lartë i euroizimit shoqërohet zakonisht me kosto për bankën qendrore në formën e kostos oportune për mbajtjen e një niveli relativisht më të lartë të rezervave valutore, si edhe për humbjen e të ardhurave (senjorazh) që shoqërojnë zëvendësimin e monedhës vendase nga ajo e huaj.

Euroizimi në Shqipëri është prezent në të dy anët e bilancit të sektorit bankar. Ngushtimi i diferencës pozitive mes normës mesatare të interesit për kredinë në lekë dhe për atë në valutë, në vijim të politikës monetare lehtësuese të Bankës së Shqipërisë, si dhe një qëndrim më pasiv i grupeve bankare të huaja për kreditimin në valutë, kanë ndikuar në uljen e peshës së kredisë në valutë në rreth 60% të totalit të kredisë (nga rreth 72% në vitin 2008), ndonëse kjo peshë vijon të konsiderohet e lartë.*

Në anën e pasiveve, depozitat në valutë përbëjnë 53% të totalit, me një prirje në rritje prej nivelit 43% që shënonte në vitin 2008. Ngushtimi i diferencës pozitive mes normës mesatare të kursimeve në lekë dhe në valutë, këtë herë ka mbështetur rritjen e kursimeve në valutë. Euroizimi i aktiveve dhe pasiveve të sektorit bankar janë të ndërlidhur ngushtë së bashku. Në përputhje me parimet dhe kërkesat për zbutjen e rrezikut të kursit të këmbimit, sektori bankar synon ruajë një pozicion sa më të balancuar në përbërjen e zërave të bilancit sipas monedhave. Rrjedhimisht, rritja e burimeve të financimit në valutë, reflektohet përgjatë kohës në krahun e aktivit. Nga ana tjetër, kreditimi në valutë, reflektohet në detyrimet e sektorit bankar në valutë, në kushtet kur përdorimi i kredisë nga huamarrësi për kryerjen e investimeve apo blerjeve të ndryshme nga subjekte të tjera, rrit vlerën e vendosjeve të këtyre subjekteve në banka.

Në këtë drejtim, Banka e Shqipërisë vlerëson së rritja e euroizimit në pasivet e sektorit bankar e ekspozon sektorin bankar ndaj mundësisë së rikthimit të kredidhënies në valutë të huaj për subjektet rezidente (e cila pati dhe përkeqësimin më të shpejtë të cilësisë së kredisë) dhe ndaj investimeve në aktive jashtë vendit, e cila përforcon vulnerabilitetin e sektorit bankar dhe të agjentëve të ekonomisë reale, ndaj zhvillimeve të pafavorshme në kursin e këmbimit, dhe njëherazi ngushton kanalet e nevojshme të transmetimit të politikës monetare. Pra, identifikimi i masave për të kontrolluar dhe ulur nivelin e euroizimit, përmirëson zbatimin e politikave të Bankës së Shqipërisë dhe stabilitetit financiar në tërësi, për sa kohë që i shërben uljes së rrezikut sistemik.

Është e qartë, që de-euroizimi nuk mund të jetë vetëm një objektiv për sistemin financiar, për sa kohë që përdorimi i valutës nga publiku në transaksionet e ndryshme, mbetet i gjerë. Për këtë arsye, qasja për de-euroizimin duhet të jetë gjithëpërfshirëse, ku edhe autoritetet e tjera të vendit mund të identifikojnë dhe të ndërmarrin masa të ndryshme, të cilat nxisin publikun dhe agjentët ekonomikë të rrisin shkallën e përdorimit të monedhës vendase. Në këtë rast, objektivi duhet të jetë realist: ulja në zero e nivelit të euroizimit do të ishte objektivisht tepër e vështirë për t'u realizuar, e madje edhe ekonomikisht mund të ishte e pajustifikueshme. Nga ana tjetër, ndërmarrja e veprimeve të forta, që synojnë një rezultat të shpejtë, mund të shoqërohej me kosto të konsiderueshme për subjektet që i nënshtrohen këtyre masave, dhe mund të shkaktonte efekte të padëshirueshme në tregues të caktuar ekonomikë dhe financiarë. Ajo që duhet të synohet në kuadër të kësaj përpjekjeje, është kontrolli i niveleve aktuale të euroizimit dhe ulja e tij në nivele më të përshtatshme në afat të gjatë, të krahasueshme me ato të vendeve që kanë një ekonomi të ngjashme me atë të vendit tonë.

Banka e Shqipërisë synon që në mënyrë strategjike, t'i qaset këtij fenomeni duke kërkuar bashkëpunimin e autoriteteve të tjera në vend. Për këtë qëllim, është punuar për realizimin e një Memorandumi Bashkëpunimi, i cili do t'i propozohet për miratim Ministrisë së Financave dhe Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Memorandumi do të nxisë secilin autoritet, që brenda fushës së tij të kompetencës dhe në mënyrë sa më të koordinuar, të identifikojë veprimet e nevojshme në drejtim të de-euroizimit, duke përfshirë edhe komunikimin me publikun. Dokumenti do të përmbajë edhe mekanizma monitorues për të vlerësuar dhe raportuar rregullisht mbi efektin që mund të kenë masat e ndërmarra nga autoritetet në tregues të ndryshëm financiarë dhe ekonomikë.

Nga ana e saj, Banka e Shqipërisë ka nisur procesin e identifikimit dhe vlerësimit të masave që mund të merren fillimisht për të adresuar nivelet e euroizimit në sektorin bankar. Këto masa, do të synojnë uljen e rreziqeve që shoqërojnë nivelet e larta të euroizimit, në të dy krahët e bilancit të sektorit bankar.

** Rekomandimi mbi kredinë në valutë, 2011, Bordi Evropian i Rrezikut Sistemik.*

8.4.1 RREZIKU I LIKUIDITETIT

(86) Pozicioni i likuiditetit të sektorit bankar është në nivele të mira. Treguesit e likuiditetit, në lekë dhe valutë, janë mbi nivelet minimale të kërkuara nga kuadri rregullator. Burimi kryesor i financimit mbeten depozitat, të cilat mbulojnë gati dy herë vëllimin e kredive të sektorit.

(87) Sektori bankar vijon të ruajë një pozitë të mirë likuiditeti me një tepricë të konsiderueshme të depozitave të klientëve mbi kreditë. Në dhjetor 2016, raporti "depozita/kredi" shënoi 192.8% (kredi/depozita 51.9%). Sipas monedhës, ky raport shënon 220.1% për monedhën vendase dhe 173.6% për valutën.

Nivelet e aktiveve likuide në bilancet e bankave vijojnë të mbeten të larta, në vijim të një ecurie poshtë potencialit të aktivitetit kreditues. Në fund të vitit 2016, aktivet likuide përbëjnë 31.3% të totalit të aktiveve të sektorit bankar, lehtësisht në rënie gjatë periudhës me 0.3 p.p. Ecuria e treguesit tjetër të likuiditetit "aktive likuide/totali i detyrimeve afatshkurtra" ra gjithashtu me 0.5 p.p., në nivelin 40.6%.

Ndonëse bankat po operojnë në kushtet e një likuiditeti të bollshëm, hendeku negativ mes aktiveve dhe detyrimeve, sipas segmenteve të maturitetit të mbetur, në raport me totalin e aktiveve, konsiderohet në nivele të larta dhe në rritje kundrejt vitit të kaluar në afatin e shkurtër.

Grafik 8.24 Tregues të likuiditetit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 8.25 Mospërputhja në maturim mes aktiveve dhe detyrimeve*



*Janë përfshirë edhe aktivet dhe detyrimet jashtë bilancit.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

(88) Gjatë periudhës është ruajtur diferenca mes afatit mesatar të maturimit të aktiveve dhe të detyrimeve. Kjo diferencë është rreth 16.5 muaj. Maturiteti i mbetur i depozitave, si zëri më përfaqësues i detyrimeve është zgjeruar në 6.8 muaj, në përputhje me sjelljen sezonale, nga 6.1 muaj në qershor 2016. Maturiteti i mbetur i kredive nga krahu i aktiveve është zgjeruar në 44.8 muaj

Grafik 8.26 Maturimi mesatar i mbetur



Burimi: Banka e Shqipërisë.

(nga 43 muaj në qershor 2016), duke reflektuar prirjen e bankave për të rritur kreditimin për periudha më afatgjata.

(89) Vlera e linjave të financimit nga grupet bankare zotëruese zë një peshë shumë të ulët në burimet e financimit të sektorit bankar. Gjatë periudhës, totali i vlerës së këtyre linjave shënoi 6.3 miliardë lekë, nga 6.7 miliardë në qershor 2016. Për bankat që disponojnë linja kredie me grupet bankare zotëruese në fund të periudhës, shkalla e përdorimit të tyre shënoi 29.6%, nga 26.9% në qershor 2016.

8.5 RREZIQET E TREGUT

8.5.1 RREZIKU I KURSIT TË KËMBIMIT

Grafik 8.27 Pozicioni i hapur në valutë ndaj kapitalit rregullator për grupet sipas madhësisë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

(90) Pozicioni i hapur valutor i sektorit, në raport me kapitalin rregullator, nuk paraqet ndryshime të rëndësishme nga periudhat e mëparshme. Në dhjetor 2016, në nivel sektori, pozicioni i hapur valutor është "në blerje" dhe zë 7% të kapitalit rregullator, duke qenë 1.4 p.p. më i ulët se niveli i qershorit 2016 dhe 0.6 pp më i ulët se një vit më parë. Bankat e mëdha vijojnë të ruajnë pozicion "në blerje" në nivelin 11.4% të kapitalit rregullator, ndërsa grupi i bankave të vogla dhe ai i bankave të mesme pozicionohen "në shitje" përkatësisht në nivelet 4.5% dhe 1.9% të kapitalit rregullator. Në përgjithësi, këto nivele të pozicionit të hapur në valutë, tregojnë për një ekspozim të kufizuar të sektorit bankar ndaj ndikimit të drejtpërdrejtë në bilanc të luhatshmërisë së kursit të këmbimit.

(91) Sektori bankar ka ulur ekspozimin ndaj rrezikut të tërthortë të kursit të këmbimit, përmes tkurrjes së kredisë në valutë për rezidentët. Në muajin dhjetor 2016, treguesi i mospërputhjes valutore[52] për të gjithë monedhat, qëndron në

[52] *Treguesi i mospërputhjes valutore mat shkallën e mbulimit të detyrimeve të sektorit bankar në valutë me aktivet në valutë të netuara me kredinë rezidente në valutë. Një vlerë e ulët e raportit të këtij treguesi ndaj aktiveve tregon ekspozim të ulët ndaj lëvizjeve në kursin e këmbimit. Për llogaritjen e treguesit të mospërputhjes valutore, referohuni Raportit të Stabilitetit Financiar për gjashtëmujorin e parë të vitit 2016.*

nivelin 18.4% të aktiveve. Tkurrja e kredisë në valutë për subjektet rezidente (me 3% në terma vjetorë), ka kontribuar në përmirësimin e treguesit të mospërputhjes valutore me 1.8 p.p. në terma vjetorë. Sipas monedhave të veçanta, mospërputhja valutore në euro ka rënë me 1.2 p.p. gjatë periudhës në nivelin 17.4%, ndërsa ajo në dollarë amerikanë ka rënë lehtësisht në nivelin 1.3%.

Grafik 8.28 Mospërputhja valutore dhe teprica e aktiveve neto



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 8.29 Mospërputhja valutore sipas monedhave



Burimi: Banka e Shqipërisë.

(92) Të tri grupet bankare shënojnë ulje të ekspozimit ndaj rrezikut të tërthortë të kursit të këmbimit. Grupi G3 i bankave të mëdha reflekton një shkallë më të lartë të mbulimit të detyrimeve valutore me aktive në valutë, ku indeksi i mospërputhjes valutore është ulur në nivelin 14.7%. Bankat e mesme paraqesin ekspozimin më të lartë ndaj rrezikut të tërthortë të kursit të këmbimit, edhe pse në rënie, ku indeksi i mospërputhjes valutore shënon 27.1%. Në rastin e grupit të bankave të vogla, ky ekspozim është ulur në nivelin 24.2%.

Grafik 8.30 Mospërputhje valutore sipas monedhave



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 8.31 Mospërputhja valutore, sipas grupeve



Burimi: Banka e Shqipërisë.

8.5.2 RREZIKU I NORMËS SË INTERESIT

(93) Sektori bankar vlerësohet të jetë i ekspozuar ndaj luhatjeve të normës së interesit në kushtet kur diferenca midis aktiveve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj normës së interesit, sipas periudhave të riçmimit, është negative. Gjatë periudhës, sektori ka ulur ndjeshëm ekspozimin ndaj luhatjeve të normës së interesit për periudhën afatshkurtër deri në tre muaj, duke ngushtuar ndryshimin kumulativ negativ midis aktiveve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj normës së interesit, në nivelin 3.6% të totalit të aktiveve nga 17.5% në fund të gjashtëmujorit të parë. Ngushtimi ka ardhur si pasojë e rritjes së aktiveve të ndjeshme ndaj normës së interesit, ndërkohë që pasivet kanë shënuar rënie. E njëjta gjë është vërejtur në diferencën aktive-pasive të ndjeshme ndaj normës së interesit për maturitetin deri në një muaj, e cila ra në nivelin 9% të aktiveve nga niveli 14% në qershor 2016. Për maturitetin e mbetur deri në një vit, diferenca aktiv-pasiv ka rënë me 2.5 p.p. gjatë periudhës dhe me 9.4 p.p. ndaj vitit të kaluar, në nivelin 6.8% të aktiveve të sektorit.

Ulja e nivelit të hendekut mes aktiveve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj normës së interesit, ul rrezikun që sektori bankar dhe banka të veçanta të përballen me kosto në rastin kur zhvillimet ekonomike të sugjerojnë një rritje të normave të interesit në treg. Vlerësimi i rrezikut që mund të vijë nga luhatjet e normave të interesit, përveç monitorimit të efektit të drejtpërdrejtë në rezultatin financiar të bankave (përmes ndikimit mbi të ardhurat neto nga interesi dhe mbi të ardhurat nga rivlerësimi), duhet të mbajë në konsideratë edhe efektin e tërthortë të lëvizjes së normës së interesit në aftësitë paguese të huamarrësve. Një rritje e mundshme e normës së interesit ndikon negativisht në aftësinë paguese të huamarrësve dhe mund të shoqërohet me probleme në cilësinë e kredisë.

Grafik 8.32 *Gap*-et e maturimit sipas periudhave të riçmimit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 8.33 *Spread*-i i normave të interesit sipas monedhave



Burimi: Banka e Shqipërisë.

8.6 RREZIKU OPERACIONAL

(94) Për vlerësimin e rrezikut operacional gjatë periudhës, Banka e Shqipërisë i ka kushtuar një vëmendje në rritje sigurisë fizike të veprimtarisë bankare. Ky qëndrim ka reflektuar edhe ngjarjet e vitit të kaluar, ku bankave iu janë grabitur vlerat monetare, përgjithësisht gjatë transportimit të tyre. Për këtë çështje, Banka e Shqipërisë, në kuadër të përmirësimit të masave të sigurisë të subjekteve financiare, organizoi punën për rishikimin e rregullores "Për kërkesat minimale të sigurisë në ambientet në të cilat kryhen veprimtaritë financiare dhe për transportin e vlerave", miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 67 datë 01.06.2016, në të cilën u kryen disa ndryshime me fokus kryesor përforcimin e masave të sigurisë, planifikimin, hartimin, monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatueshmërisë së procedurave, nga njësitë e sigurisë së bankave tregtare. Në këtë rregullore, është përforcuar detyrimi për kontrolle periodike në banka apo subjekte të tjera financiare që mbikëqyren nga Banka e Shqipërisë, veçanërisht për mënyrën se si njësia e sigurisë në banka zbaton procedurat e sigurisë. Për transportin e vlerave monetare, për të cilat ekziston detyrimi që të jenë të siguruara pranë shoqërive të sigurimit, rregullorja i referohet ligjit nr.75/2014 për Shërbimet Private të Sigurisë Fizike, veprimtari e cila mbikëqyret nga institucioni i Policisë së Shtetit. Në këtë kuadër, Banka e Shqipërisë ka pasur bashkëpunim të vazhdueshëm me Policinë e Shtetit gjatë vitit 2016, duke kontribuar në përgatitjen e akteve rregullative për transportin e vlerave monetare, sa më pranë standardeve të Bashkimit Evropian.

(95) Vlerësimi më i plotë i kapaciteteve të bankave për të përballuar rreziqet operacionale të veprimtarisë, tregon një përmirësim relativ, pasi mbulimi me kapital i humbjeve operacionale bruto të raportuara është përmirësuar ndjeshëm. Megjithatë, treguesit kyç të rrezikut paraqesin një panoramë më të larmishme. Ecuria e treguesve tregon për nevojën e përmirësimit të mëtejshëm të procesit për identifikimin dhe raportimin e humbjeve operacionale në sistem, në mënyrë që struktura e humbjeve operacionale sipas linjave të biznesit të reflektojë më mirë profilin e aktivitetit të bankës.

8.7 REZULTATI FINANCIAR DHE EFICIENCA E BURIMEVE

(96) Sektori bankar e mbylli vitin 2016 me një rezultat financiar pozitiv, por më të ulët në krahasim me një vit më parë. Për shkak të rënies më të shpejtë të të ardhurave nga interesat krahasuar me ritmin e rënies së kostove të financimit, të ardhurat neto nga interesi dhe marzhi neto i interesave kanë shënuar rënie. Shpenzimet në formën e provigjioneve për rrezikun e kredisë u rritën ndjeshëm dhe përfaqësojnë faktorin kryesor të rënies së fitimit në sektorin bankar. Veprimtaritë e tjera kanë pasur efekt më të ulët në rezultatin financiar. Treguesit e kthimit mbi kapitalin (RoE) dhe të kthimit mbi aktivet (RoA) të sektorit bankar treguan rënie në terma vjetorë.

Grafik 8.34 Përbërësit e rezultatit financiar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 8.35 ROA sipas peshës së bankave në aktivet e sektorit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 8.36. Marzhi neto nga interesi

Burimi: Banka e Shqipërisë.

(97) Në fund të vitit 2016, sektori bankar raportoi një rezultat financiar pozitiv prej 9.3 miliardë lekësh ose rreth 6.4 miliardë lekë më pak se një vit më parë. Pavarësisht se rritja e shpenzimeve për provigjione dha kontributin kryesor në rënien e fitimit, edhe të ardhurat neto nga interesi shënuan rënie në terma vjetorë. Treguesit kryesorë të rentabilitetit, kthimi mbi aktivet (ROA) dhe kthimi mbi kapitalin (ROE), shënuan përkatësisht 0.7% dhe 7.2%, duke qenë përkatësisht 0.5 pp dhe 6 pp më të ulët në krahasim me fundin e vitit 2015. Sipas grupeve të bankave, grupi G2 i bankave të mesme, është i vetmi grup për të cilin vlerat e treguesve RoE dhe RoA kanë shënuar rritje të lehtë.

(98) Ulja e vazhdueshme e kostove të financimit nuk mjaftoi për të kompensuar rënien e të ardhurave nga aktiviteti kryesor bankar. Kështu, rezultati neto nga interesat ra me rreth 1.8 miliardë lekë, në 47.2 miliardë lekë, pasi rënia e të ardhurave nga interesat rezultoi më e lartë se ajo e shpenzimeve për interesa. Si rrjedhojë, marzhi neto nga interesat ra në nivelin 4.2%, nga 4.4% një vit më parë.

Grafik 8.37 Shpenzimet për provigjionim



Burimi: Banka e Shqipërisë.

(99) Shpenzimet për provigjionim për rrezikun e kredisë, shënuan 17.5 miliardë lekë ose 5.8 miliardë lekë më shumë se fundi i vitit 2015, duke qenë faktori kryesor në rënien e rezultatit financiar të sektorit. Për banka individuale, edhe pse rezultati neto nga veprimtaria bankare nuk ka shënuar ndryshime të rëndësishme, rritja e shpenzimeve të provigjionimit ka dhënë ndikimin kryesor në rënien e rezultatit financiar. Pesha në aktivet e sektorit bankar të bankave që regjistruan humbje financiare u ngjit në nivelin 24.2%, në krahasim me vlerën mesatare prej rreth 10% të regjistruar në dy vitet paraardhëse.

(100) Së fundi, rezultati financiar nga veprimtaritë e tjera u rrit me rreth 0.4 miliardë lekë, si pasojë e rritjes së të ardhurave nga veprimet me titujt. Në të njëjtën kohë, kostot e veprimtarisë, edhe pse shënuan rritje të lehtë, u mbuluan në nivele të mira nga të ardhurat e veprimtarisë, duke dhënë ndikim pozitiv në të ardhurat operative bruto (para provigjionimit).

8.8 KAPITALIZIMI I VEPRIMTARISË

(101) Kapitalizimi i sektorit bankar në dhjetor 2016, u vlerësua në nivel të mirë dhe rezultoi i qëndrueshëm, pavarësisht rritjes së kërkesave për kapital për rrezikun e kredisë dhe investimeve në subjektet jorezidente. Nivelet e mira të kapitalizmit u mbështetën nga injektimi me kapital, si dhe rezultati financiar pozitiv. Bankat kanë respektuar normën rregullatore të kërkuar për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit.

(102) Në dhjetor 2016, norma e mjaftueshmërisë së kapitalit shënoi 15.7%, pothuaj e pandryshuar gjatë vitit të fundit (15.8%[53] një vit më parë). Në fund të vitit 2016, aktivet e peshuara me rrezik ishin rreth 4.3% më të larta krahasuar me muajin qershor 2016, duke kontribuar në uljen e raportit të mjaftueshmërisë

Grafik 8.38 Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

së kapitalit me 0.7 pp. Nga ana tjetër, për shkak të injektimeve të kapitalit dhe ruajtjes së rezultatit financiar pozitiv, kapitali rregullator u rrit me 3.8%, duke përmirësuar raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit me 0.6 pp.

(103) Në nivel grupesh, bankat e Grupit 3 paraqesin normë më të ulët kapitalizimi, ndërsa sipas origjinës së kapitalit, bankat e klasifikuara si "Të tjera" dhe ato me kapital shqiptar kanë norma më të ulëta të mjaftueshmërisë së kapitalit. Në pjesën më të madhe, bankat individuale ruajnë norma të mjaftueshmërisë së kapitalit në intervalin 14%-16% dhe 16%-18%.

Grafik 8.39 Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit për grupet sipas madhësisë dhe origjinës së kapitalit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 8.40 Shpërndarja e aktiveve të sektorit sipas raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

(104) Sektori bankar paraqet një ekspozim në rritje përsa i përket klasave të rrezikut të kredisë. Aktivet e peshuara me rrezikun e kredisë janë zgjeruar me rreth 14.7 miliardë lekë krahasuar me gjysmën e parë të vitit 2016, duke u ngjitur në nivelin 703.2 miliardë lekë. Kategoritë e kredisë që peshohen me një koeficient më të lartë rreziku, përfshijnë kredinë për jorezidentët, kredinë e pambrojtur në valutë. (Grafik 8.41). Sipas grupeve të bankave, bankat e vogla paraqesin ekspozim të lartë për kredi të siguruar me kolateral në formën e pasurive të paluajtshme, bankat e mesme kanë ekspozim më të lartë për kredinë për korporata dhe kredi me probleme, ndërsa bankat e mëdha i shtojnë këtyre edhe ekspozimin ndaj organeve administrative dhe institucioneve të mbikëqyrura. Në ndarjen sipas origjinës së kapitalit, vërehet që bankat me kapital shqiptar kanë ekspozim më të lartë për klasën "Kredi për korporata dhe kredi me probleme" (Grafik 8.42).

Grafik 8.41 Koeficientët e ponderimit dhe madhësia e klasave kryesore të portofolit të kredisë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 8.42 Ekspozimet e klasave të kredisë për bankat sipas madhësisë të aktivitetit dhe origjinës në kapitalit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

(105) Zbatimi i disa ndryshimeve në koeficientët e ponderimit të aktiveve, si pjesë e masave kundërciklike të Bankës së Shqipërisë të majit 2013, kanë dhënë një ndikim të ndryshëm mbi kërkesat për kapital të bankave. Kështu, masa në mbështetje të rritjes së kredisë për ekonominë kanë pasur një ndikim më të ulët në përmirësimin e raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit, me vetëm 0.16 pp. Ky efekt përfshinte zbutjen graduale, deri në mbylljen përfundimtare të kësaj mase në fund të 2016-ës. Riorientimi i kredisë në monedhën vendase, kushtet e favorshme të mjedisit të normave të ulëta të interesit dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së kredisë si një ndër faktorët përcaktues të aktivitetit kreditues, ulën nevojën për këtë masë. Nga ana tjetër, masat që penalizonin investimet në jorezidentë, kanë ndikuar ndjeshëm në uljen e raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit gjatë periudhës. Në dhjetor 2016, kërkesa për kapital shtesë për këto investime shënon 93.6 miliardë lekë. Si rezultat, zgjerimi i investimeve jorezidente ka ndikuar negativisht në tkurrjen e raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit të sektorit bankar me 1.81 pp, ku bankat e mëdha vijojnë të jenë më të prekurat. Me qëllim vendosjen e një kufiri të sipërm në kërkesat shtesë për kapital, gjatë 2017-ës, mënyra e zbatimit të kësaj mase do të ndryshojë (shiko paragrafin 64).

(106) Kërkesat për kapital për rrezikun e tregut kanë shënuar rënie, ndërsa ato për rrezikun operacional kanë mbetur të pandryshuara ndaj gjysmës së parë të vitit 2016. Për periudhën, kërkesat për kapital për rrezikun e tregut shënuan vlerën e 15.2 miliardë lekëve, në rënie me 1.7 miliardë lekë ose 10.3%. Kërkesat për kapital për rrezikun operacional mbetën të pandryshuara. Këto të fundit zënë afërsisht 10% të totalit të aktiveve të peshuara me rrezik, ndërsa të tregut vetëm 1.7%.

Grafik 8.43 Treguesi i levës financiare, në herë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

(107) Sektori bankar shqiptar karakterizohet nga një raport i ulët i levës financiare, gjë që konfirmon ruajtjen e një niveli të mirë të kapitalizimit. Treguesi i levës financiare[54] në fund të vitit 2016 ishte 10.3 herë, nga 10.5 herë një vit më parë. Masa në të cilën bankat individuale ndryshojnë në drejtim të nivelit të levës financiare nuk ka zhvendosje të rëndësishme.

[54] *Treguesi i levës financiare matet si raport i aktiveve ndaj kapitalit aksioner.*

HAPËSIRË INFORMUESE 8.2. FAKTORËT NDIKUES NË RAPORTIN E MJAFTUESHMËRISË SË KAPITALIT TË BANKAVE

Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit reflekton zhvillimet e njëkohshme në kapitalin rregullator dhe në aktivet e ponderuara me rrezik, si dhe të të gjitha elementeve që përbëjnë këta zëra. Në këtë hapësirë informuese është vlerësuar kontributi që ka dhënë secili element në ecurinë e raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit të sektorit bankar shqiptar, në periudhën 2009-2016. Për shkak të ndryshimeve përgjithësisht të vogla, kontributi në ndryshimin e normës së mjaftueshmërisë së kapitalit, është shprehur në pikë bazë (pb).*

Në grafikun 8.44 pasqyrohet kontributi i treguesve të kapitalit dhe të aktiveve të ponderuara në ndryshimin vjetor të RMK-së. Për periudhën 2009-2012, RMK-ja përgjithësisht shënon përmirësim, mbështetur nga rritja e kapitalit rregullator, tkurrja e aktiveve të ponderuara me rrezik dhe ecuria e aktiveve totale. Pas vitit 2013, RMK-ja shënon tkurrje, duke reflektuar një rritje më të shpejtë të aktiveve të ponderuara në krahasim me rritjen e kapitalit rregullator.

Grafik 8.44 Kontributi i elementeve në normën e mjaftueshmërisë së kapitalit, në pikë bazë



Burimi: Banka e Shqipërisë, llogaritje e autorëve.

Grafik 8.45 Kontributi i elementeve në normën e mjaftueshmërisë së kapitalit, në pikë bazë, pa ndikimin e masave kundërciklike/makroprudenciale



Burimi: Banka e Shqipërisë, llogaritje e autorëve.

Në fakt, zhvillimet në aktivet e ponderuara me rrezik për periudhën pas vitit 2013, janë ndikuar ndjeshëm nga masat kundërciklike të Bankës së Shqipërisë, duke reflektuar shtesat në kërkesat për kapital për investime me jorezidentët.

Për të matur ndikimin e pastër (që nuk lidhet me kërkesat rregullatore të Bankës së Shqipërisë) të aktiveve të ponderuara me rrezik në RMK, është rivlerësuar kontributi i përcaktuesve të RMK-së, në rast se nuk do të ishin marrë masat kundërciklike. Siç pasqyrohet në Grafikun 8.45, pas vitit 2013, në mungesë të këtyre masave, RMK-ja do të shënonte përmirësim, mbështetur nga një rritje më e shpejtë e kapitalit rregullator në krahasim me zgjerimin e aktiveve të ponderuara me rrezik. Efekti më i detajuar i masave kundërciklike në aktivet e ponderuara me rrezik, jepet në Grafikun 8.46.

Kapitali rregullator, i cili ndikon drejtpërdrejt zhvillimet në RMK, përfshin disa elemente: fitimin neto, dividendët, fitimin e pashpërndarë të llogaritur si diferencë e fitimit neto me dividentët, si dhe të ardhura/burime të tjera të kapitalit. Kjo e fundit, përfaqëson të gjitha ato burime të tilla si injektimi me kapital (emetimi i aksioneve) dhe diferencat e rivlerësimit për mjete të qëndrueshme apo të letrave me vlerë të vlefshme për shitje.

Grafik 8.46 Aktivet e ponderuara me rrezik (APR



Burimi: Banka e Shqipërisë, llogaritje e autorëve.

Grafik 8.47 Burimet e rritjes së kapitalit të bankave



Burimi: Banka e Shqipërisë, llogaritje e autorëve.

Në sektorin bankar shqiptar, shpërndarja e dividentëve është e kufizuar, duke zënë rreth 0.3% të kapitalit rregullator, ndaj kontributi i tij është i papërfillshëm. Detajimi i mëtejshëm i kontributit në RMK që vjen prej elementeve të tjera, prezantohet në Grafikun 8.47. Kontributi i lartë para vitit 2013 në rritjen e kapitalit rregullator, vjen si nga fitimi neto, ashtu edhe nga rritja e kapitalit. Pas vitit 2013, kontributi pozitiv i fitimit neto është thelluar, duke përbërë burimin kryesor të rritjes së kapitalit rregullator.

Grafik 8.48 Kontributi në ecurinë e normës së mjaftueshmërisë së kapitalit për grupet sipas madhësisë së aktivitetit, në pikë bazë



Burimi: Banka e Shqipërisë, llogaritje e autorëve.

Në nivel grupesh sipas madhësisë së aktivitetit, RMK-ja për grupin e bankave të vogla është ndikuar kryesisht nga zhvillimet në madhësinë e aktiveve totale, dhe pak nga rritja në kapital. Në të kundërt, për bankat e mesme kontributi kryesor vjen nga ecuria e kapitalit rregullator, ndërsa për bankat e mëdha, zgjerimi i aktiveve të ponderuara me rrezik ka dhënë ndikim më të madh në tkurrjen e RMK-së pas vitit 2013.

** 1 pikë bazë nënkupton 0.01%.*

9. VLERËSIM I QËNDRUESHMËRISË SË SEKTORIT BANKAR SIPAS USHTRIMIT TË PROVËS SË REZISTENCËS[56]

(108) Ushtrimi i provës së rezistencës, i cili vlerëson qëndrueshmërinë e sektorit bankar kundrejt zhvillimeve ekonomike dhe financiare përgjatë një periudhe të ardhshme dyvjeçare, tregon se sektori vijon të mbetet i qëndrueshëm. Ushtrimi i provës së rezistencës së likuiditetit gjithashtu reflekton kapacitete të mjaftueshme të sektorit bankar për të përballuar tërheqje të ndjeshme të depozitave.

9.1 VLERËSIMI I QËNDRUESHMËRISË SË SEKTORIT BANKAR NDAJ GODITJEVE MAKROEKONOMIKE

(109) Ushtrimi i provës së rezistencës vlerëson qëndrueshmërinë e sektorit bankar dhe mjaftueshmërinë e kapitalit për periudhën 2017-2018. Ky vlerësim përjashton mundësinë e rritjes së kapitalit të paguar gjatë periudhës dhe kryhet duke aplikuar tre skenarë, atë bazë dhe dy skenarë me zhvillime më të përkeqësuara dhe me probabilitet më të ulët ndodhjeje.

Grafik 9.1 Supozimet për ndërtimin e provës së rezistencës



Burimi: Banka e Shqipërisë.

[55] *Prova e rezistencës nuk përfaqëson një mënyrë parashikimi. Në mënyrë të qëllimshme, skenarët përmbajnë zhvillime negative dhe ekstreme, por me një probabilitet të ulët ndodhjeje, për të provuar rezistencën e sektorit bankar ndaj tyre. Megjithëse bankat nxiten që të vlerësojnë kapacitetin e gjendjes së tyre financiare për të përballuar ndikimin e këtyre skenarëve, ato nuk duhet t'i konsiderojnë këta skenarë si ngjarje të pritshme nga ana e Bankës së Shqipërisë për të ardhmen. Skenarët janë të ndryshueshëm përgjatë kohës, në varësi të zhvillimeve ekonomike dhe financiare. Nga ana tjetër, skenarët nuk marrin në konsideratë veprimet që mund të kryejnë bankat dhe autoritetet për të forcuar në vazhdimësi situatën financiare dhe qëndrueshmërinë ndaj rreziqeve të bankave.*

(110) Skenari bazë supozon një rritje ekonomike në përmirësim deri në fund të vitit 2018. Në këtë skenar, rritja ekonomike shoqërohet me rritje të kreditimit dhe përmirësim të cilësisë së portofolit të kredisë deri në fund të vitit 2018. Për të njëjtën periudhë, supozohet një rritje e ndikimit të masave të ndërmarra nga autoriteti mbikëqyrës për trajtimin e kredive me probleme.

(111) Skenari i moderuar supozon një rritje ekonomike pozitive, por ndjeshëm më të ulët se skenari bazë; ndërsa skenari i rënduar supozon një tkurrje të ekonomisë në vend. Këto zhvillime, supozohet se shoqërohen me ndryshime të tjera në treguesit makroekonomikë dhe financiarë, siç janë një nënçmim ti kursit të këmbimit të lekut, rritje e normave të interesit, si dhe ndalim apo tkurrje e ndjeshme e kreditimit. Të gjithë këta faktorë, ndikojnë në treguesit e kapitalizimit të sektorit bankar. Cilësia e portofolit të kredisë në këta skenarë reflekton, krahas pastrimit të bilancit, edhe prurjet e reja të kredive me probleme. Si rezultat, deri në fund të vitit 2018, raporti i kredive me probleme paraqitet i përkeqësuar (rritet) me përkatësisht deri në 15.6 pp në skenarin e moderuar dhe me 32.3 pp në skenarin e rënduar, ndaj nivelit të skenarit bazë. Për më tej, në vijim të përkeqësimit të cilësisë së kredisë, këta dy skenarë supozojnë edhe goditje në terma të rrezikut të tregut, përfshirë rrezikun e riçmimit të letrave me vlerë, si dhe atij operacional.

(112) Rezultatet e ushtrimit të provës së rezistencës në terma të mjaftueshmërisë së kapitalit tregojnë se:

a. **në skenarin bazë**, norma e mjaftueshmërisë së kapitalit (RMK) të sektorit shënon 15.2% në fund të vitit 2017 dhe 16.2% në fund të vitit 2018, në vijim të përmirësimit të cilësisë së kredisë dhe ritmit më të lartë të rritjes ekonomike. Edhe zhvillimet sipas grupeve bankare dëshmojnë për një qëndrueshmëri dhe nivel kapitalizimi të tyre dukshëm mbi minimumin e kërkuar nga kuadri rregullativ.

b. **në skenarin e moderuar,** RMK-ja e sektorit arrin në nivelin 13.4% në fund të vitit 2017 dhe 12.5% në fund të vitit 2018. Zhvillimet në banka të veçanta evidentojnë nevojën për injektim kapitali në 6 prej tyre, të cilat përbëjnë 36.6% të aktiveve të sektorit. Në këtë rast, nevojat për kapital shtesë arrijnë deri në 12.1 miliardë lekë deri në fund të vitit 2018.

c. **në skenarin e rënduar**, RMK-ja e sektorit ulet edhe më tej, nisur nga supozimet edhe më të rënduara që përfshin skenari. RMK-ja e sektorit arrin në nivelin 10.9% në fund të vitit 2017 dhe rreth 10.5% në vitin 2018. Në këtë skenar, numri i bankave që bie në nënkapitalizim rritet krahasuar me skenarin e moderuar, ku zhvillimet e supozuara makroekonomike ndikojnë në përkeqësimin e ndjeshëm të cilësisë së kredisë, nivelin e humbjeve në portofolin e letrave me vlerë dhe rritjen e ekspozimit ndaj rrezikut të tregut dhe atij operacional. Në këtë rast, nevojat për kapital shtesë arrijnë në rreth dy herë më të larta së në skenarin e moderuar.

(113) Për t'i vendosur këto vlera në kontekstin e zhvillimeve aktuale, theksojmë së gjatë vitit 2016 sektori bankar ka shtuar kapitalin me rreth 10.4 miliardë lekë, rreth 3 miliardë lekë më shumë sesa kapitali i injektuar gjatë gjithë 2015-ës.

Grafik 9.2 Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit, sipas skenarëve të provës së rezistencës



Burimi: Banka e Shqipërisë.

HAPËSIRË INFORMUESE 9.1 NDJESHMËRIA E SEKTORIT BANKAR NDAJ LËVIZJEVE NË NORMËN E INTERESIT

Lëvizjet e normës së interesit ndikojnë drejtpërdrejt në rezultatin financiar të sektorit bankar kryesisht në dy zëra: të ardhurat neto nga interesi dhe të ardhurat nga rivlerësimi i titujve (për efekt të analizës së ndjeshmërisë, çdo efekt i tërthortë negativ i rritjes së normës së interesit që lidhet, p.sh., me rënien e cilësisë së kredisë, nuk është konsideruar).

Ndjeshmëria e të ardhurave neto nga interesi, analizohet sipas dy skenarëve: Skenari 1, ku normat e interesit vijojnë të mbeten në rënie, edhe pse të lehtë ndaj vitit 2016; dhe Skenari 2 ku normat e interesit, rriten njëtrajtësisht gjatë secilit vit të ushtrimit kundrejt normave aktuale, me 1 p.p. çdo vit.

Për të analizuar efektin që ka një rritje e normave të interesit sipas dy skenarëve të mësipërm, duhet të mbajmë parasysh strukturën e bilancit të sektorit bankar. Më konkretisht, struktura e sektorit bankar në vend regjistron një hendek negativ mes aktiveve dhe pasiveve të ndjeshme ndaj normës së interesit me maturim deri në 12 muaj, duke dëshmuar për një ndjeshmëri të shtuar të sektorit ndaj strukturës së pasivit në rastin e një rritjeje të normave të interesit. Kjo pasi, për të njëjtin ndryshim në normën e interesit, pasivi i bilancit do të riçmohet më shumë se aktivi, duke ndikuar në rënien e të ardhurave neto nga interesi. Në rastin e rënies së normës së interesit, e kundërta është e vërtetë. Llogaritjet në ushtrim konsiderojnë që në dhjetor 2016 rezulton një hendek negativ prej 95.4 miliardë lekësh dhe pesha e pasivit që riçmohet brenda një viti është e konsiderueshme (83% e totalit) dhe më e lartë se ajo e aktivit (76%).

Grafik 9.3. Vlerësimi i të ardhurave neto nga interesi për sektorin bankar, sipas skenarëve



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në skenarin 1, kur normat e interesit shfaqin një rënie të lehtë (0.1-0.2pp), të ardhurat neto nga interesi shënojnë një rritje të lehtë, e cila deri në fund të vitit 2018 shkon në 192 milionë lekë, ndaj nivelit 47,152 milionë lekë që shënuan në dhjetor 2016. Në skenarin 2, kur normat e interesit fillojnë të rriten, të ardhurat neto nga interesi ngushtohen me 545.6 milion lekë në 2017 dhe me 2,019 milionë lekë në fund të vitit 2018, ndaj nivelit të vitit 2016.

Por lidhja e zhdrejtë mes lëvizjes së normës së interesit dhe vlerës së titullit, sugjeron që rritja e supozuar e normave të interesit ndikon negativisht dhe në terma të rivlerësimit të portofolit të titujve që mban sektori bankar, dhe anasjelltas. Në këtë rast, duke konsideruar të pandryshueshëm të gjithë portofolin e titujve të mbajtur deri në maturim (HTM) dhe të vlefshëm për shitje (AFS) në fund të 2016, humbja nga rivlerësimi i titujve për shkak të rritjes së normës së interesit me 1% në vit, vlerësohet në rreth 5.5 miliardë për secilin vit. Në rastin e rritjes së supozuar të normës së interesit në këtë ushtrim, ndryshimi në vlerën e rivlerësuar të titujve, është i papërfillshëm.

Nisur nga krahasimi mes dy skenarëve të mësipërm, mund të thuhet se ndikimi që ka rritja e mundshme e normave të interesit në rezultatin financiar (dhe në vijim në treguesit e kapitalizimit) të sektorit bankar, ka nevojë të vlerësohet me kujdes dhe në vijimësi nga ana e tij.

9.2 PROVA E REZISTENCËS SË LIKUIDITETIT

(114) Prova e rezistencës së likuiditetit mat aftësinë e bankave individuale dhe sektorit bankar për t'i qëndruar goditjeve ekstreme por të mundshme në financimin e tyre. Këto prova synojnë të evidentojnë dobësi të sektorit dhe të ndihmojnë autoritetin mbikëqyrës në vendosjen e prioriteteve për ndërhyrje me politika të posaçme, duke përfshirë ato që synojnë uljen e ekspozimeve specifike ose krijimin e rezervave, dhe për vlerësimin e gatishmërisë në përballimin e një situate të stresit të likuiditetit.

(115) Analiza në këtë rast është ndërtuar në bazë të strukturës së likuiditetit të sektorit në nëntor 2016. Burimi i të dhënave bazohet në të dhënat individuale të bankave për flukset granulare të parasë të gjeneruara nga aktivet dhe detyrimet e klasifikuara sipas strukturës së maturimit. Skenarët e ndryshëm supozojnë disa goditje të tërheqjes së papritur të depozitave dhe vlerësojnë përshtatshmërinë e aktiveve likuide të zgjeruara[56] në dispozicion për financimin e tyre. Më konkretisht:

(i) Ushtrimi supozon se bankat do të përballojnë tërheqjen e theksuar të depozitave të tyre, nëpërmjet shitjes vetëm të aktiveve likuide të zgjeruara (pa kërkuar likuiditet shtesë nga Banka e Shqipërisë);
(ii) Shitja e investimeve në tituj është bërë me një marzh reduktues (*haircut*) të vlerës së tyre prej 10% dhe 20%.

Banka konsiderohet se dështon në ushtrimin e provës së rezistencës vetëm nëse aktivet likuide të zgjeruara tkurren deri në nivelin ku ka nevojë për likuiditet shtesë nga Banka e Shqipërisë në formën e "kredisë për mbështetje me likuiditet".

(116) Rezultatet e ushtrimit tregojnë se sektori bankar e kalon përgjithësisht pa probleme provën e rezistencës së likuiditetit. Në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar, vërehet një dobësim i lehtë i situatës për monedhën lekë dhe një përmirësim i dukshëm i situatës për monedhat euro dhe dollar amerikan. Në rastin e lekut, numri i bankave që nuk arrijnë të mbyllin hendekun negativ të likuiditetit edhe pas shitjes së aktiveve likuide të zgjeruara, varion nga 2 për maturitetet afatshkurtra, në 3 për maturitetet afatgjata. Për monedhën euro, hendek negativ regjistrohet vetëm në maturitetin më afatshkurtër (deri në 1 ditë) për vetëm 1 bankë. Për monedhën amerikane, numri më i madh i bankave që regjistrojnë hendek negativ, kryesisht për maturitete më afatgjata, është 3. Për të treja monedhat, pesha e hendekut ndaj aktiveve të sektorit bankar në monedhën përkatëse është mjaft e ulët (0.1-0.3% për lekun dhe 1.2% për euron dhe dollarin amerikan).

[56] *Në ndryshim nga koncepti i aktiveve likuide sipas rregullores së Bankës së Shqipërisë, që kufizon afatin e maturimit të titujve që përfshihen si "aktive likuide", në këtë koncept, për qëllime të këtij ushtrimi, përfshihet i gjithë portofoli i titujve.*

(117) Në përfundim, vlerësohet se bankat kanë një elasticitet të mirë ndaj goditjeve të likuiditetit. Gjithsesi, niveli i ulët i diversifikimit në rezervat e likuiditetit, që përbëhen kryesisht nga tituj të borxhit qeveritar, nxjerr në pah nevojën për thellimin e tregut dhe rritjen e likuiditetit për këto instrumente.

ANEKS. TREGUESIT E SHËNDETIT FINANCIAR TË SEKTORIT BANKAR

në përqindje	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Treguesit me bazë kapitalin										
Kapitali rregullator ndaj aktiveve të peshuara me rrezik	17.08	17.23	16.17	15.40	15.56	16.17	17.96	16.84	15.72	15.71
Kapitali i nivelit të parë ndaj aktiveve të peshuara me rrezik	16.01	16.31	15.27	14.52	14.30	14.57	14.88	13.79	13.45	13.81
Kapitali aksioner ndaj totalit të aktiveve	7.62	8.57	9.57	9.40	8.69	8.57	8.37	8.58	9.53	9.73
Cilësia e aktiveve										
Huatë me probleme neto ndaj kapitalit rregullator	10.05	21.74	28.24	35.95	52.01	55.62	40.22	38.25	24.28	23.08
Huatë me probleme (bruto) ndaj huave totale	3.36	6.64	10.48	13.96	18.77	22.49	23.49	22.80	18.22	18.27
Përfitueshmëria										
Kthimi nga kapitali (ROE) (bazë vjetore)	20.74	11.35	4.58	7.58	0.76	3.78	6.43	10.53	13.16	7.15
Kthimi nga aktivet (ROA) (bazë vjetore)	1.57	0.91	0.42	0.72	0.07	0.33	0.54	0.89	1.20	0.69
Pozicioni i hapur neto në valutë të huaj ndaj kapitalit										
Pozicioni i hapur neto në valutë të huaj ndaj kapitalit rregullator	1.69	4.30	3.89	5.03	3.94	3.98	4.08	8.49	7.66	7.03
Pozicioni i hapur neto në valutë të huaj ndaj kapitalit të nivelit të parë	1.80	4.54	4.12	5.33	4.29	4.41	4.92	10.37	8.95	8.00
Treguesit me bazë aktivet										
Aktive likuide ndaj totalit të aktiveve	49.77	42.83	27.65	25.95	26.53	29.37	27.64	31.94	32.26	31.29
Aktive likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra (deri në një vit)	73.96	64.86	32.58	30.62	33.15	36.71	34.71	40.36	41.43	40.57
Depozita të klientëve ndaj totalit të huave	215.45	162.60	154.32	166.39	163.20	171.62	180.83	180.16	187.78	192.84

Burimi: Banka e Shqipërisë.